REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 52043/26
Nr. i fq. / Br. st. - 2 -
Data: / Datum: 16.11.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 164/26 16/11/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 nëntor 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 tetor 2026;
2. Projekt – Rregullore për menaxhimin e parkingjeve në Komunën e Vushtrrisë;
3. Propozim - Vendim për miratimin e Propozim – vendimit të kryearit të Komunës për regjistrimin e pronave rezervë të komasacionit nga Komisioni për Komasacion në pronësi të komunës;
4. Propozim - Vendim për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të kuvendit të Komunës nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017;
5. Propozim - Vendim për caktim të lokacionit për mbeturinat inerte;
6. Miratimi i Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vushtrrisë 2026 – 2028;
7. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2026/2027;
8. Informatë lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
9. Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
10. Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
11. Deklaratë mbështetëse mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;
12. Pyetje dhe përgjigje.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVO

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-119/26 26.11.2026

P R O C E S V E R B A L
NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË: 30 TETOR 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe filloi në orën **10:20**
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Pllumb Maliqi, Edmond Hyseni, Gentiana Rama, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Isak Uka, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini, Stefan Markovic dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Gresa Muli, Fakete Dushi, Hava Mlinaku, dhe Nasuf Aliu.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 27 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, andaj procedoj me rendin e punës sipas rregullores së punës së kuvendit.
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- E nderuar kryesuese e Kuvendit, të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtarë të Kuvendit, kolegë, të nderuar përfaqësues të KFOR-it dhe të shoqërisë civile, të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë të Vushtrrisë, Mbeturinat në oborrin e Shkollës së Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtrri dëmtojnë imazhin e institucionit arsimor, rrezikojnë sigurinë e nxënësve dhe cenojnë pastërtinë e ambientit. Këto mbeturina ndodhen në oborrin e kësaj shkolle që nga viti 2025, në kohën kur në Komunën e Vushtrrisë u realizuan dy projekte. Projekti i parë ishte rikonstruktimi i bulevardit dhe ndërtimi i parkingut nëntokësor, Lot 1, me vlerë prej 2.713.169,78 euro, me numër protokolli 644238965151, si dhe projekti i ndërtimit të shesheve dhe parqeve në Vushtrri. Kërkojmë nga Komuna e Vushtrrisë menaxhim më të mirë, transparencë dhe llogaridhënie gjatë implementimit të projekteve dhe shpenzimit të parasë publike, si dhe largimin e këtyre deponive nga oborri i Shkollës Profesionale

“Bahri Haxha”. Gjatë këtij muaji kam pasur takime me përfaqësuesit e Këshillit Lokal Stanoc i Epërm, Abdyl Bajqinovci, si dhe me banorët e fshatit Gracë, të cilët kanë paraqitur disa kërkesa, të cilat po i paraqes këtu.
Kërkesat e tyre janë:

- Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm;
- Rregullimi i pompave të ujit në disa lagje të fshatit Gracë;
- Rregullimi i kanalizimit në disa lagje të fshatit;
- Asfaltimi i rrugëve “Ibarska” dhe “Radosovska” dhe riemërtimi i tyre;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik.

Po ashtu, gjatë takimit me anëtarin e Këshillit Lokal Stanoc i Epërm, z.Bajram Ibrahimi, dhe qytetarët e Stanocit të Epërm, janë paraqitur kërkesa që në lagjen Ibrahimi-Bregaj të rregullohet rruga e rendit të katërt, e cila është aneks i rrugës “Amerika”. Në këtë rrugë kalojnë çdo ditë rreth 25 nxënës dhe gjendja e saj është shumë e rëndë. Po ashtu, është kërkuar edhe rregullimi i kanalizimit. Banorët e lagjes Maloku kanë kërkuar pastrimin e lumit, si dhe rregullimin e kanalizimit. Edhe banorët e lagjeve Buliqi dhe Terakaj kanë kërkuar rregullimin e kanalizimit. Gjatë takimeve me banorët, qytetarët e lagjes Haradinaj dhe Kosumi kanë kërkuar rregullimin e rrugës, e cila është aneks i rrugës “Ferat Haxhaj”, përkatësisht asfaltimin e saj ose, së paku, shtrimin me zhavorr, pasi bëhet fjalë për një rrugë të rendit të katërt. Po ashtu, kanë kërkuar edhe largimin e mbeturinave. Gjatë takimit që kam pasur me anëtarët e Këshillit Lokal Stanoc i Epërm dhe me bujqit e këtij fshati, ata kanë kërkuar vendosjen e gypave në një rrugë të rendit të katërt, për të cilën kam pasur edhe premtim nga drejtori i Bujqësisë dhe drejtori i Emergjencave. Bëhet fjalë për gypa të cilët kanë mbetur në atë rrugë pa u vendosur tash e dy vjet. Rruga është zgjeruar, ndërsa gypat kanë mbetur pa u vendosur. Në takimin që kam pasur me drejtorët e Bujqësisë dhe gjatë vizitës që kemi bërë në atë lokacion, kam marrë premtimin se kjo çështje do të zgjidhet brenda dhjetë ditësh. Mirëpo, kanë kaluar më shumë se tre muaj dhe gypat ende nuk janë vendosur. Ndërkohë, qytetarët, sidomos tani që jemi edhe në fazën e mbjelljes së grurit, nuk kanë mundësi ta kalojnë atë rrugë. Po ashtu, këto ditë kam vizituar edhe tregun e gjelbër për prodhime vendore, i cili është projekt i Komunës së Vushtrrisë, me vlerë prej 1.775.549,73 euro. Ndërtimi i këtij tregu nga Komuna e Vushtrrisë ka filluar në vitin 2024. E kemi edhe kodin e aktivitetit dhe projekti është dashur të përfundojë në vitin 2025, por ende nuk ka përfunduar. Është koha që ky projekt të realizohet në interes të prodhuesve dhe qytetarëve të Vushtrrisë. Mjaft më me vonesa dhe premtime! Është koha për veprime konkrete.

Drita Dibrani, anëtare kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit vijoj: Sot kam ardhur në këtë foltore të Kuvendit për të ngritur disa çështje dhe shqetësime të qytetarëve, të cilat na kanë preokupuar gjatë këtyre muajve, në prag të përfundimit të vitit. Është shumë keq që drejtoresha e Arsimit nuk është e pranishme sot këtu, sepse kam disa pyetje për të, për të cilat besoj se do të japë përgjigje në fund të mbledhjes, gjatë pikës së pyetjeve. Drejtoreshë e Arsimit, a mund të na tregoni sa shkolla dhe sa nxënës ka Komuna e Vushtrrisë? Disa muaj më parë ju kam pyetur lidhur me vendosjen e disa frigoriferëve për pije në shkollën “Anton Zako Çajupi”, pikërisht në shkollën ku ka punuar kryetari Idrizi. Ndërkohë, prindërit ankoheshin se fëmijëve të tyre u ndalohej të sillnin pije nga shtëpia. Pas shumë ankesave të prindërve, këta frigoriferë janë larguar nga shkolla. Është shumë keq që kryetari nuk është i pranishëm sot në këtë seancë, sepse do të duhej të pyesnim se kujt i shërben ky biznes. A është i lidhur ky rast abuzimi me bashkëshortin e një asambliste, e cila voton për PDK-në sa herë ju nevojitet vota në kuvend, apo e njëjta gjendje skandaloze është edhe në shkollën “SHUM 2”, tek shoqja e kryetarit dhe bashkëaktivistja e PDK-së, Shqipe Dubovci?

Si është e mundur që prindërve t'u kërkohen para për lyerjen e klasave dhe blerjen e perdeve? Është shumë keq që kryetari nuk është sot këtu, sepse gjatë fushatës së tij ka folur vazhdimisht për arsimin. Por, përderisa shkollat po bëhen biznes i pakontrolluar, duhet t'i vijë turp. Prindërit, me shumë mundime, sigurojnë kushte për fëmijët e tyre, ndërsa ju po ua rëndoni edhe më shumë xhepin qytetarëve dhe familjeve që i kanë fëmijët në shkollë. Është e rëndësishme të dimë se sa punë zyrtare ka realizuar drejtoresha e Arsimit dhe sa udhëtime ka pasur jashtë vendit. A ka sjellë ndonjë përvojë nga këto udhëtime, apo detyra e saj e vetme është të mos përzihet në punët e drejtorisë? Për këto çështje duhet të jepen përgjigje. Mirë që sot është i pranishëm drejtori i Shërbimeve Publike, zoti Shala, sepse drejtori i Inspeksionit, zoti Ahmeti, nuk vjen fare. Megjithatë, është mirë ta dëgjoni me vëmendje atë që dua të them. A mund të na tregoni si po ju shkon biznesi me xham? A jeni vetë në këtë biznes apo së bashku me kryetarin? Si e imagjinoni që qytetarët e Vushtrrisë t'i mbyllin sytë para kësaj katastrofe mjedisore që po ndodh në qytetin tonë? Unë kam siguruar fotografi dhe video nga terreni, ku shihet qartë fytyra e kësaj qeverisjeje. Sasi enorme të mbeturinave të xhamit dhe mbetjeve të tjera po dërgohen fshehurazi në lokacionin e Kodrës së Bajskës. Aty mbeturinat po hidhen, po digjen dhe më pas po mbulohen me dhe. Imagjinoni, qytetarë të Vushtrrisë! Kompania "Përparimi" mezi po mbijeton dhe pagesat i vonohen, ndërsa këta po bëjnë kontrata të dyshimta. Xhami digjet dhe më pas mbulohet me dhe. Pse nuk reagon Inspektorati ndaj këtij krimi mjedisor që po bëhet në komunën tonë?

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për kryesuesen, kabinetin qeveritar dhe kolegët e nderuar të Kuvendit. Dëshiroj të ndalem te sporti, përkatësisht te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në sektorin e sportit, për vitin aktual kalendarik. Gjatë këtij viti nuk ka pasur asnjë angazhim konkret për mbështetjen e klubeve sportive. Po flas konkretisht për dy ekipet e Vushtrrisë, atë të meshkujve dhe të femrave. Për të dyja ekipet nuk ka pasur ndarje të mjeteve financiare, ndërsa sot të dyja i kanë ndërprerë aktivitetet sportive dhe janë shuar, duke mos qenë më pjesë e garave sportive në nivel vendi. Dua të sqaroj gjithashtu se klubi i volejbollit "Vushtrria" ka garuar në Superligën e Kosovës dhe jo në Ligën e Parë, siç e ka cekur drejtoresha në raportimin e saj. Në përgjithësi, përkrahja e sportit nga DKRS-ja gjatë kësaj periudhe ka munguar. Kjo situatë ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta për klubet, sportistët dhe zhvillimin e sportit në Vushtrri. Sporti nuk mund të zhvillohet pa përkrahje institucionale dhe pa ndarje të mjeteve financiare. Klubet kanë nevojë për mbështetje konkrete, në mënyrë që të mos detyrohen t'i ndërpresin aktivitetet e tyre sportive, ashtu siç ka ndodhur me dy klubet që i përmenda. Si është e mundur që klubi i volejbollit "Vushtrria", në kategoritë e meshkujve dhe të femrave, të ketë qenë kampion në nivel të Kosovës në kategorinë U18 dhe U16, ndërsa të mos ndahen mjete financiare për këto klube? Të gjitha klubet kanë nevojë urgjente për ndihmë financiare. Duhet të gjendet një zgjidhje sa më shpejt, në mënyrë që sporti në Vushtrri të mos mbetet pa klube që marrin pjesë në garat kampionale në nivel të Kosovës. Sa i përket buxhetit të DKRS-së, do t'i drejtohesha edhe drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport: sa ka qenë buxheti i kësaj drejtorie?

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit-E nderuara kryesuese e Kuvendit, të nderuar kolegë asamblistë, të nderuar drejtorë, të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë dhe mysafirë të nderuar, Fillimisht, dua të them se do të ishte mirë që kryetari të ishte i pranishëm në këtë mbledhje, pasi mbledhjen e kishim planifikuar ta mbanim më 29, por data është zhvendosur nga 29 në 30, me arsyetimin se kryetari do të ishte i pranishëm. Ndoshta kryetari nuk ka se si ta mbrojë dështimin e qeverisjes lokale dhe dështimet e njëpasnjëshme të drejtorive që vetë i udhëheq dhe, për këtë arsye, mungon edhe sot në seancë. Nuk desha t'i drejtohem kryetarit me pyetje, por desha të ngre disa çështje që janë shqetësim imi dhe i komunitetit. Drejtoria e Prokurimit ka filluar të procedojë tenderë në vazhdimësi, pa e marrë parasysh nëse ka buxhet apo jo. Ndoshta edhe kryetari nuk është

në dijeni se drejtori i Prokurimit ka hapur tender për vendosjen e kamerave në qytet, në vlerë prej 300.000 eurosh. Ndoshta drejtori i Prokurimit nuk e përfill fare kryetarin dhe ky i fundit nuk ka dijeni se ky tender vetëm do ta fundosë Komunën e Vushtrrisë. Në çdo mbledhje, në çdo debat dhe në çdo intervistë, kryetari i komunës del dhe arsyetohet për mungesën e mjeteve financiare, duke e përmendur barrën e kontratës kolektive. A është në rregull që vazhdimisht ta fundosim komunën në vështirësi financiare? Nuk është vetëm ky tender. Është edhe tenderi tjetër që është lidhur, për të cilin kam folur edhe në këtë seancë, për pastrimin e lumit Sitnica, nga pjesa e lumit Podrançë deri në fshatin Doberllukë. Ky është një tender me vlerë marramendëse, me makineri për të cilat kam theksuar se nuk përkojnë me punët që janë kryer. Çfarë ka ndodhur me atë tender? Çështja tjetër që dua të ngre para jush është vendosja e rampës te Banesat e Bardha, aty ku operojnë shumica e bizneseve dhe ku ofrojnë shërbime shumica e mjekëve të komunës dhe të Vushtrrisë. Çfarë po ndodh me Drejtorinë e Inspeksionit? Apo nuk ka fare Drejtori të Inspeksionit? Ku është problemi që Drejtoria e Inspeksionit nuk po e zbaton vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, përmes të cilit drejtori i kësaj drejtorie e ka larguar rampën, me qëllim të lirimit të hapësirës për qytetarët që shkojnë për të marrë shërbime në atë pjesë, ku operojnë mjekët e Komunës së Vushtrrisë? Apo nuk ka fare bashkëpunim ndërmjet drejtorive?

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Fillimisht, duhet të ndalem pak te kryesuesja. Kryesuese, ta kemi të qartë: ti je kryesuese e Kuvendit, je pjesë e Kuvendit, je pjesë e jona dhe nuk je pjesë e qeverisjes e as zëdhënëse e kryetarit. Pra, ti je njëra prej nesh dhe jo njëra prej tyre. Prandaj, do të të lusja që fillimisht ta luash rolin e një anëtareje të Kuvendit dhe jo rolin e një zëdhënëseje të kryetarit. E dyta, zonja e paraqet çështjen dhe faktet. Përditë, madje çdo sekondë, që nga momenti kur ke ardhur, po dëshmon se nuk po e luan rolin e kryesueses, por rolin e zëdhënëses së kryetarit. Duhet ta kuptojmë një gjë: fjala parlament rrjedh nga fjala *parler*, që do të thotë të flasësh, ndërsa fjala kuvend nënkupton kuvendimin, pra të folurit. E vetmja armë që mund ta përdorim ne si anëtarë të Kuvendit është fjala, argumentimi dhe arsyetimi logjik e faktik për çështjet e ndryshme. Ne nuk kemi armë tjetër. Prandaj, nëse ti ia mohon të vetmen armë që ka një deputet apo asambleist, atëherë po e degradon në maksimum këtë Kuvend, i cili është i paraparë pikërisht për këtë qëllim. Është shumë e thjeshtë. Anëtarja e Kuvendit e paraqiti një çështje, duke ngritur shqetësimin se Kodra e Bajkës është shndërruar në një kodër mbeturinash. Përveç mbeturinave të tjera që kanë qenë aty më herët, tash paska filluar të shndërrohet edhe në deponi të mbeturinave të xhamit. Anëtarja e Kuvendit e ngriti këtë çështje, ndërsa ju ironizoni dhe e ndërprisni gjatë ngritjes së shqetësimeve për të cilat ajo është e thirrur të flasë. Ju lutem, kini kujdes në këto çështje. Kryesuese, do të të lusja ta ushtrosh rolin tënd për të cilin je e përcaktuar.

Diellza Pllana, anëtare kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Dua të ngre sot një çështje që e konsideroj të rëndësishme dhe që lidhet drejtpërdrejt me trajtimin e përfaqësuesve të komuniteteve në Komunën e Vushtrrisë. Më datë 27 të këtij muaji, në zyrën e kryetarit dhe në Drejtorinë e Financave është dorëzuar një kërkesë nga anëtarët e Komitetit për Komunitete. Ne, si anëtarë të Kuvendit Komunal, paguhemi për punën dhe pjesëmarrjen tonë në mbledhje. Ndërkohë, përfaqësuesit e komuniteteve, të cilët kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në identifikimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të tyre, në adresimin e problemeve dhe shqetësimeve të përditshme, si dhe në promovimin e bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve në Vushtrri, po përballen me mospagesën e mëditjeve për pjesëmarrjen në mbledhjet e Komitetit për Komunitete. Prandaj, kërkoj nga organet përgjegjëse që të sqarojnë sot arsyet e kësaj vonese, të konfirmojnë obligimet e papaguara dhe të përcaktojnë një afat konkret për realizimin e pagesave.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit- tha se dëshiron të sqaroj dhe të demantoj disa nga pretendimet që u thanë, pasi unë dhashë vetëm një përgjigje lidhur me seancën e Kuvendit, e cila është shtyrë për një ditë. Ndërsa, në takimin që pata me kryetarin, mora informatën se ai ndodhej në takim me qytetarët. Ju e dini që e premtja është ditë e dedikuar për qytetarët dhe, si unë, edhe ai e ka pasur të qartë këtë. Megjithatë, nuk kam dashur të hyj në shpjegime të tjera apo të dal përtej çështjes që ishte ngritur. Së dyti, dua të theksoj se në asnjë rrethanë dhe asnjëherë nuk ia kam ndërprerë fjalën dikujt para kohe. Çdo çështje që ngrihet këtu nga anëtarët e Kuvendit është në interes të qytetarëve dhe, rrjedhimisht, edhe në interesin tonë të përbashkët. Ndërhyrja ime e vetme ishte që të mos paraqiten pyetje, por çështje, pasi në këtë pikë të rendit të ditës jemi te paraqitja e çështjeve, ndërsa pyetjet janë të parapara në fund. Megjithatë, dua të theksoj se asnjërit prej diskutuesve sot, me përjashtim të teje, nëse nuk më ka shpëtuar diçka, nuk i është ndërprerë fjala në minutën e tretë dhe nuk i është kufizuar koha e diskutimit. Sa i përket ndërhyrjes sime për t'ju rikthyer temës, kjo është përgjegjësi dhe detyrë e kryesueses, e jo e dikujt tjetër. Prandaj, ju lutem që çështjet t'i paraqitni në mënyrën e duhur, sepse të gjitha ato që diskutohen këtu duhet të jenë në interes të qytetarëve dhe, rrjedhimisht, në interes të të gjithëve ne. Sa i përket rolit tim, zëdhënëse e kryetarit nuk jam, edhe pse, për nga profesioni, ndoshta do të më përshtatej. Por, nëse ndonjëherë shpallet një konkurs i tillë, nuk e di nëse do të konkurroja. Unë jam njëra prej jush, kam qenë dhe do të vazhdoj të jem njëra prej jush. Nëse dëshironi ta vlerësoni drejt këtë çështje, besoj se deri më tani e keni parë vetë qëndrimin dhe mënyrën se si e kam ushtruar këtë detyrë. Lidhur me çështjen e kompensimit të anëtarëve të Komitetit për Komunitete shtoj se mmeqenëse kjo çështje lidhet drejtpërdrejt me mua, dëshiroj të jap një përgjigje dhe disa sqarime. Kjo është një çështje që përbën shqetësim timin personal, por edhe të të gjithë neve. E njëjta problematikë ka qenë e pranishme edhe gjatë mandatit të kaluar. Të gjitha veprimet që është dashur të ndërmerren në aspektin ligjor dhe zyrtar i kemi ndërmarrë. Kemi dërguar kërkesën në ministrinë përkatëse, por përgjigjja që kemi marrë ka qenë se për anëtarët që nuk janë pjesë e Kuvendit Komunal nuk ekziston kodi buxhetor për pagesën e tyre. Kjo nuk është një problematikë që prek vetëm Komunën e Vushtrrisë, por është e pranishme edhe në komuna të tjera. Prandaj, do të ishte mirë që ta ngrisim zërin së bashku, si anëtarë të Kuvendit, por edhe përmes Kolegjiumit të Kryesuesve, ku këtë çështje tashmë e kemi ngritur. Shpresoj që Ministria e Financave ta marrë parasysh këtë shqetësim, sepse kjo ndarje dhe kjo mënyrë e trajtimit të anëtarëve të Komitetit për Komunitete nuk është aspak e drejtë. E njëjta problematikë vlen edhe për anëtarët e komisioneve të tjera, për të cilat nuk dua të zgjerohem në këtë diskutim. Këto janë çështje për të cilat jemi duke bërë përpjekje të përbashkëta edhe ne, si dhe kryesuesit e kuvendeve komunale të komunave të tjera. Besoj se ministritë përkatëse do të gjejnë një zgjidhje dhe do ta adresojnë këtë çështje në mënyrë të drejtë. Ju siguroj se do të vazhdojmë t'ju qëndrojmë pranë në këto përpjekje, si unë, ashtu edhe kryesuesit e kuvendeve komunale të komunave të tjera.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-tha se po i bashkëngjitëm asaj kërkese dhe shqetësimit që ngritën kolegët Refik, Drita dhe të gjithë të tjerët. Por, të nderuar kolegë, kemi të bëjmë edhe me një shqetësim shumë më të madh. Nuk bëhet fjalë vetëm për Kodrën e Bajskës. Ju ftoj secilin prej jush që të shkoni në fushën sportive „Musa Abazi“ dhe ta shihni se në çfarë gjendjeje ndodhet ajo tash e dy vjet. E nderuar kryesuese, nuk e di se çfarë veprimesh kanë ndërmarrë Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, por të gjitha mbeturinat dhe materialet inerte janë hedhur në fushën e tretë sportive. Dua t'ju bëj një pyetje: në atë pjesë të qytetit luajnë fëmijët e gjysmës së qytetit. A do t'i dërgonit fëmijët tuaj të luanin në ato kushte? Ju ftoj që sot, pas përfundimit të seancës, të dalim dhe ta shohim nga afër gjendjen e asaj fushe. Është e turpshme

për ne si qytetarë dhe për secilin prej nesh që ajo fushë të jetë në atë gjendje. Ju ftoj të shkoni dhe ta shihni vetë. Nuk kam bërë fotografi, por mjafton të shkoni në fushën e tretë sportive. Aty ka qenë edhe fusha e tenisit, ku kanë luajtur shumë qytetarë. Unë jam rritur në atë fushë dhe besoj se secili prej nesh këtu ka luajtur në të. Prandaj, ju ftoj të shkoni dhe ta shihni gjendjen e saj. Nuk po ju ftoj për të dalë e për t'u krenuar me atë që është bërë, por për ta parë realitetin. Të gjitha ato mbeturina dhe materiale që po hiqen nga pjesë të tjera të qytetit po dërgohen pikërisht aty, tash e dy vjet.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Fillimisht dua të ndalem te çështja e Bajskës dhe t'u përgjigjem drejtpërdrejt ish-drejtorit Refik dhe Dritës. I sfidoj publikisht të tre ata që kanë qenë në qeverisje gjatë mandatit të parë, kur kemi ardhur në qeverisje, disa për tre vjet e gjysmë e disa për mandat të plotë. Kodra e Bajskës ka qenë deponia më e madhe e mbeturinave që kam trashëguar në cilësinë e drejtorit të Shërbimeve Publike. Aty ka pasur mbeturina inerte dhe mbeturina të zakonshme. Për këtë çështje, në seancën e ardhshme do t'ju sjell edhe pamje dëshmuese. Sa i përket menaxhimit të Kodrës së Bajskës, ajo aktualisht menaxhohet në mënyrë të shkëlqyeshme nga Ndërmarrja „Përparimi“. Aty tash kullosin bagëtitë, të nderuar kolegë, ndërkohë që dikur ajo ka qenë deponia më e madhe e mbeturinave. Për këtë ju sfidoj publikisht. Nëse Ndërmarrja „Përparimi“ ka hasur në mbeturina gjatë punës dhe i ka larguar e deponuar aty përkohësisht, kjo është çështje tjetër dhe duhet trajtuar ndaras. Por, Kodra e Bajskës ka qenë deponia më e madhe e mbeturinave për qytetin. Sa i përket stadiumit „Musa Abazi“, shumë shpejt pritet të përfundojnë edhe projekti i tregut dhe ai i sheshit, me ç' rast do të bëhet edhe pastrimi i asaj hapësire. Gjithashtu, dua t'ju rikujtoj se stadiumi „Musa Abazi“ është një nga stadiumet më të mira dhe më të lavdishme në territorin e Kosovës. Ndërsa, këtë vit, asnjë aktivitet nuk e keni organizuar aty. Asnjë! Një maratonë e keni organizuar në Mitrovicë, ndërkohë që mund të organizohej edhe në Vushtrri.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e DKRS-së- Duke qenë se po diskutohet informata e DKRS-së lidhur me pyetjen e Ramadan Parduzit, në cilësinë e drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e ndiej si obligim të sqaroj gjendjen financiare në të cilën ndodhet kjo drejtori, por edhe drejtoritë e tjera të komunës. Gjendja financiare nuk është e mirë, për shkak të situatës kaotike dhe vështirësive financiare që lidhen me zbatimin e kontratës kolektive dhe procedurat përmbarimore. Sinqerisht, më vjen keq që edhe klubet sportive po përballen me këtë situatë. Megjithatë, kjo nuk na e zbeh motivimin për të qëndruar gjithmonë pranë tyre. Brenda mundësive dhe kornizave tona ligjore, si Drejtori e Kulturës, jemi duke ofruar bashkëpunim dhe mbështetje për çdo nevojë që kanë klubet sportive.

Drita Dibrani, anëtare kuvendit- Drejtori tha: „Ju sfidoj, ju sfidoj publikisht!“. Edhe unë e sfidoj publikisht drejtorin. Këtu e kam numrin e targave të kamionit, madje e kam edhe videon ku shihet duke u hedhur mbeturina. Komuna e Vushtrrisë ka dy kontrata përmes të cilave mbeturinat duhet të dërgohen në deponi të licencuar dhe jo në Kodrën e Bajskës. Drejtor, deponia përkatëse është në Mitrovicë. Unë e kam videon ku shihet hedhja e mbeturinave. Kjo është e kundërligjshme dhe shkakton dëme në mjedis. Drejtor, për këtë çështje shihemi në Prokurori.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- Edhe njëherë dëshiroj të marr një përgjigje nga ju lidhur me çështjen që e adresova. Duke pasur parasysh se kryetari i komunës e ka shtyrë mbledhjen tonë me arsyetimin se është shumë i zënë për shkak të angazhimeve të së premtes, përsëri, edhe të premten, nuk gjen kohë të vijë në mbledhje. Kjo është papërgjegjësi totale dhe mosrespektim i institucionit të Kuvendit të Komunës. Por, duke parë se gjendja me mbeturinat në Shkollën e Mesme Profesionale „Bahri Haxha“ është tepër e rëndë, dua ta ritheksoj këtë shqetësim. Bëhet fjalë për një shkollë që ka numrin më të madh të nxënësve nga të gjitha shkollat e mesme në Komunën e

Vushtrrisë; një shkollë që ka rend dhe rregull, që vazhdimisht nxjerr kuadro të cilat e përfaqësojnë Kosovën, si në nivel komunal, ashtu edhe në nivel institucional e shtetëror. Megjithatë, deri më tani nuk kemi dëgjuar asnjë fjalë dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje, as nga drejtori i Shërbimeve Publike, i cili është përgjegjës për këtë çështje, e as nga drejtorët e tjerë. Kam pritur një reagim edhe nga ju, kryesuese, duke pasur parasysh se vini nga fusha e arsimit. Kjo është vërtet shqetësuese. Prandaj, edhe njëherë kërkoj që të ndërmerrni masa urgjente për pastrimin e oborrit të shkollës nga mbeturinat e hedhura aty dhe që këtij institucioni t'i kthehet pamja që e meriton, sepse është një institucion me të cilin krenohet e gjithë Komuna e Vushtrrisë. Shkolla e Mesme Profesionale „Bahri Haxha“ është një nga shkollat model, jo vetëm në Komunën e Vushtrrisë, por në të gjithë Kosovën.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- tha se ne jemi zgjedhur për të kryer punë në shërbim të qytetarëve të Vushtrrisë. Ne e ngritëm këtë çështje si shqetësim. Shko dhe shikoje gjendjen, pastaj më trego një punë të mirë që ke bërë. Kemi për të të thënë bravo të gjithë, por hajde, dil dhe tregoje tani. Po e pranoj sfidën. Kryetari yt, Ferit Idrizi, në mbledhjen e kaluar ka thënë: „E falënderoj ish-kryetarin e komunës, Xhafer Tahirin, për punën që e ka bërë gjatë bashkëqeverisjes me Lëvizjen Vetëvendosje“. Kur të duash, që nga ky moment, sapo të përfundojë seanca, shkojmë atje. Nëse ti dëshmon se gjendja është ashtu siç po thua, atëherë unë nuk do të dal më këtu për të folur për këtë çështje.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- Dëshiroj të shfrytëzoj edhe një minutë shtesë për t'iu drejtuar drejtoreshës së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Drejtoreshë, do të dëshiroja që të qëndroni më afër klubeve sportive, sidomos në këtë periudhë kur ato po përballen me vështirësi të mëdha financiare. Për shkak të mungesës së mbështetjes financiare, disa klube tashmë janë shuar dhe, sipas informatave që kam, deri më tani janë mbyllur katër klube. Po ju drejtohem edhe në emër të qytetarëve, sepse disa nga klubet më kanë kontaktuar përmes mesazheve, duke kërkuar që ta ngre këtë shqetësim dhe ta pyes drejtoreshën se si mund të jetë më afër klubeve sportive. Unë e di se edhe në të kaluarën u kam qëndruar pranë klubeve, sidomos kur ato kanë qenë në situata të vështira dhe kanë luftuar për mbijetesë. Sot, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, klubet po përballen me vështirësi të mëdha. Madje, disa prej tyre nuk po kanë mundësi të udhëtojnë as në qytetet e tjera për t'i zhvilluar ndeshjet, ndërsa po përpiqen që së paku t'i zhvillojnë ndeshjet si vendas. Gjithashtu, do të dëshiroja të informohesha se sa ka qenë buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për këtë vit dhe sa mjete kanë qenë të parapara për mbështetjen e klubeve sportive.

Diellza Pllana, anëtare kuvendit- E nderuar kryesuese, të nderuar zyrtarë komunalë, drejtorë të drejtorive, drejtoreshë, kolegë asamblistë, të dashur qytetarë të Vushtrrisë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë, Nuk do të doja që kjo mbledhje të përfundonte pa u përmendur një rast tragjik, një krim makabër, për të cilin jemi dëshmitarë të gjithë ne dhe që ka ndodhur në Kosovë. Bëhet fjalë për rastin e znj.Arlinda Zekajt, një qytetare nga Peja, e cila u vra në vendin ku do të duhej të ishte më e sigurta, nga njerëzit që, në parim, do të duhej ta mbronin dhe asnjëherë ta lëndonin. Të gjithë jemi dëshmitarë të një papërgjegjësie totale dhe të një dështimi të madh institucional në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe në mbrojtjen e grave që përballen me këtë fenomen. Për këtë arsye, konsideroj se duhet të ketë reagim nga çdo instancë dhe nga çdo institucion, përfshirë edhe nga ne sot, këtu. Pikërisht në këtë drejtim, dua të propozoj që në kuadër të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të shqyrtohet mundësia e krijimit të një komisioni ose grupi punues ndërpartiak për monitorimin e politikave dhe shërbimeve komunale në fushën e parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së grave. Ky mekanizëm do të duhej të përfshinte përfaqësues nga subjektet politike të përfaqësuara në këtë Kuvend dhe, përmes bashkëpunimit institucional, të

kërkonte informacione dhe raporte periodike nga Qendra për Punë Sociale, Policia dhe mekanizmat e tjerë përgjegjës, gjithmonë në përputhje me kompetencat institucionale dhe kufizimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Ne duhet ta dimë se sa raste të dhunës në familje raportohen në komunën tonë. A marrin viktimat mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme? A ekziston koordinim i mjaftueshëm ndërmjet institucioneve? Ku qëndrojnë vështirësitë dhe çfarë mund të bëjë komuna, brenda kompetencave të saj, për përmirësimin e këtyre shërbimeve? Ky grup punues do të duhej të mblidhej rregullisht, të shqyrtonte rekomandimet dhe të raportonte para Kuvendit për masat e ndërmarra dhe përmirësimet e nevojshme. Gjithashtu, për ne si përfaqësues të qytetarëve të Vushtrrisë, e veçanërisht të grave të qytetit tonë, ky mekanizëm do të mund të shërbente edhe si një hapësirë takimi dhe komunikimi ndërmjet nesh dhe viktimave të dhunës në familje, një hapësirë ku ato do të mund ta trajtonin këtë temë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e tyre dhe të adresonin shqetësimet e tyre. Në fund, nga kjo foltore e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për familjen e Arlinda Zekajt, për çdo familje që ka kaluar nëpër një dhimbje të tillë dhe për çdo qytetar që bashkëndjenë me këtë tragjedi.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- sa i përket pikave që keni propozuar për t'u shtuar në rendin e ditës, do të doja të ndalesha në një çështje shumë të rëndësishme. Kryesuese, ju lutem të më dëgjoni, sepse kjo lidhet drejtpërdrejt me atë që thatë pak më parë, kur theksuat se kemi dy pika për t'u shtuar në rendin e ditës, të cilat e kanë kaluar KPF-në. Është e vërtetë që këto pika e kanë kaluar KPF-në, por nuk është e vërtetë që njëra prej tyre nuk ka qenë në seancën e kaluar dhe nuk është refuzuar nga ky Kuvend. Jam i bindur se këtë nuk e keni përmendur në fjalën tuaj, pasi ju kam përcjellë me shumë vëmendje. Por edhe në emailin që na është dërguar nga Sekretaria e Kuvendit shkruhet e njëjta gjë. Prandaj, nuk e kuptoj se çfarë është kjo nguti për ta sjellë sërish një pikë që ka të bëjë me dhënien e një prone në shfrytëzim, kur ajo është refuzuar nga ky Kuvend në mbledhjen e muajit të kaluar. Meqenëse kjo pikë është refuzuar nga Kuvendi me shumicë votash, ne propozojmë që shqyrtimi i saj të shtyhet për njërën nga mbledhjet e radhës. Pra, nuk ka nevojë për nguti.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- Të nderuar drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë, përfaqësues të KFOR-it, mediave, shoqërisë civile dhe qytetarë të dashur, Jemi para jush për të diskutuar lidhur me rendin e ditës dhe për t'iu referuar edhe diskutimit të parafolësit, kolegut nga Lëvizja Vetëvendosje. Ne, si grup kuvendar, konsiderojmë se këto dy pika, të cilat janë sjellë si propozime shtesë për rendin e ditës, duhet të shtyhen për njërën nga seancat e ardhshme, në mënyrë që fillimisht të shqyrtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe më pas të procedohen në Kuvend. Këto pika nuk e kanë kaluar Komitetin për Politikë dhe Financa. Nuk ka nevojë që ato të vijnë dy herë në Kuvend. Madje, kjo është hera e tretë radhazi që këto pika sillen dhe nuk kalojnë. Nuk e kuptoj pse duhet të sillen përsëri edhe sot. Prandaj, si grup kuvendar, kërkojmë që këto dy pika të mos përfshihen në rendin e ditës dhe të shtyhen për një nga mbledhjet e ardhshme, në mënyrë që fillimisht ta kalojnë Komitetin për Politikë dhe Financa.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-edhe logjikisht, edhe ligjërisht, ajo pikë e ka kaluar KPF-në, ka ardhur në Kuvend dhe për të është votuar. Pra, votimi është përfunduar dhe ajo pikë e rendit të ditës e ka përmbyllur procedurën e shqyrtimit në Kuvend. Për t'u sjellë përsëri, duhet t'u nënshtrohet procedurave nga fillimi. Prandaj, kryesuese, sigurohuni që, edhe logjikisht, edhe ligjërisht, procedura të jetë në rregull. Megjithatë, këtë mund ta provojmë edhe një herë më vonë, nëse vendosni ta miratoni. Kam edhe një kërkesë tjetër: të përfshihet në rendin e ditës çështja e vlerësimit të dëmeve për vitin 2026. Bëhet fjalë për rastin e Fehmi Gashin nga fshati Akrashticë, i cili më 26 qershor 2025, gjatë zjarreve që kanë ndodhur në atë pjesë të komunës sonë, ka pësuar dëme shumë të mëdha.

Këto dëme nuk i kam vlerësuar unë, por Komisioni Komunal, i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe i ka evidentuar e vlerësuar të gjitha dëmet e shkaktuara nga zjarri. Sipas vlerësimit të komisionit, dëmet në infrastrukturë janë rreth 5.000 euro, ndërsa dëmet në pjesën tjetër, përkatësisht në njësitë dhe instalimet elektrike, janë rreth 6.000 euro. Pra, kryesuese, dua të theksoj se ky vlerësim nuk është bërë nga unë, por nga Komisioni Komunal, i cili ka dalë në terren dhe e ka kryer vlerësimin e dëmeve. Pyetja ime është: pse nuk është trajtuar rasti i tij, ashtu siç janë trajtuar rastet e tjera që po vijnë sot për shqyrtim në këtë mbledhje? Bëhet fjalë për dëmet e shkaktuara nga zjarri i madh i 26 qershorit 2025, i cili e kishte përfshirë atë pjesë të komunës dhe nga i cili ky qytetar ka pësuar dëme të konsiderueshme. Prandaj, kërkoj që rasti i tij të përfshihet në rendin e ditës së sotme ose, në të kundërtën, të procedohet për shqyrtim në njërën nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit, me qëllim që të merret një vendim për kompensimin e dëmeve, nëse jo në tërësi, atëherë së paku në një pjesë të tyre. Unë nuk e njoh personalisht këtë qytetar, por kam qenë në vendin e ngjarjes që nga dita kur ka ndodhur zjarri dhe kam parë nga afër dëmet që i janë shkaktuar. Besoj se duhet të përpiqemi ta ndihmojmë edhe një qytetar që gjendet në gjendje të vështirë. Nuk po e marr këtë si obligim personal, por thjesht po kërkoj që rasti i tij të trajtohet me seriozitetin e duhur. Pra, kërkoj që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës së sotme ose të procedohet për një mbledhje të ardhshme. Komisioni tashmë e ka kryer vlerësimin dhe e ka miratuar atë.

Isa Hajrizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim-ne nuk e kemi përfshirë çështjen në fjalë në rendin e ditës, për arsyen se, nëse i votojmë ato që i kemi përfshirë në rendin e ditës, ato procedohen në AME (Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave). Qeveria i kompenson vetëm dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Në këtë rast, është konstatuar se zjarri është shkaktuar nga dora e njeriut dhe jo nga ndonjë fatkeqësi natyrore. Për këtë arsye, nuk e kemi përfshirë këtë çështje, sepse Qeveria nuk i kompenson dëmet e shkaktuara nga faktori njeri. Kjo është arsyeja pse nuk e kemi proceduar. Komuna nuk ka buxhet për t'i kompensuar këto dëme. Por, siç thanë edhe kryesuesja dhe ti, ne mund ta trajtojmë këtë çështje në seancën e radhës. Nuk mund t'ia përcaktojmë tani kompensimin për vitin e ardhshëm, sepse aktualisht nuk kemi mjete buxhetore. Nëse ju e votoni, ne mund ta përfshijmë në buxhetin e vitit të ardhshëm një shumë për t'ia kompensuar disa nga dëmet. Qeveria i kompenson vetëm dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe jo ato të shkaktuara nga dora e njeriut

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit-Meqenëse jemi te këto pika, kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës mbështetja financiare për familjen së cilës i është djegur shtëpia gjatë këtij muaji. Të gjithë e dimë se familja ka pësuar dëme të mëdha. Familja aktualisht ka dalë nga shtëpia, e cila është bërë e pabanueshme. Nuk e di nëse komisioni ka dalë për ta vlerësuar dëmin apo jo. Ndoshta drejtori mund të na njoftojë më mirë për këtë çështje. Megjithatë, duke e ditur se këtë vit nuk ka buxhet, do të ishte mirë që kjo çështje të futet si pikë e rendit të ditës ose, nëse e shohim të arsyeshme, të bartet për vitin e ardhshëm, me qëllim që asaj familjeje t'i ofrohet mbështetje financiare. Fatkeqësia më e madhe është se zjarrfikësit kanë arritur vetëm pas rreth 40 minutash për të ndërhyrë dhe për ta shuar zjarrin. Por edhe më shqetësuese është një çështje tjetër: Njësia e Zjarrfikësve tash e sa vite nuk ka bërë kërkesë në AME për shtimin e numrit të zjarrfikësve, duke e ditur se Komuna e Vushtrrisë i paguan zjarrfikësit, ndërsa menaxhimin e tyre e bën Agjencia e Menaxhimit Emergjent në nivel qendror. Prandaj, duke parë situatën dhe dëmet e shkaktuara, kërkoj që ta mbështesim këtë familje, e cila ka pësuar humbje të konsiderueshme materiale në shtëpinë e saj.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-Mendoj se të gjitha rastet e fatkeqësive të shkaktuara nga dora e njeriut është mirë të trajtohen si pikë e veçantë. Mund të ketë edhe raste të tjera, të cilat do të

ishte mirë t'i diskutojmë në një nga seancat e ardhshme dhe të propozojmë mënyra për trajtimin e tyre. Pajtohem plotësisht që ajo familje të mbështetet, por nëse ka edhe familje të tjera në situata të ngjashme, propozoj që drejtoria përkatëse të përgatisë një raport dhe t'i trajtojmë të gjitha këto raste në mënyrë të veçantë, sidomos ato që nuk mbështeten nga ministria. Mendoj se ky është një propozim praktik dhe i drejtë, pasi edhe Komuna ka përgjegjësi në këtë drejtim. Prandaj, do të propozoja që në seancën e ardhshme t'i trajtojmë të gjitha rastet. Nuk ka rëndësi se kush e merr iniciativën apo kush e propozon pikën e rendit të ditës. Nuk dua të marrë primatin e kësaj iniciative apo të dal si i pari që e propozon, por kërkoj që këto raste t'i trajtojmë me dinjitet, pa u ngutur dhe duke i trajtuar të gjitha familjet në mënyrë të barabartë.

Isa Hajrizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim- sa u përket zjarreve, ende nuk ka dalë raporti përfundimtar, por shkaktari kryesor i zjarreve që kanë ndodhur deri më tani është dora e njeriut. Për këtë arsye, Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nuk i merr parasysh këto raste, pasi kompetencat e tij shtrihen në të gjitha komunat e Kosovës. Sa i përket Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve në Vushtrri, mund të them se është ndër më të mirët. Deri më tani, asnjë vlerësim i bërë nga ky komision nuk na është kthyer. Vlerësimet janë profesionale dhe të sakta. Edhe për shtëpinë e kësaj familjeje, komisioni ka dalë në terren, e ka bërë vlerësimin dhe ia kemi dërguar propozimin kryetarit të komunës për ndarjen e 2.000 eurove si mbështetje fillestare për familjen. Sa i përket zjarrfikësve, atë ditë i gjithë ekipi ka pasur vështirësi në terren. Vonesa ka ndodhur për shkak se është dashur të merret një automjet zjarrfikës nga një lokacion tjetër dhe të sillet te shtëpia, ndërsa një automjet tjetër është dashur të tërhiqet nga Akrashtica. Ne kemi qenë aty pranë dhe e kemi parë nga afër situatën. Kjo tregon nevojën që Komuna të ketë një kamion zjarrfikës shtesë, pasi është kërkesë e domosdoshme për përballimin e rasteve të tilla.

Rahim Ajeti, anëtar i kuvendit- E nderuar kryesuese, të nderuar kolegë asamblistë, Unë e kam kërkuar fjalën shumë më herët, gjatë diskutimit për pronat, por kryesuesja nuk na pa fare neve në pozitë, por vetëm opozitën. Prandaj, kryesuese, ju lutem që nganjëherë ta shikoni edhe pozitën, sepse edhe ne jemi këtu dhe jemi pjesë e këtij Kuvendi. Gjithashtu, po kërkoj, ashtu siç kam kërkuar edhe herën e kaluar, edhe sot publikisht, që prona për të cilën po diskutohet, e cila gjendet në fshatin tonë, në Stanoc të Poshtëm, dhe për të cilën është marrë vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 30 vjet, të dedikohet për ndërtimin e një Qendre të Mjekësisë Familjare. Ky është një propozim dhe kërkesë e Këshillit të Fshatit dhe e banorëve. Nuk ka vend më adekuat në atë pjesë sesa kjo pronë për ndërtimin e një Qendre të Mjekësisë Familjare. Prandaj, kërkoj sot nga drejtori, kryetari dhe kryesuesja që kjo pronë të mos na sillet më në Kuvend në këtë formë, duke u tallur me një çështje kaq të rëndësishme për banorët. Ndoshta ka premtime apo interesa të caktuara për këtë pronë diku tjetër, por më mirë është të mendojmë për qytetarët sesa për individët.

Në vazhdim kuvendi votoj në mënyrë individuale për disa pika të propozuar në të ndryshme për t' i bërë pjesë të rendit të ditës për shqyrtim dhe atë si në vijim:

Kuvendi pas votimit me 11 vota "për", 12 vota "kundër" dhe 1 vota "abstenim" vendosi që *të mos shtohet* në rend dite Propozim-Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjes së interesit.

Kuvendi pas votimit me 13 vota "për", 10 vota "kundër" dhe 1 votë "abstenim" vendosi që *të shtohet* në rend dite Propozim-Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale përmes ankandit publik.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 13 vota "për", 9 vota "kundër", aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 shator 2026;
2. Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026;
3. Propozim – vendim për formimin e komisionit për hartimin e Draft - Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027;
4. Propozim – vendim për miratimin e zgjidhjes me marrëveshje të kontratës mbi dhuratën Nr. LRP/ref:477/1248/2025, dt. 31.01.2025;
5. Propozim – vendim për emërtimin e objektit të muzeut;
6. Informatë nëntëmujore për punën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.44640/26 për shtimin e emrit të z.Erzen/Hysen/Dedia në listën rezervë të rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Raport mbi vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për muajin korrik 2026;
9. Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale;
10. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 shator 2026;

Pas shqyrtimit, pas votimit me 12 vota "për", kuvendi aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrrisë, mbajtur në datën 24 shtator 2026.

2. Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026;

Drita Dibrani, anëtare kuvendit- E nderuar kryesuese, të dashur qytetarë të Vushtrrisë, të nderuar anëtarë të Kuvendit, Në korrik ju kam thënë se buxheti nuk është thjesht një letër me shifra, por është pasqyrë morale e qeverisjes. Sot, në shtator, po shohim se morali i kësaj qeverisjeje nuk ka ndryshuar. Drekat zyrtare, karburantet dhe luksi i veturave zyrtare nuk ndalen as gjatë vapës së verës. Ndërsa paratë e popullit po shkojnë te përmbaruesit, çerdhet, shkollat, shëndetësia dhe projektet jetike të komunës sonë vazhdojnë të mbeten pa investime. Në korrik, kur e shqyrtuam raportin gjashtëmujor, ju thashë një të vërtetë të hidhur: buxheti i komunës nuk është thjesht një dokument me shifra, por pasqyra e prioriteteve dhe e moralit të kësaj qeverisjeje. Atëherë ju paralajmërova se djersa e punëtorit, mundi i fermerit dhe taksat e bizneseve të vogla po përfundonin në dyert e gjykatave dhe në luksin e pushtetit. Sot, kur e analizojmë raportin nëntëmujor për periudhën janar-shtator, dëshmia zyrtare e dokumenteve është edhe më shqetësuese. Ajo që pamë në gjysmën e parë të vitit jo vetëm që nuk u ndal, por u përkeqësua edhe më shumë gjatë tre muajve të verës. Përderisa në korrik alarmuam për shpenzimet e udhëtimit, veturave me qira dhe karburanteve, të dhënat tregojnë se këto shpenzime janë rritur nga 45.000 euro në qershor në 54.300 euro në shtator. Pra, kemi një rritje prej 9.300 eurosh. Edhe te drekat zyrtare kemi një rritje të konsiderueshme. Në qershor shpenzimet ishin 53.000 euro, ndërsa në shtator kanë arritur në 69.000 euro. Pra, kemi rreth 15.000 euro shpenzime shtesë. Shtrohet pyetja:

ku dhe për çfarë janë shpenzuar këto para në restorante të ndryshme? Sa u përket shërbimeve të tjera kontraktuese, në kodin 13460, edhe në korrik e kam ngritur si shqetësim këtë çështje. Deri në shtator, kjo shumë është bërë edhe më shqetësuese, duke arritur shifrën marramendëse prej mbi 2,55 milionë eurosh. Qytetarët kanë të drejtë të dinë se cilët operatorë po i marrin këto para dhe për çfarë shërbimesh po paguhen. Në korrik ju pyeta se ku po shkon djersa e qytetarit. Përgjigjja gjendet edhe në raportin e shtatorit: mbi 2,75 milionë euro kanë përfunduar përmes faturave përmbarimore, duke marrë mjete nga investimet kapitale për të mbuluar detyrimet dhe dështimet tuaja gjyqësore. Cilat janë pasojat e kësaj? Në pasqyrat financiare, projektet kapitale figurojnë me realizim zero.

Ndër projektet që vazhdojnë të figurojnë me zero realizim janë:

- Blerja e autobusëve;
- Ndërtimi i vigut në Novolan;
- Ndërtimi i parkut në Dyneku,
- Ndërtimi, i çerdheve publike në Lumadh, në Maxhunaj dhe në qytet;
- Ndërtimi i shkollës "Emin Duraku",
- Ndërtimi i shkollës "7 Mars", në Bukosh;
- Ndërtimi i objektit për depon e shëndetësisë në Vushtrri.

Në korrik ju deklaruar se këto gjërat duhet të përmirësohen, por raporti i shtatorit dëshmoi të kundërtën. Për luks ka para, ndërsa për çerdhe, shkolla dhe shëndetësi nuk ka.

Kryetari sot po mungon, por kërkoj që të na përgjigjeni në këto pyetje:

1. Si e shpjegoni faktin që, edhe pas alarmit tonë në korrik, shpenzimet për karburante dhe dreka zyrtare janë rritur edhe më shumë gjatë verës, duke arritur shifra rekorde?
2. Cilat janë kontratat specifike që e përbëjnë shumën prej mbi 2,55 milionë eurosh për shërbime të tjera kontraktuese? A mund të na e ofroni listën e tyre, drejtor?
3. Pse mbi 2,75 milionë euro nga investimet kapitale janë marrë përmes përmbaruesve, duke lënë çerdhet, shkollat, objektet shëndetësore dhe projektet nëpër fshatra me realizim zero?

Pra, Vushtrria nuk ka nevojë për luks zyrtar në kurriz të qytetarëve. Ajo ka nevojë për llogaridhënie dhe transparencë, si dhe për një qeverisje me duar të pastra, gjë që deri më tani nuk po shihet.

Prandaj, ne do të vazhdojmë t'jua përballim këto shifra zyrtare, derisa paratë e qytetarëve të kthehen në shërbim të qytetarëve. Gjithashtu, drejtorit të Financave, nëse është i pranishëm, i kërkoj të na tregojë se sa mjete janë marrë nga projektet për shkak të obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive. Sa është shuma e saktë që është marrë nga projektet për t'i mbuluar këto obligime? Meqenëse në çdo projekt po deklaroni se mjetet janë marrë për shkak të kontratës kolektive, kërkoj të na njoftoni saktësisht se për çfarë shume bëhet fjalë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- Sa i përket raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026, nga raporti dhe tabelat shoqëruese shihet se granti qeveritar për periudhën janar–shtator 2026 ka qenë i planifikuar në shumën prej 23.842.592 €**,** ndërsa realizimi është 23.804.000 €**,** apo shprehur në përqindje, rreth 100%**.** Këtu mund të nisem nga një shprehje: *Planifikohen investimet, shpenzohen paratë, por punët nuk kryhen.* Sa u përket të hyrave vetanake, për këtë periudhë nëntëmujore, planifikimi ka qenë 3.108.432 €**,** ndërsa realizimi i të hyrave është 2.762.527 €**,** apo shprehur në përqindje, 89%**.** Donacionet e brendshme të planifikuara kanë qenë 3.623 €**,** ndërsa gjatë kësaj periudhe nëntëmujore nuk është realizuar asnjë shumë nga kjo kategori. Sa u përket investimeve kapitale, buxheti i planifikuar ka qenë **5.**621.622 €**,** ndërsa shpenzimet për këtë periudhë kanë arritur në 3.961.198,99 €**,** apo shprehur në përqindje, 70,46%**.** Në vazhdim, do t'i përmend disa nga projektet që kanë qenë të planifikuara, por që nuk janë realizuar ose nuk kanë

filluar fare gjatë periudhës raportuese nëntëmujore. Siç shihet edhe në tabelë, për këto projekte realizimi figuron me zero.

- Ndërtimi i çerdheve në Vushtrri, Lumadh, Smrekonicë dhe Maxhunaj;
- Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët "Emin Duraku";
- Ndërtimi i shkollës fillore "Naim Frashri në Vushtrrisë;
- Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët "7 Marsi" në Bukosh;
- Rregullimi i shkollës së mesme profesionale "Bahri Haxha" në Vushtrri;
- Furnizimi me mjete për punëtorinë e salduesve dhe instaluesve në Shkollën e Mesme Teknike në Vushtrri;
- Ndërtimi i depos për objektet shëndetësore në Vushtrri;
- Ndërtimi i rrugës "2 Maj", me infrastrukturë përcjellëse;
- Rregullimi i rrugës Isak Halili, me infrastrukturë përcjellëse;
- Asfaltimi i rrugës Pantinë–Ashlan;
- Rregullimi i rrugës Bahri Kuçi, segmenti i parë;
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve;
- Ndërtimi i urës në Lumadh;
- Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni;
- Ndërtimi i trotuareve në fshatrat Dobërllukë, Stanoc dhe Akrashticë;
- Ndërtimi i vigut në Novlan;
- Ndërtimi i Parkut të Dynekut.

Të gjitha këto janë projekte të planifikuara në buxhetin e vitit 2026, por që, sipas raportit nëntëmujor, nuk janë realizuar. Prandaj, pyetja është e thjeshtë: Ku janë investimet dhe kush mban përgjegjësi për këtë situatë? I bëjmë thirrje Komunës së Vushtrrisë që të ofrojë transparencë dhe llogaridhënie të plotë lidhur me këtë gjendje. Çfarë do të ndodhë me projektet që nuk janë realizuar? A do të barten në vitin e ardhshëm, a do të rishikohen apo do të mbeten vetëm projekte të parealizuara në letër? Qytetarët kanë të drejtë ta dinë se ku po shkon çdo euro e parasë publike. Transparenca nuk është privilegj, por obligim institucional. Vushtrria ka nevojë për investime konkrete, përgjegjësi institucionale dhe llogaridhënie, e jo vetëm për plane në letër.

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit-mjafton ta lexojë dikush këtë raport të shpenzimeve nëntëmujore të Komunës së Vushtrrisë për të kuptuar se në çfarë gjendje ndodhet komuna. Nga ky raport mund të dëgjohen lavdërime pa fund, por ne që jetojmë dhe ballafaqohemi çdo ditë me mungesën e infrastrukturës dhe probleme të ndryshme, e dimë se kjo është një nga qeverisjet më të dështuara që ka pasur ndonjëherë Komuna e Vushtrrisë. Meqenëse shumica e projekteve kapitale u përmendën nga parafolësi, nuk dua të ndalem në to, por vetëm në disa pika që kanë të bëjnë me shpenzimet. Së pari, dua të ndalem te shpenzimet e komunalive dhe furnizimi me fotokopje. E nderuar kryesuese, në shkollën ku edhe ju keni qenë pjesë, mungojnë fotokopjet. Këtë vit është rrezikuar edhe mbajtja e testeve, pasi arsimtarët, në mënyrë demonstrative, kanë kërkuar që të mos mbajnë fare teste, për shkak të mungesës së fotokopjeve dhe letrës së bardhë. Një tjetër çështje që më ka bërë përshtypje është rritja dhjetëfish e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, krahasuar me vitin e kaluar. Nuk e di se ku po gjenden këto mjete dhe për çfarë udhëtimesh zyrtare po shpenzohen. Gjithashtu, dua të ndalem te mirëmbajtja e rrugëve, për të cilën janë shpenzuar 149.118 euro. A ka mundësi të na tregoni se cilat rrugë janë mirëmbajtur dhe ku janë bërë këto investime? Sepse nuk ka rrugë në Vushtrri ku të lëvizësh me makinë pa hasur në ndonjë gropë çdo 300 metra. Nuk e di çfarë mirëmbajtjeje është bërë në këto rrugë. Dua të përmend edhe tenderin që është duke u zhvilluar për klimatizimin dhe ngrohjen e objekteve. Në raport nuk është specifikuar se për cilat objekte bëhet fjalë. Dua t'ju informoj se, në disa shkolla, përfshirë edhe

shkollën ku keni qenë ju javën e kaluar, unë personalisht, si prind, kam dhënë mjete financiare për furnizimin e klasës së fëmijës tim me klimë. Për më tepër, prindërit kanë kontribuar që klasat të pajisen me klima, perde, dyer dhe të lyhen me gëlqere. Megjithatë, as shkolla dhe as drejtoria përkatëse nuk kanë dalë me një njoftim apo një falënderim të vetëm për prindërit që kanë kontribuar për përmirësimin e kushteve në shkolla. Të paktën, do të duhej të kishim një falënderim për kontributin e prindërve. Nuk kam shumë për të shtuar. Ky raport është një tjetër dëshmi e dështimit të vazhdueshëm të qeverisjes suaj.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- Sa i përket raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026, do të ndalesha më shumë te pjesa e të hyrave vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike. Konkretisht, dua të ndalem te fusha e Urbanizmit, përkatësisht te të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale. Drejtoria e Urbanizmit ka formuar një komision për mbledhjen e taksës për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale. Nga raporti nëntëmujor shohim se realizimi i këtyre të hyrave është vetëm 18%, që është një shifër shumë e ulët. Nëse e shikojmë totalin e të hyrave për këtë periudhë nëntëmujore, shohim se janë mbledhur pothuajse 2.800.000 euro. Prandaj, propozimi im për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Financave është që këto 2.8 milionë euro të ridestinohen për investime kapitale, veçanërisht në projektet që kanë mbetur pa u realizuar në komunën tonë tashmë dy apo tre vjet. Njëri prej këtyre projekteve është Tregu për Prodhuesit Vendorë. Do të ishte mirë që një pjesë e këtyre mjeteve të ridestinohej për këtë projekt, në mënyrë që ai të përfundojë sa më parë. Mendoj se, edhe nga aspekti arkitekturor, Tregu për Prodhuesit Vendorë do të jetë një shembull i mirë dhe një projekt me vlerë për komunën tonë. Prandaj, propozimi im shkon drejtpërdrejt për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Financave që të shqyrtojnë mundësinë e ridestinimit të këtyre mjeteve për përfundimin e këtij projekti.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit- Unë të falënderoj si prind që ke investuar në shkollë. Besoj se shkollat udhëhiqen nga këshillat drejtuese të shkollave, ku edhe prindërit kanë rolin e tyre. I falënderoj të gjithë prindërit që po kujdesen për shkollat dhe po kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve në to. Është mirë që të gjithë të kujdesemi për objektet shkollore dhe të investojmë në to. Të falënderoj publikisht për investimin që ke bërë në shkollë. Të gjithë kemi për detyrë të kontribuojmë për shkollat.

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit- Unë e theksova si dështim të qeverisjes lokale dhe të Drejtorisë së Arsimit faktin që nuk kanë arritur t'i sigurojnë mjetet dhe kushtet elementare për fëmijët tanë në shkolla. Nuk e di në cilësinë e kujt ma ktheve këtë përgjigje, apo thjesht deshe të më falënderoje. Kjo përgjigje është dashur të jepej nga kryetari, nëse do të ishte i pranishëm, duke treguar se kjo është një përgjegjësi dhe dështim i vazhdueshëm i Drejtorisë së Arsimit dhe i kryetarit të Komunës. Sa më përket mua, për fëmijën tim jam gjithmonë i gatshëm të jap gjithçka. Por ne paguajmë taksa pikërisht për këtë qëllim. Me gjithë këto taksa, komuna ka pasur miliona euro suficit. Miliona euro janë bartur dhe janë shpenzuar përmes procedurave të ndryshme, ndërkohë që fëmijët tanë vazhdojnë të mos i kenë kushtet elementare nëpër shkolla. Është e papranueshme që në shekullin XXI të përballemi ende me mungesën e kushteve elementare për fëmijët tanë në shkolla.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së- të nderuar anëtarë të Kuvendit. Unë kështu do të kisha pasur dëshirë të dilja dhe të flisja për statistika, të kundërshtoja anëtaren e kuvendit Drita Dibrani me fakte, pasi në disa raste mund të mos ketë të drejtë. Por dola këtu për t'i kërkuar që ta tërheqë fjalën, sepse me deklaratën e saj e ka ofenduar tërë qeverisjen lokale. Këtu po flitet në emër të qeverisjes lokale, duke na cilësuar si të pamoralshëm. Dritë, në çdo pikë të rendit të ditës mund të vish dhe të diskutosh me fakte e me statistika, të japësh vërejtje dhe të kritikosh, por nuk ke të drejtë të na cilësosh si qeverisje të pamoralshme apo të moralshme. Ne këtu përfaqësojmë dikë.

Nuk jemi pa përfaqësim, sepse edhe ne kemi qytetarë që na kanë besuar dhe të cilët i përfaqësojmë. Nëse Drita nuk e tërheq këtë deklaratë, kërkoj nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje që të dalë dhe ta tërheqë atë deklaratë.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit- Ju lutem, nuk është në rregull të përdoren fjalë të papranueshme gjatë diskutimeve. Prandaj, e ftoj Dritën që ta tërheqë shprehjen „qeveri e pamoralshme". Besoj se nuk është keq të kërkohet falje. Njerëzit e mirë dhe të fortë dinë të kërkojnë falje. Po të ftoj, në fakt nuk po të kërkoj, që ta tërheqësh këtë deklaratë. Ju lutem! Në të gjitha diskutimet ka pasur ofendime, drejtuar qeverisë, kryesueses dhe të tjerëve. Drejtor, të lutem! Dua t'ju siguroj se, fillimisht, kërkoj falje që i kam toleruar këto gjëra, duke menduar se do të përfundonin. Megjithatë, nga sot e tutje, kushdo që përdor fjalë të papranueshme, etiketon apo ofendon cilindo, qoftë qeverinë, anëtarët e Kuvendit apo dikë tjetër, do t'i ndërpritet fjala dhe nuk do të lejohet të vazhdojë me ofendime. Besoj se të gjithë e dini që janë faktet dhe argumentet ato që e bëjnë dallimin, e jo zhurma dhe ofendimet.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa, bazuar në planin e saj të punës, ka përgatitur raportin nëntëmujor dhe e ka proceduar atë në Komitetin për Politikë dhe Financa, për shqyrtim dhe më pas për miratim në Kuvend. Si gjithmonë, të gjitha të dhënat që i kemi paraqitur në raport janë transparente, të sakta dhe pasqyrojnë gjendjen reale të financave të komunës. Sa i përket përmbledhjes së shpenzimeve për këtë periudhë nëntëmujore, buxheti ka qenë i planifikuar në shumën prej **27.560.285 €**, ndërsa realizimi ka arritur në **27.145.693 €**, apo shprehur në përqindje, **98%**. Ajo që më habit është fakti se disa anëtarë të Kuvendit, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje, po bëjnë analiza financiare tani, ndërkohë që gjatë fazës së planifikimit dhe miratimit të buxhetit nuk i kanë ngritur këto çështje.

Për të bërë një analizë statistikore dhe financiare, së pari duhet të merret plani buxhetor dhe të shqyrtohet:

- A është planifikuar buxheti?
- A është planifikuar në mënyrë të detajuar?
- A janë kategoritë ekonomike të planifikuara sipas kodeve ekonomike të paraqitura në tabelat buxhetore?

Nëse këto kategori janë të planifikuara, atëherë duhet të shqyrtohet edhe ecuria e procedurave për miratimin e shpenzimeve, qoftë për udhëtime zyrtare, derivate apo shërbime kontraktuese. Të gjitha këto shpenzime duhet t'i nënshtrohen procedurave përkatëse të miratimit, përpara se të autorizohet realizimi i tyre. Sa u përket shpenzimeve për derivate, është e vërtetë se ato janë realizuar dhe janë të arsyeshme. Kjo lidhet edhe me çmimin e tregut, i cili përcaktohet nga Berza ndërkombëtare. Shifrat që i keni në tabela janë të sakta dhe në rregull. Sa i përket çështjes së transparencës, të cilën u përmendë mendoj se vlerësimin më të mirë për transparencën financiare e ka dhënë Instituti GAP. Komuna e Vushtrrisë ka qenë e vlerësuar me **100% të transparencës buxhetore**. Kjo do të thotë se Drejtoria e Financave i prezanton të dhënat financiare për organizatën buxhetore 644 – Komuna e Vushtrrisë, për të gjitha programet buxhetore. Sa u përket shpenzimeve përmbarimore, përkatësisht atyre që lidhen me kontratën kolektive, dua të sqaroj se, ndryshe nga vitet e kaluara, kur kemi pasur vështirësi në ndarjen e vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me kontratën kolektive nga vendimet e tjera përmbarimore, këtë vit kemi bërë një klasifikim më të qartë. Në vitet e kaluara, këto mjete janë marrë nga kategori të ndryshme ekonomike, si mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale. Të dhënat i kam paraqitur edhe në raport, përfshirë kategorinë e investimeve kapitale. Kodi 0040, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, gjatë vitit 2026 e ka thjeshtuar evidentimin e këtyre shpenzimeve, pasi ato tashmë regjistrohen në një program të vetëm, në këtë kod. Megjithatë, për

të pasur një pasqyrë më të qartë të shumave të marra nga kategoritë e ndryshme buxhetore, po i paraqes të dhënat si në vijim:

Për vitin 2025:

- Mallra dhe shërbime: 897.455 €;
- Shërbime komunale: 252.076 €;
- Subvencione dhe transfere: 1.935.396 €.

Shuma totale e ekzekutuar gjatë vitit 2025 ka qenë **3.683.144 €**.

Për vitin 2026:

- Mallra dhe shërbime: 497.824,97 €;
- Shërbime komunale: 20.932,45 €;
- Subvencione dhe transfere: 1.062.837,48 €;
- Investime kapitale: 2.753.610 €.

Shuma totale e ekzekutuar gjatë vitit 2026 për këto obligime është **4.335.205 €**.

Ndërsa, si total për të gjitha vitet, shuma e mjeteve të ekzekutuara arrin afërsisht në **15 milionë e 16 mijë euro**. Megjithatë, duhet theksuar se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për obligimet që rrjedhin nga kontrata kolektive, por edhe për vendimet gjyqësore dhe përmbarimore që kanë të bëjnë me operatorët ekonomikë. Edhe këto obligime ndikojnë në shumën e përgjithshme të ekzekutuar gjatë këtij viti.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- Unë e dëgjova me vëmendje drejtorin e Buxhetit dhe dua të them disa fjalë rreth disa çështjeve që i përmendi drejtori. Gjatë fjalimit, drejtori tha se ju nuk e keni votuar buxhetin dhe keni dalë jashtë. Ne, si Lëvizje Vetëvendosje, kemi qëndruar në seancën e shtatorit, kur është votuar buxheti, dhe kemi votuar kundër. Në këtë Kuvend kam dalë dhe kam thënë se buxheti është i jashtëligjshëm, për shkak se nuk është mbajtur së paku edhe një takim me qytetarët gjatë muajit shtator për këtë çështje. Kam dërguar ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe dje më është kthyer një përgjigje, sipas së cilës, ku janë edhe kryesuesja, edhe kryetari i komunës, çështjen duhet ta adresojmë në Ministrinë e Financave. Pra, ende nuk e kemi një buxhet valid për vitin e ardhshëm. Kështu që kemi qëndruar në sallë dhe kemi votuar kundër, për shkak se kemi konsideruar që buxheti nuk është ligjor. Kjo është çështja e parë. Çështja e dytë që e ngrita ka të bëjë me transparencën. Drejtori tha se jemi mjaft transparentë. Unë e kam lexuar raportin e GAP-it, mirëpo për mua është shqetësuese se si një projekt i nisur, projekti për parkingun nëntokësor, Loti 1, i cili ka kushtuar 2.7 milionë euro, dhe ato mjete ju i keni paguar në vitet e kaluara, ndërsa, si rezultat i punimeve të para që i ka marrë përsipër kompania nga komuna, janë krijuar mbeturina, pra janë krijuar depo të mbeturinave në oborrin e shkollës dhe në stadiumin e qytetit. Unë e kam edhe fotografinë që e kam bërë. Pra, nuk ka kuptim, drejtor, që ju t'i paguani kompanitë dhe ato t'i shndërrojnë oborret e shkollave dhe hapësirat publike në deponi të mbeturinave. Çështja e tretë që duhet ta ngre është se vazhdimisht, si kryetari, ashtu edhe drejtori, kanë thënë se vetëm kontrata kolektive po na i merr paratë. Sot drejtori e pranoi se, përveç kontratës kolektive, edhe operatorët ekonomikë, kanë marr mjetet financiare në shuma të konsiderueshme përmes procedurave përmbarimore më tepër se sa nga kontratat kolektive, por kontrata kolektive po shfrytëzohet vetëm si instrument arsyetimi.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- I nderuar deputetë, me gjithë respektin që kam për ju, mendoj se i keni përzier pak çështjet. Çështja e parë për të cilën fola kishte të bënte me shpenzimet për vitin 2026, e jo me aprovimin e buxhetit që ka ndodhur, për të cilin keni qenë këtu, për vitin 2027. Po, po. Çështja e parë, unë e pata fjalën për periudhën kur e kemi aprovuar buxhetin e vitit 2025 për vitin 2026.

Ti e di, ke një përvojë të madhe. Për të bërë një analizë, duhet të nisemi nga plani, nga planifikimi dhe nga plani i detajuar. Sa i përket çështjes së transparencës, Drejtoria e Financave është përgjegjëse për prezantimin e të dhënave financiare. Nuk ka kuptim të më pyesësh mua nëse është përfunduar bodrumi atje apo nëse është shtruar rruga për dy metra. Këto nuk janë çështje që i takojnë Drejtorisë së Financave. Financat janë përgjegjëse për të na prezantuar planin buxhetor të miratuar nga ky Kuvend dhe shpenzimet e realizuara. Nëse janë marrë mjete buxhetore në bazë të vendimeve, qoftë në bazë të kontratës kolektive, qoftë në bazë të vendimeve gjyqësore, Drejtoria e Financave është përgjegjëse për të bërë prezantimin e tyre. Sa u përket çështjeve të tjera, ato kanë akterë të tjerë, të cilëve duhet t'u drejtoheni. Kryesuese, më falni, më ka mbetur edhe t'i jap një përgjigje Beratit lidhur me të hyrat vetanake. Ju e dini se me aprovimin e buxhetit i kemi tri tabela buxhetore: tabelën 4.1, 4.2 dhe 4.3. Po ashtu, i kemi fondin 10, grantin qeveritar, fondin 21, të hyrat vetanake, dhe fondin 22, të hyrat e bartura. Fondi 21, përmes planifikimit buxhetor, i shpërndan të hyrat sipas kategorive përkatëse. Kështu që, gjatë këtyre muajve, të gjitha të hyrat që janë inkasuar i kemi plotësuar në kategoritë përkatëse, ndërsa mjetet e tjera do të adresohen në investime kapitale.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-Drejtori përmendi një shifër, në fakt dy shifra, por po e përmbledh në një: 4 milionë e të tjera. Nuk është me rëndësi. Këto mjete janë marrë nga përmbaruesit gjatë këtij viti. Në total, drejtori përmendi shumën prej 15 milionë eurosh. Pyetja ime është kjo: Asnjëherë nuk na keni sjellë një raport të detajuar se si janë shpenzuar këto mjete. Ne duam të dimë se, nga mjetet e dedikuara për mësimdhënësit, sa për qind apo sa mjete kanë përfunduar te vetë mësimdhënësit, sa janë ndalur te avokatët, sa te përmbaruesit dhe sa te ndërmjetësuesit apo faktorët e tjerë. Sepse në shënimet tuaja figuron saktësisht se, nga 100 euro që kanë pasur për t'i marrë mësimdhënësit, sa janë ndalur për avokatët, sa për përmbaruesit dhe sa për shërbimet e tjera. Jam i bindur se mësimdhënësit do të shokohen kur ta shohin shumën e mjeteve që kanë marrë në raport me shumën që është ndarë nga Komuna për ta.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se është pyetje e drejt ajo që parashtroj parafolësi, duke shtuar se edhe vetë ai, si drejtor i Financave, përveç shumave statistikore që i kam në dispozicion, ende nuk kam një informacion të saktë se sa mjete janë marrë përmes përmbarimit për shkak të kontratës kolektive dhe sa përmes vendimeve gjyqësore. Mirëpo, jam duke punuar në këtë drejtim. Kemi për ta trajtuar këtë çështje edhe në kolegjiumin e drejtorëve, sepse të njëjtën pyetje e kam ngritur edhe në nivelin qendror. Arsyeja është se, siç e dini, në vitin 2025, kur i kam prezantuar raportet në këtë Kuvend, në letër rezultonte se realizimi i investimeve kapitale ishte 100%. Mirëpo, në realitet, një pjesë e mjeteve të destinuara për investime kapitale dhe për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë marrë për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive dhe vendimet gjyqësore. Arsyeja është se Thesari, tri ditë përpara, na informon dhe na kërkon të përcaktohemi se nga cilat kategori buxhetore dëshirojmë të merren mjetet, në mënyrë që të mos mbesim me obligime të papaguara. Ne, si organizatë buxhetore, nuk jemi vendimmarrës për këto veprime. Për të dhënë një përgjigje se nga cila kategori duhet të merren mjetet, më duhet të konsultohem paraprakisht dhe ta trajtoj çështjen edhe me ju. Mirëpo, në shumicën e rasteve, nuk na kanë pyetur fare se nga cila kategori duhet të merren ato mjete. Sa i përket informatave dhe tabelave që na i dërgon Thesari, aty evidentohen shumat që janë marrë përmes përmbarimit, por nuk kemi të dhëna të hollësishme se kush i ka marrë dhe për çfarë obligimesh konkrete. Unë zyrtarisht kam kërkuar dhe do të kërkoj përsëri që të na ofrohen të dhëna më të detajuara. Përveç shumave të përgjithshme, të cilat i kam të evidentuara, aktualisht nuk kam një pasqyrë të plotë dhe të saktë për secilin rast. Prandaj, nuk mund t'ju jap një informacion të saktë në këtë moment.

Megjithatë, jam duke punuar në këtë drejtim dhe shpresoj që, më së largu në seancën e dhjetorit, do t'jua prezantoj këtë pasqyrë të detajuar.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 10 vota "për", 8 vota "kundër" aprovoj Raportin nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026.

3. Propozim – vendim për formimin e komisionit për hartimin e Draft - Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se Komuna e Vushtrrisë ka publikuar planet e mëhershme të punës së Kuvendit, përfshirë edhe planin për vitin 2026. Sa i përket komisionit që harton draft-planin e punës për vitin 2027, detyrat kryesore të tij janë përgatitja e dokumentit dhe propozimi i tij për miratim në Kuvend. Detyrat konkrete të komisionit për vitin 2027 janë: të hartojë draft-planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027; të mbledhë propozimet për temat që duhet të trajtohen gjatë vitit. Këtu do të ndalesha te një çështje: jo vetëm komisioni, por edhe ne si kuvendarë kemi të drejtë të propozojmë tema që duhet të adresohen dhe të përfshihen në planin e punës. Po ashtu, komisioni ka për detyrë të përcaktojë aktivitetet dhe çështjet që do të shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit, të caktojë afatet e shqyrtimit dhe organet përgjegjëse për secilën çështje, si dhe ta përgatisë planin brenda afatit të caktuar dhe t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027, në përbërjen si në vijim:

1.1 Melihate Basholli-Latifi, **kryesuese e kuvendit (PDK);**
1.2 Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit (PDK);
1.3 Drita Dibrani, anëtare e kuvendit (LVV);
1.4 Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit (LDK);
1.5 Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit (AAK);

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, dhe të njëjtin duhet t'ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Propozim – vendim për miratimin e zgjidhjes me marrëveshje të kontratës mbi dhuratën Nr. LRP/ref:477/1248/2025, dt. 31.01.2025;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se nga ajo që kemi parë në dokumentin që na është sjellë, bëhet fjalë për një parcelë të cilën paraprakisht një person i caktuar ia ka dhuruar komunës, me kushtin ose marrëveshjen që ajo parcelë të shërbejë si rrugë. Ju e keni bërë këtë marrëveshje. Edhe vetë, gjatë kohës sa kam qenë drejtor, e kam pasur të qartë se një person juridik ka të drejtë ta japë pronën e vet, në mënyrë që ajo pronë më pas të trajtohet nga shteti për interes publik. Mirëpo, nuk njoh raste kur, pasi një pronë i është dhuruar komunës për një qëllim të caktuar, më pas kërkohet kthimi i saj. Gjithashtu, nuk e di nëse ekziston ndonjë bazë ligjore që i jep të drejtë komunës t'ia dhurojë tokën dikujt. A jeni thirrur në ndonjë ligj që e lejon komunën të dhurojë pronën publike? Toka nuk dhurohet. Komuna mund ta japë pronën në shfrytëzim, për 30 vjet, 45 vjet apo 90 vjet, por nuk e di se si mund të bëhet dhurimi i tokës nga komuna. Po ju tregoj se mund të keni edhe më shumë vota dhe ta votoni këtë propozim, por kjo çështje nuk kalon. Lëvizja Vetëvendosje nuk e mbështet këtë pikë të rendit të ditës.
Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- Ne e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës dhe pajtohem me profesor Refikun. Kemi pasur edhe më herët raste të tilla, kryesuese, kur personat privatë, me kërkesat e tyre për asfaltimin ose shtrimin me kubëza të një rruge të caktuar, i kanë falur apo dhuruar pronat e tyre përmes aktit noterial. Një veprim i tillë është zbatuar edhe në Drejtorinë e Kadastrit. Nuk kemi pasur raste kur është kërkuar kthimi i pronës. Në rastin konkret, rruga në fjalë tashmë ka kaluar në pronësi të komunës. Ligjërisht është e pamundur që Komuna, përmes një vendimi të Kuvendit Komunal, ta marrë një vendim për kthimin e kësaj prone. Ndoshta kjo pronë mund t'u jepet ligjërisht në shfrytëzim personave në fjalë, por kthimi i saj në pronësi të tyre, sipas mendimit tim, është i pamundur nga ana ligjore. Unë mendoj se, së paku, ky propozim-vendim është dashur të kalojë paraprakisht përmes Zyrës Ligjore. Besoj se, po të ishte vepruar kështu, ne si asamblistë nuk do të gjendeshim sot në një pozitë të tillë. Prandaj, mendoj se ky propozim është i pakalueshëm nga ana ligjore.
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Ne këtë çështje e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku kemi shprehur kundërshtimin tonë, për shkak se, si nga materiali që kemi pranuar, ashtu edhe nga diskutimet me drejtorin, kemi vërejtur se drejtoria ka tentuar që këtë falje apo rikthim të tokës t'ua bëjë personave fizikë, duke u bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës, përkatësisht Ligjin Nr. 06/L-092.
Ky ligj përcakton mënyrën se si komunat mund ta japin pronën komunale në shfrytëzim dhe si mund ta këmbejnë atë me një pronë tjetër. Prona duhet të jetë e regjistruar në kadastër, destinimi i saj duhet të jetë në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor dhe duhet të ekzistojë interesi publik dhe përfitimi ekonomik për komunën. Afatet për të cilat, në bazë të këtij ligji, ne si Kuvend kemi të drejtë ta japim pronën në shfrytëzim janë dy: shfrytëzimi afatshkurtër, nga një deri në 15 vjet, dhe shfrytëzimi afatgjatë, nga 15 deri në 99 vjet. Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale miratohet nga Kuvendi i Komunës, me shumicën e anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit. Sipas dispozitave përkatëse të ligjit, ekziston edhe Rregullorja QRK Nr. 09/2020, e cila përcakton më hollësisht procedurat për zbatimin e ligjit. Dhënia në shfrytëzim bëhet sipas procedurave ligjore dhe nuk është e njëjtë me dhurimin apo kthimin e pronës. Prandaj, komuna nuk ka të drejtë ta kthejë këtë pronë. Drejtori, gjatë mbledhjes së KPF-së, është bazuar edhe në aktin noterial. Këtu dua t'ia rikujtoj drejtorit se ligji është mbi aktin noterial. Pra, në asnjë ligj, as në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe as në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës, nuk është specifikuar apo përcaktuar që Kuvendi, respektivisht kryetari, të autorizohet për ta kthyer më

pas tokën te pronarët. Pra, ne mund ta japim tokën në shfrytëzim, por që ta falim tokën, dihet se nuk kemi të drejtë. Prandaj, siç e tha edhe shefi i grupit kuvendar, ne do ta kundërshtojmë fuqishëm këtë çështje me të gjitha instrumentet juridike dhe ligjore që i kemi në dispozicion, duke përfshirë edhe adresimin e saj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit- Meqenëse kjo pikë na ka ardhur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku e kemi diskutuar, do të ishte mirë që, përmes Drejtorisë së Kadastrit, të shqyrtohen të gjitha mundësitë ligjore dhe të veprohet ashtu siç është bërë marrëveshja, pra përsëri në bashkëpunim me këta persona. Ne nuk jemi ata që duhet t'ia bëjmë aminin çdo gabimi tuaj të vazhdueshëm. Unë po kërkoj që ju, si komunë, ta shtroni atë rrugë, meqenëse personi në fjalë ka dhënë pronën e tij me qëllim që të shtrohet rruga. Fatkeqësisht, ju e keni bërë praktikë që gjatë fushatave të dilni dhe, për të marrë vota, të premtoni shtrimin e rrugëve, ndërsa në fund nuk i keni realizuar ato premtime. Ky rast është pak më specifik, sepse tani ju ka obliguar që t'ia ktheni pronën përsëri. Prandaj, ne nuk jemi ata që duhet të vazhdojmë t'i mbulojmë defektet tuaja.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së- pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kam cekur se kjo çështje nuk ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim, siç e përmendi zoti Haradinaj. Është një kontratë përmes së cilës prona i është dhuruar komunës me qëllim që të shtrohet rruga. Bëhet fjalë për një rrugë qorre, pa dalje, e cila shërben për katër apo pesë familje. Sipas Drejtorisë së Urbanizmit, meqenëse nuk kanë arritur ta shtrojnë rrugën, personi ka kërkuar që ta shtrojë vetë dhe që prona t'i kthehet përsëri në pronësi. Sa i përket kontratës së faljes, shpeshherë, nëse ju ka ikur ndonjëherë vëmendja, aty shkruhet qartë se palët, në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, duhet ta zgjidhin atë ndërmjet tyre. Dallimi ndërmjet faljes dhe blerjes është shumë i madh. Po ashtu, ekziston edhe pjesa e domosdoshme e ruajtjes së sipërfaqes për të tjerët. Në kontratë shkruhet qartë se palët mosmarrëveshjet duhet t'i zgjidhin ndërmjet tyre dhe, nëse nuk arrijnë marrëveshje, atëherë vendos gjykata. Në këtë rast është komuna pala që duhet të përballet me këtë çështje. Unë nuk i kuptoj këto barriera dhe argumentet e shumta që po i paraqitni, por kjo është e drejta juaj. Kjo çështje është në dorën tuaj, me vota mund të na jepni të drejtën për ta shkëputur kontratën. Nëse nuk votohet, kontrata nuk shkëputet. Lënda vazhdon në gjykatë, sikurse edhe lëndët e tjera.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me "asnjë votë për", 11 vota "kundër" dhe 6 vota "abstenim" nuk e aprovoj Propozim – vendimin për miratimin e zgjidhjes me marrëveshje të kontratës mbi dhuratën Nr. LRP/ref:477/1248/2025, dt. 31.01.2025.

5. Propozim – vendim për emërtimin e objektit të muzeut;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- sipas dokumenteve që na i keni sjellë, është propozuar që muzeu të emërtohet me emrin e "Xhavit Hazirit". A jam në rregull deri këtu? Shpeshherë ne përballemi me këtë çështje, jo pse nuk e dini që nuk është ashtu, por sepse keni dëshirë t'i jepni një interpretim të tillë, sikur Vetëvendosja të jetë kundër vlerave të UÇK-së. Mirëpo, këtë e përdorni vetëm kur keni interes partiak. Përndryshe, ju e dini mirë se nuk është ashtu. Pa e nënvlerësuar në asnjë moment as rolin, as veprimtarinë e personit në fjalë, ne si Vetëvendosje e kundërshtojmë këtë emërtim për disa arsye. Unë i kam përgatitur tri-katër arsye. E para, siç u cek, është e vërtetë që Xhavit Haziri ka lindur në fshatin Druar, mirëpo është po aq e vërtetë se në moshë shumë të re është shpërngulur në Obiliq, ku i ka përfunduar të gjitha nivelet e shkollimit dhe ku e ka zhvilluar tërë veprimtarinë e tij. Me një fjalë, ai nuk është banor apo rezident i Komunës së Vushtrrisë dhe

as nuk ka qenë ndonjëherë i tillë. E dyta, në Obiliq ai është vlerësuar maksimalisht. Shtëpia e Kulturës mban emrin e tij dhe po ashtu aty është ngritur edhe një shtatore. Pra, në njëfarë forme, ai tashmë është përvetësuar si figurë nga Komuna e Obiliqit. E treta, Komuna e Vushtrrisë ka shumë emra që lidhen me luftën e lavdishme të UÇK-së. Po ashtu, ka shumë personalitete që kanë qenë profesionistë të dalluar, pedagogë dhe historianë. Nuk kemi nevojë të importojmë emra nga komunat e tjera për ta emërtuar një institucion të caktuar të komunës sonë. E katërta, dhe ndoshta më e rëndësishmja, duket mjaft e palogjikshme që muzeu të mbajë emrin e "Xhavit Hazirit". Zakonisht, nëse kërkoni edhe në internet, do të shihni se emërtimi i muzeve lidhet me emrin e qytetit, si Muzeu i Vushtrrisë, Muzeu i Prizrenit, Muzeu i Dibrës etj. Pra, zakonisht emri i muzeut lidhet me qytetin ku ndodhet. Nuk ka asnjë logjikë që muzeut t'i vendoset ky emër. Për më tepër, duhet ta kemi parasysh se bëhet fjalë për shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit, e cila tashmë është shndërruar në muze. Tani, të shkojmë dhe të themi se kemi Muzeun e Xhavit Hazirit në shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit, nuk ka kurrfarë kuptimi logjik. Prandaj, ne e kundërshtojmë këtë emërtim.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- Ne, si grup kuvendar, e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës. Ka disa çështje për të cilat nuk pajtohemi me profesor Refikun. Një rast të ngjashëm e kemi pasur edhe me aktorin dhe ish-deputetin tashmë të ndjerë, Adem Mikullovci, i cili nuk ka jetuar në Vushtrri, por megjithatë teatri është emërtuar me emrin e tij. Ne e njohim kontributin e Xhavit Hazirit, pa u ndalur në hollësi të historisë së tij, duke filluar nga prejardhja familjare, jeta e tij politike dhe ushtarake, zhdukja e tij, si dhe fakti se në vitin 2010 është nderuar me titullin Hero i Kosovës nga presidenti i atëhershëm, Jakup Krasniqi. Mendojmë se një emërtim i tillë do të përbënte vlerë për qytetin tonë. Prandaj, si grup kuvendar, do ta përkrahim këtë propozim.

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit- Edhe ne, si grup kuvendar, e përkrahim këtë iniciativë. Madje, mendojmë se deri më tani nuk i është dhënë vlerësimi i duhur kontributit të Xhavit Hazirit. Prandaj, në mënyrë unanime, si grup kuvendar, e përkrahim këtë iniciativë.

Fatmire Cecelia, anëtare kuvendit- Sot, para nesh, kemi një propozim-vendim për emërtimin e muzeut të qytetit. Ky propozim, në pikën një dhe dy, përmban mospërputhje, pasi bëhet fjalë për emërtimin e muzeut dhe emërtimin e objektit të muzeut, të cilat janë dy çështje të ndryshme. Për ata që nuk e dinë, aktualisht ky muze ka dy emërtime. Në vitin 2005, nga ky Kuvend Komunal është themeluar Muzeu i Qytetit dhe është nxjerrë akti i themelimit, me të cilin i është dhënë emërtimi Muzeu i Qytetit Historik-Etnografik. Ndërsa objekti në të cilin është vendosur muzeu është një objekt i trashëgimisë kulturore, i cili gjendet në listën e objekteve të mbrojtura me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe mban emrin e pronarit të tij, "Mahmut Agë Gjinolli". Për ta riemërtuar muzeun me këtë emër, fillimisht duhet të shfuqizohet vendimi me numër 01411/05, i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal për themelimin, emërtimin dhe përcaktimin e veprimtarisë së muzeut. Ju lutem, duhet ta sigurojmë dhe ta shqyrtojmë fillimisht vendimin me të cilin është themeluar muzeu, është emërtuar dhe i është përcaktuar veprimtaria e tij. Në këtë vendim përcaktohet qartë se veprimtaria e muzeut ka për synim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu, edhe me Ligjin për Institucioneve Publike të Kulturës, përkatësisht me nenin 17, paragrafin 17.1, përcaktohet çështja e emërtimit të institucioneve në ndërlidhje me veprimtarinë e tyre. Kjo do të thotë se emërtimi i institucioneve duhet të identifikohet me veprimtarinë që ato zhvillojnë. Muzeu i qytetit mbledh, ruan dhe ekspozon eksponate të periudhave dhe fushave të ndryshme, duke pasur si shtrirje gjeografike të gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë. Prandaj, nuk mund ta ngushtojmë veprimtarinë e tij dhe t'ia ndryshojmë emërtimin një muzeu që ka një mision dhe vizion shumë më të gjerë sesa emri i një personi të përveçëm. Për këtë arsye, kryesuese, brenda muzeut mund të

bëhet një ndarje e veçantë, ku një pjesë e tij mund të emërtohet me emrin e personit në fjalë. Kjo është plotësisht e pranueshme edhe për mua dhe ne jemi të gatshëm ta mbështesim një propozim të tillë. Madje, nëse ende nuk kemi të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e nevojshme për këtë personalitet, mund të punohet në mbledhjen e tyre dhe të organizohet një ekspozitë e veçantë kushtuar jetës dhe veprimtarisë së tij. Për ta prezantuar një personalitet brenda muzeut, duhet të kemi edhe materiale dhe eksponate që e dokumentojnë veprimtarinë e tij. Nëse muzeu emërtohet me një emër të përveçëm, atëherë perceptimi i përgjithshëm do të jetë se bëhet fjalë për muzeun e një personi të vetëm. Nga hulumtimet dhe dokumentet që kam siguruar nga Ministria e Kulturës, të cilat shërbejnë si referencë për mënyrën e funksionimit të muzeve në Kosovë, rezulton se nuk ka muze të emërtuar me emra të përveçëm, jo vetëm në Republikën e Kosovës, por as në rajon dhe më gjerë. Një emërtim i tillë mund të krijojë perceptimin se muzeu i kushtohet vetëm një personaliteti, duke e lënë në hije veprimtarinë e tij të përgjithshme dhe të gjitha periudhat historike që përfaqëson. Dhe, edhe një çështje tjetër që dua ta theksoj: Muzeu i Qytetit ka probleme shumë më të mëdha sesa vetë çështja e emërtimit. Ky muze tash e sa vite funksionon pa pranim teknik, si nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, ashtu edhe nga Ministria e Kulturës. Ministria e Kulturës tash e tre vjet ka shprehur gatishmërinë për ta bërë pranimin teknik të muzeut. Mirëpo, Drejtoria e Urbanizmit e ka humbur projektin dhe, për shkak se projekti nuk po gjendet nga kjo drejtori, Ministria nuk po mund ta përfundojë procesin e legalizimit dhe të bëjë pranimin teknik të muzeut. E nderuara kryesuese, për të gjitha këto arsye, kërkoj nga ju që ta tërhiqni këtë propozim-vendim për emërtimin e muzeut dhe ta shqyrtoni mundësinë që ky emër t'i jepet një objekti apo një hapësire tjetër të përshtatshme. Kemi shkolla pa emra, kemi edhe objekte të tjera publike pa emërtime. Prandaj, ky emër mund t'i jepet një objekti tjetër, pa qenë e nevojshme të ndryshohet emërtimi i Muzeut të Qytetit. Dua t'ju them në fund dhe ju lus që të mos keq interpretohem. Unë jam e vogël përballë veprave dhe kontributit që kanë dhënë njerëzit në luftën për liri dhe për fjalën e lirë. Nuk kam asgjë kundër personit në fjalë, por shqetësimi im lidhet me aspektin ligjor të këtij propozimi. Nëse veprohet në këtë mënyrë, vendimi rrezikon të jetë i kundërligjshëm dhe, si rrjedhojë, muzeu mund të kthehet sërish në gjendjen në të cilën ndodhet aktualisht, pasi ende nuk e kemi funksionalizuar dhe nuk kemi arritur ta vëmë në shfrytëzim.

Drita Dibrani, anëtare kuvendit- lidhur me diskutimet rreth propozim-vendimit për emërtimin e Muzeut Historik dhe Etnografik të Komunës sonë, dua të theksoj se çdo nismë për vlerësimin dhe nderimin e figurave tona kombëtare është e vlefshme. Megjithatë, besoj se ndaj institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të veprojmë gjithmonë duke u bazuar në dokumente dhe vendime institucionale. Sipas vendimit të propozuar, muzeu ynë synohet të emërtohet me një emër të përveçëm. Megjithatë, kjo bie në kundërshtim të hapur me vetë identitetin dhe rrugëtimin e këtij institucioni. Të mos harrojmë se Komuna e Vushtrrisë, pak kohë më parë, ka shënuar solemnisht 21-vjetorin e themelimit të Muzeut të Vushtrrisë, duke vlerësuar punën e përbashkët të stafit, udhëheqëses Shukrane Begu dhe nxënësve në ruajtjen, promovimin dhe pasurimin e koleksioneve muzeore. Për 21 vjet me radhë, ky institucion ka funksionuar si muze i përgjithshëm historik dhe etnografik i qytetit, me misionin që të mbledhë dhe të prezantojë të gjithë trashëgiminë, traditën dhe kujtesën kolektive të qytetarëve dhe të trevave tona ndër shekuj. Heroi i Kosovës, Xhavit Haziri, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, i cili është i pacenueshëm dhe i dëshmuar. Ai meriton të nderohet në forma të tjera, përmes emërtimit të një shkolle, rruge apo sheshi, ashtu siç e përmendën edhe kolegët e mi, por jo duke i tjetërsuar karakterin një institucioni muzeor 21-vjeçar. Prandaj, ju bëj thirrje që ta shqyrtoni mirë këtë çështje, sepse në këtë Kuvend kemi pasur shumë vendime që janë kthyer nga MAPL-ja për

rishqyrtim. Nuk duhet të lejojmë që, për shkak të vendimeve të tilla, të krijohet përshtypja se ky Kuvend nuk di të marrë vendime në përputhje me procedurat dhe kërkesat ligjore.
Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-E para e punës, unë jam e parimit se, për të folur për dikë, duhet ta njohim veprën dhe jetën e atij personi. Besoj se këtu nuk kam nevojë të tregoj se kush ishte ai, por, nëse nuk e dini, atëherë mund të hulumtoni dhe të lexoni në histori. Do ta shihni se emri i tij është shumë më i madh sesa emërtimi i një këndi në Muzeun e Vushtrrisë. Prandaj, besoj se edhe një herë duhet ta potencoj se ne jemi pro këtij votimi. Edhe një herë ju lus që, për shkak të disa mendimeve tuaja personale, të mos i degradoni emrat e figurave të mëdha kombëtare, sepse këtë gjë nuk do ta lejoj asnjëherë në këtë Kuvend dhe në këtë foltore.
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- Duke besuar se askush nga anëtarët e Kuvendit që kanë folur deri më tani nuk ka për qëllim ta ulë apo ta degradojë emrin e një heroi kombëtar, siç është heroi "Xhavit Haziri", dua të theksoj se falë gjakut të heronjve, dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe të gjithë njerëzve që kanë kontribuar, ne sot e gëzojmë lirinë. Prandaj, në këtë çështje, e nderuara kolege, nuk ka nevojë të emocionoheni, sepse edhe ju keni vlera dhe meritoni respekt. Mund të diskutoni bashkërisht pas përfundimit të kësaj seance. U tha shumëçka rreth emërtimit të muzeut. Ajo që mund të konstatojmë deri më tani është se në asnjë qytet të Kosovës nuk ka muze të emërtuar me emra të përveçëm. Ne nuk jemi kundër emrit të "Xhavit Hazirit". Së dyti, sado që jam interesuar dhe kam hulumtuar, në Komunën e Vushtrrisë nuk ka asnjë institucion, qoftë shesh, shkollë, institucion tjetër apo rrugë, që mban emrin e këtij heroi. Pra, ky hero deri më tani ndoshta nuk është trajtuar në mënyrën e duhur dhe nuk i është dhënë vlerësimi që meriton. Ne e dimë se pjesën më të madhe të qeverisjes në Komunën e Vushtrrisë e keni pasur ju. Atëherë, pse deri më tani e keni lënë këtë hero pa ia kushtuar emrin e ndonjë institucioni? Duke u bazuar edhe në diskutimet e mëparshme, ku u përmend se kemi sheshe, shkolla dhe shumë rrugë pa emra, propozojmë që emri i tij të mos i vendoset muzeut. Emri i "Xhavit Hazirit" është shumë më i madh dhe meriton të trajtohet në një mënyrë tjetër. Prandaj, propozojmë që kjo çështje të shtyhet për njërën nga seancat e radhës, në mënyrë që të shqyrtohet mundësia e emërtimit të ndonjë shkolle.
Për shembull, kemi shkolla që mbajnë emra të fshatrave, si dhe shkolla të tjera që mund të shqyrtohen për këtë qëllim. Do të ishte shumë më e ndershme, më e dobishme dhe më përfaqësuese për familjen Haziri që emrin e tij ta mbante një shkollë, ku në dëftesat dhe diplomat e nxënësve do të shkruhej vazhdimisht emri i tij, sesa të vendosej në një muze, i cili mund të mbetet i mbyllur. Edhe më herët u tha se muzetë nuk emërtohen me emra të përveçëm. Prandaj, për hir të korrektësisë, kolegjialitetit dhe respektit të ndërsjellë, do të ishte mirë që të tërhiqet ky propozim dhe emri i heroit "Xhavit Haziri" t'i kushtohet një institucioni arsimor. Kështu do të ishte një zgjidhje më e qëlluar dhe do të mund të vazhdonim tutje.
Medina Bunjaku, drejtoresh e DKRS-së- vlerësoi se është fakt se ai ka lindur në Vushtrri, por kjo nuk do të thotë se nuk na bën krenarë edhe neve si qytetarë të Vushtrrisë. Gjithashtu, kundërshtoj jashtëzakonisht shumë shprehjen "importimi i personalitetit", sepse nuk ka aspak kuptim. Unë e falënderoj jashtëzakonisht shumë shefin e grupit të LDK-së, z. Berat, si dhe Vlerën nga PDK-ja. Vlen të theksohet se muzeu ka dy akte që ndërlidhen me funksionimin e tij: aktin e themelimit të Muzeut Historik dhe Etnografik dhe Rregulloren për mënyrën e funksionalizimit të muzeut. Muzeu vazhdon të mbetet i tillë, pra muze historik dhe etnografik, por tashmë propozohet që të emërtohet me emrin e një heroi të madh të çështjes kombëtare, siç është i ndjeri z. Xhavit Haziri. Po ashtu, këtij propozimi do t'ia bashkëngjisim edhe bazën ligjore, përkatësisht Ligjin nr. 02/L-57 për Institucionet Kulturore, nenin 19, konkretisht pikat 19.1 dhe 19.2, sipas të cilave institucioni mund të emërtohet me emrin e një personi të merituar, me pëlqimin e trashëgimtarëve të tij ose me pëlqimin e vetë personit, nëse është gjallë. Institucioni mund të emërtohet edhe me

emrin e një personi me rëndësi historike, kulturore dhe shkencore, vetëm me pëlqimin e trashëgimtarëve të tij dhe nëse emri i tij shfrytëzohet në mënyrë që të mos cenohet dinjiteti i atij personi. Besoj se, në këtë aspekt, jemi në rregull.

Pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje lëshoi sallën e mbledhjes. Në sallë mbetën vetëm 12 anëtarë të Kuvendit, numër ky i pamjaftueshëm për të siguruar kuorumin e nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes. Në këtë rast, kryesuesja e Kuvendit mori një pauzë prej 15 minutash për konsultime ndërmjet grupeve kuvendare. Pas konsultimeve, nuk u arrit ndonjë dakordim për votimin e kësaj pike të rendit të ditës. Në sallë ishin të pranishëm 15 anëtarë të Kuvendit, po ashtu kuorum i pamjaftueshëm për vazhdimin e punimeve dhe marrjen e vendimeve të plotfuqishme. Kësisoj, në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, kryesuesja e Kuvendit ndërpreu punimet e mbledhjes në orën 14:35 dhe njoftoj se për vazhdimin e mbledhjes do të njoftoheni me kohë.

Më datën 13 nëntor 2026 ditë e premte ora 14:40 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 30 tetor 2026, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 17 anëtarë të kuvendit, 14 anëtarë të kuvendit mungonin, kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme lidhur me pikat e rendit të ditës në renditje numërore pikat 5, 6,7,8,9 dhe10 të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.

Prezent në mbledhje janë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Blerina Shala, Diellza Pllana, Fidan Bejta, Pllumb Maliqi, Gentiana Rama, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Isak Uka, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Rrahim Ajeti, dhe Vlerë Tahiri.

Munguna: Betim Grabanica, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Mek Selaci, Stefan Markovic, Xhon Gubetini, dhe Ymer Haradinaj.

Vazhdimi i diskutimeve për pikën 5 të rendit të ditës Propozim – vendim për emërtimin e objektit të muzeut;

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit-duke diskutuar për figurën e heroit të Kosovës "Xhavit Haziri" vlerësoi: Ka njerëz që janë pjesë e historisë dhe ka njerëz që, me veprat dhe sakrificën e tyre, kontribuojnë në formësimin e saj. Xhavit Haziri ishte njëri prej atyre njerëzve që nuk e pritën lirinë, por ia kushtuan jetën përpjekjes për ta sjellë atë. I lindur më 3 shtator 1960, në fshatin Druar të Vushtrrisë, në familjen e Bajramit dhe Fahrie Hazirit, Xhaviti fëmijërinë dhe shkollimin i kaloi në Obiliq. Që në rini, përmes njohjes së historisë së popullit shqiptar, ai ndërtoi bindjen se liria dhe dinjiteti kombëtar nuk ishin vetëm ideale për të cilat duhej folur, por përgjegjësi për të cilat duhej vepruar. Dhe këtë bindje e dëshmoi gjatë gjithë jetës së tij. Në një kohë kur angazhimi për çështjen kombëtare kërkonte guxim të jashtëzakonshëm, Xhavit Haziri zgjodhi rrugën e veprimit dhe të organizimit. Nga demonstratat e vitit 1981, shpërndarja e materialeve atdhetare dhe organizimi i veprimtarëve, deri te përgjegjësitë më të larta në Lëvizjen Popullore të Kosovës, ai ishte pjesë e rëndësishme e rezistencës së organizuar shqiptare. Kontributi i tij nuk qëndronte vetëm në pjesëmarrjen në këto përpjekje, por edhe në aftësinë për të bashkuar njerëz, për të

ndërtuar struktura organizative dhe për të mbajtur gjallë veprimtarinë në rrethana të jashtëzakonshme. Ai ishte ndër veprimtarët që punuan për kalimin nga rezistenca e organizuar politike drejt përgatitjeve për rezistencë të armatosur, duke dhënë kontribut në krijimin e bërthamave të para që i paraprinë luftës çlirimtare. Për bindjet dhe veprimtarinë e tij, Xhavit Haziri u përball me përndjekje dhe burgosje të njëpasnjëshme. Vite të tëra të jetës së tij kaluan në burgje, larg familjes dhe larg lirisë për të cilën angazhohej. Por ajo që e karakterizon qëndresën e tij është fakti se as burgosjet dhe as përndjekjet nuk e larguan nga rruga që kishte zgjedhur. Pas çdo burgosjeje, ai iu kthye veprimit. Pas çdo përpjekjeje për ta ndalur, ai vazhdoi organizimin. Në këtë qëndresë qëndron një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së tij: bindja se idealet nuk dëshmohen vetëm në kohë të lehta, por sidomos atëherë kur mbrojtja e tyre kërkon sakrificë. Më 17 shtator 1998, Xhavit Haziri u rrëmbye në Prishtinë nga pjesëtarë të shërbimit sekret serb. Që nga ajo ditë, fati i tij mbetet i pazbardhur. Zhdukja e tij la pas një dhimbje që vazhdon, por nuk e fshiu veprën dhe kontributin e tij. Në vitin 2010, ai u dekorua me titullin Hero i Kosovës, si njohje e kontributit të tij atdhetar. Sot, kur para nesh kemi propozimin që Muzeu i Qytetit të Vushtrrisë të mbajë emrin e Xhavit Hazirit, besoj se duhet ta shohim këtë vendim përtej aktit formal të emërtimit. Sepse një qytet nuk e ndërton identitetin e tij vetëm përmes monumenteve, ndërtesave dhe institucioneve, por edhe përmes kujtesës që zgjedh të ruajë. Xhavit Haziri ishte bir i Vushtrrisë, por veprimtaria e tij i tejkaloi kufijtë e saj. Ai ia kushtoi jetën një kauze që përfshinte gjithë Kosovën dhe përpjekjen e popullit shqiptar për liri. Prandaj, emri i tij përfaqëson jo vetëm lidhjen me vendlindjen, por edhe vlerat e guximit, të qëndresës, të organizimit dhe të përkushtimit ndaj një qëllimi të përbashkët. Një muze është institucion i kujtesës. Është vendi ku e kaluara ruhet për t'u kuptuar nga e tashmja dhe për t'u përcjellë te brezat e ardhshëm. Dhe pikërisht për këtë arsye, besoj se emri i Xhavit Hazirit mbart një domethënie të veçantë për këtë institucion. Jo thjesht sepse ai ishte një figurë e rëndësishme e historisë sonë, por sepse jeta e tij na kujton se pas çdo periudhe historike qëndrojnë njerëz, vendime, përgjegjësi dhe sakrifica. Historia nuk është vetëm ajo që ka ndodhur. Është edhe ajo që ne kemi përgjegjësi të mos e harrojmë. Si anëtare e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, besoj se vendimet tona duhet të pasqyrojnë edhe përgjegjësinë që kemi ndaj trashëgimisë historike të qytetit. Ne sot gëzojmë të drejtën të diskutojmë, të propozojmë dhe të vendosim në institucione të lira. Kjo është një e drejtë që nuk duhet ta marrim si të mirëqenë, sepse liria dhe ndërtimi i institucioneve tona janë rezultat i përpjekjeve të shumë brezave. Xhavit Haziri ishte pjesë e atyre përpjekjeve. Ai nuk e pa lirinë e Kosovës si një ideal të largët, por si një përgjegjësi që kërkonte veprim në kohën e tij. Dhe sot, përgjegjësia jonë është që kontributi i njerëzve si ai të njihet, të dokumentohet dhe të ruhet me dinjitet. Ne nuk mund t'ia kthejmë Xhavit Hazirit vitet që kaloi në burg. Nuk mund ta zhbëjmë përndjekjen dhe as ta ndryshojmë fatin e tij të pazbardhur. Por mund të kujdesemi që emri dhe vepra e tij të mos humbasin në harresë. Për këtë arsye, e mbështes propozimin që Muzeu i Qytetit të Vushtrrisë të mbajë emrin e Heroit të Kosovës, Xhavit Haziri. Sepse nderimi i një figure historike nuk është vetëm një shprehje mirënjohjeje për të kaluarën. Është edhe një mesazh për të ardhmen, për vlerat që dëshirojmë t'i ruajmë dhe t'ua përcjellim brezave që vijnë. Dhe dua ta përmbyll me një mendim: Xhavit Haziri nuk e jetoi jetën duke kërkuar që një ditë emri i tij të vendosej mbi një institucion. Ai jetoi dhe veproi për një kohë kur ne do të kishim lirinë të vendosnim vetë për institucionet tona. Sot, në atë liri, kemi mundësinë ta nderojmë kontributin e tij.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit- Përshëndetje, kryetar, kryesues, nënkryetarë, anëtarë të kabinetit qeverisës dhe kolegë të nderuar të Kuvendit. Unë personalisht dola në foltore për një çështje që nuk ka të bëjë me atë se kush merr pjesë dhe si voton, sepse kjo është çështje dytësore. Problemin e kam me asamblistët e Lëvizjes Vetëvendosje. Nuk e di se si mundet një njeri, një asamblist, t'i

ikë përgjegjësisë së vet. Pa marrë parasysh se i kujt është Xhavit Haziri, sepse të gjithë e dimë që është babai i Çlirim Hazirit, kjo nuk duhet të jetë çështje diskutimi. Nuk më intereson as fakti se në cilën parti është Çlirim Haziri dhe as kush është ai politikisht. Mua më intereson jeta dhe vepra e Xhavit Hazirit. Sot, më mirë do të ishte që ata të qëndronin këtu, të diskutonin dhe të na tregonin se çfarë kundërshtimesh kanë dhe nëse kanë ndonjë propozim më të mirë. Ne jemi dëshmitarë të asaj se kemi kaluar nëpër shumë vështirësi. Gjatë mandateve të tyre janë emëruar emra të njerëzve që nuk kanë dhënë asnjë kontribut për Qytetin e Vushtrrisë. Megjithatë, nuk është dashur të veprohet kështu, duke u larguar nga salla. Secili mund ta ketë dhënë një kontribut për shtetin e Kosovës, por kjo nuk do të thotë se duhet t'i iket diskutimit dhe përgjegjësisë. Nuk ka pasur nevojë të largohen. Është dashur të ulen, të diskutojnë dhe t'i sqarojnë gjërat, në mënyrë që të gjithë qytetarët ta kuptojnë se për çfarë bëhet fjalë. Çështja tjetër është se dalin dhe, përmes Facebook-ut, na shesin moral, duke thënë se duhet të bëhet kjo punë, ajo punë dhe shumë gjëra të tjera. Por, me çfarë buxheti do të bëhen këto punë, kur ju vetë nuk e keni votuar buxhetin? Le t'ua tregojnë qytetarëve edhe këtë: ne i kemi ngritur këto çështje, por ju nuk e keni votuar buxhetin. Po të varej nga votat tuaja, buxheti nuk do të kalonte. Edhe qytetarët duhet ta dinë të vërtetën: kur duhet të vijnë, si duhet të vijnë dhe si duhet të përballen me përgjegjësitë e tyre, le të vijnë dhe të ballafaqohen këtu, në Kuvend. Në fund të fundit, për këtë jemi këtu.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota "për" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Muzeu Historik-Etnografik i Komunës së Vushtrrisë, i cili gjendet në objektin e ish-ambulantës së vjetër në monumentin e trahëgimis kulturore Shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit, emërohet me emrin e Heroit të Kosovës, "Xhavit Hazirit".

2. Emërtimi i Muzeut Historik-Etnografik i Komunës së Vushtrrisë, do të jetë "Muzeu Xhavit Haziri".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Informatë nëntëmujore për punën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

7. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.44640/26 për shtimin e emrit të z.Erzen/Hysen/Dedia në listën rezervë të rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë;

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- I nderuar kryetar, nënkryetar, anëtarë të kabinetit qeveritar, kolegë asamblistë dhe të dashur qytetarë. E kemi parë pikën e rendit të ditës që është kthyer për riemërtimin e kësaj rruge. Në shkresën, kryesuese, thuhet se, para se kjo çështje të vijë në Kuvend, Drejtoria e Urbanizmit duhet t'i drejtohet paraprakisht Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në mënyrë që të marrë miratimin e saj dhe më pas propozimi të sillet në Kuvend. Unë nuk e shoh të arsyeshme që të votohet shfuqizimi i kësaj pike, sepse kjo çështje nuk ka kaluar përfundimisht, por është

kthyer në rishqyrtim. Pra, paraprakisht, Drejtoria e Urbanizmit duhet t'i drejtohet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe, në momentin që merret miratimi, çështja të sillet sërish në Kuvend. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme që të veprohet në këtë mënyrë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 14 vota "për" 3 vota "abstenim" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.44640/26 i datës 24.10.2026 lidhur me shtimin e emrit të "z. Erzen/Hysen/Dedia" në listën rezervë të emrave të rrugëve për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë.

2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë obligon Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që emrin e "Erzen/Hysen/Dedia ta vendos në listën rezervë të rrugëve, konform legjislacionit në fuqi dhe peticionit të banorëve.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Raport mbi vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për muajin korrik 2026;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota "për" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, në Komunën e Vushtrrisë, për muajin korrik 2026.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (erërat e forta, breshëri dhe zjarret,), që kanë mbretëruar në periudhën e sipër-cekur, në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë, ka bërë vlerësimin e dëmeve nga era e fortë për periudhën korrik 2026, ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve, dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare të dëmeve në vlerë totale prej **2,227.40 € (dymijë e dyqind e njëzet e shtatë ero e katërdhjetë centë)**, dëme këto të shkuara në objekte private (shtëpi banimi), në ekonomi familjare dhe në bujqësi të cilat janë evidentuar dhe verifikuar nga komisioni profesional e të cilat janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raport.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale;

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së-Përshëndetje, kryesuese, kryetar, nënkryetar dhe të nderuar anëtarë të Kuvendit. Unë do të propozoja që kjo pikë e rendit të ditës të tërhiqet, për shkak se jemi në fund të vitit dhe jemi duke përgatitur një databazë të re për të gjitha pronat komunale. Po ashtu, për seancën e radhës kam propozuar edhe një vendim për shkëputjen e një kontrate e cila nuk është më aktive. Meqenëse duhet të përgatitet databaza e re, ekziston mundësia që, nëse votohet tani, të shkaktohen paqartësi apo dëmtime në këtë proces. Prandaj, propozoj që kjo çështje të lihet për vitin e ardhshëm. Unë jam për tërheqjen e kësaj pike, nëse edhe ju pajtoheni.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 17 vota "për" vendosi që Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në vitin e ardhshëm.

Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:56

Bastri Duraku	**Melihate Basholli-Latifi**
_____	**_____**
Procesmbajtës	**Kryesuese e Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Shërbime Publike

DATË:	11.11.2026
PËR:	KPF, Kuvendin e Komunës
PROPOZUES:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
HARTUES:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala
TEMA:	Përcjellja e Projekt-Rregullores për menaxhimin e parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë për shqyrtim dhe miratim

Të nderuar,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të Komunës dhe me qëllim të rregullimit të organizimit, menaxhimit dhe shfrytëzimit të parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë, ju përcjellim për shqyrtim Projekt-Rregulloren për organizimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
Ky dokument është hartuar nga Komisioni i themeluar me Vendimin nr. 02-60/26, të datës 06.02.2026, të Kryetarit të Komunës, në përputhje me Rregulloren (MAPL) nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.
Në kuadër të procesit të hartimit është zhvilluar edhe konsultimi publik, i cili ka përfshirë periudhën nga data 10.03.2026 deri më 26.03.2026, si dhe takimin publik të mbajtur më 23.03.2026. Gjatë këtij procesi nuk janë pranuar vërejtje apo sugjerime përmbajtësore lidhur me Projekt-Rregulloren.
Kjo Projekt-Rregullore ka për qëllim krijimin e një kornize të qartë dhe të qëndrueshme për organizimin dhe administrimin e parkingjeve publike, përcaktimin e kategorive dhe zonave tarifore, rregullimin e kushteve të shfrytëzimit, përcaktimin e përgjegjësive të organeve komunale dhe subjektit menaxhues, si dhe sigurimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të përdoruesve. Gjithashtu, Projekt-Rregullorja synon të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të hapësirave publike, rritjen e sigurisë dhe lehtësimin e qasjes për të gjithë përdoruesit, si dhe në organizimin më efikas të trafikut dhe parkimit në territorin e Komunës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij akti për interesin publik dhe menaxhimin e hapësirave publike komunale, propozojmë që Projekt-Rregullorja të shqyrtohet fillimisht nga Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe, pas shqyrtimit nga ky Komitet, t'i përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

Në mbështetje të dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më __.__.2026, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN, MENAXHIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

KAPITULLI I – DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe mënyrën e organizimit, administrimit, menaxhimit dhe shfrytëzimit të parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

2.1. shfrytëzimi racional dhe efikas i hapësirave publike për parkim;

2.2. rregullimi i organizimit dhe funksionimit të parkingjeve publike;

2.3. përmirësimi i qarkullimit dhe sigurisë në trafik;

2.4. sigurimi i qasjes së barabartë në hapësirat publike të parkimit;

2.5. krijimi i një sistemi transparent të tarifimit dhe pagesës;

2.6. mbrojtja e hapësirave për këmbësorë, persona me aftësi të kufizuara, biçikleta dhe përdorues të tjerë të rrugës; dhe

2.7. mbështetja e politikave të mobilitetit të qëndrueshëm në Komunën e Vushtrrisë.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për hapësirat publike të përcaktuara për parkim në territorin e Komunës së Vushtrrisë, përfshirë:

1.1. parkingjet publike në rrugë dhe jashtë rrugës;

1.2. parkingjet e përhershme dhe të përkohshme;

1.3. parkingjet e ndara në zona tarifore;

1.4. parkingjet për kategori të veçanta të përdoruesve;

1.5. hapësirat e parkimit pranë objekteve publike, kur ato administrohen nga Komuna; dhe

1.6. llojet e tjera të parkingjeve publike të përcaktuara me akt të organit kompetent.

2. Parkingjet private përfshihen në fushëveprimin e kësaj Rregulloreje për aq sa ato lidhen me hapësirën publike, sigurinë në trafik ose infrastrukturën publike dhe brenda kompetencave ligjore të Komunës.

Neni 3

Baza ligjore

1. Kjo Rregullore nxirret në mbështetje të:

1.1. Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;

1.2. Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;

1.3. Ligjit Nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor;

1.4. Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

1.5. Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

1.6. Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje,

1.7. Statutit të Komunës së Vushtrrisë; dhe

1.8. akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në këtë fushë.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e përcaktuar me legjislacionin në fuqi, përveç nëse në këtë nen përcaktohet ndryshe.

2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

2.1. **Parking**" është hapësira e përcaktuar dhe e rregulluar për parkimin e automjeteve

2.2. **"Vendparkim"** është hapësira e shënuar ose e përcaktuar për parkimin e një automjeti.

2.1. "**Parking publik**" është hapësira e përcaktuar dhe e rregulluar për parkimin e automjeteve, e cila është në pronësi ose administrim publik dhe është e destinuar për përdorim publik.

2.. "**Parking privat**" është hapësira e përcaktuar dhe e rregulluar për parkimin e automjeteve, e cila është në pronësi ose administrim privat.

2.3. "**Operator i parkingut**" është njësia organizative e Komunës, ndërmarrja publike ose subjekti tjetër i autorizuar ligjërisht për administrimin dhe menaxhimin operativ të parkingut.

2.4. **"Zona e parkingut"** është hapësira e përcaktuar me akt të Komunës, brenda së cilës zbatohen rregulla dhe tarifa të caktuara të parkimit.

2.5. **"Automjet"** është mjeti i përcaktuar si i tillë me legjislacionin në fuqi për trafikun rrugor.

2.6. **"Trotuar"** është sipërfaqja e rregulluar pranë rrugës, e destinuar posaçërisht për lëvizjen e këmbësorëve dhe e ndarë nga pjesa e rrugës për qarkullimin e automjeteve.

2.7. **"Parking me rampë"** është parkingu ku hyrja dhe dalja e automjeteve kontrollohen me rampë ose pajisje tjetër të ngjashme.

2.8. **"Parking për banorët rezidentë"** është parkingu ose pjesa e parkingut e përcaktuar për shfrytëzim nga banorët që plotësojnë kushtet e kësaj Rregulloreje.

2.9. **"Parking i rezervuar për biznese ose organizata"** është vendparkimi i përcaktuar për shfrytëzim nga biznesi ose organizata përkatëse, në pajtim me autorizimin dhe kushtet e përcaktuara.

2.10. **"Parkim me pagesë sipas kohëzgjatjes"** është shfrytëzimi i vendparkimit kundrejt pagesës për periudhën e përcaktuar.

2.11. **"Abonim"** është e drejta për shfrytëzimin e parkingut për një periudhë të caktuar, kundrejt pagesës dhe sipas kushteve të përcaktuara.

2.12. **"Tarifë e parkingut"** është shuma e miratuar nga organi kompetent për shfrytëzimin e vendparkimit publik.

2.13. **"Kontrollor i parkingut"** është punonjësi i operatorit që, brenda detyrave të tij, kontrollon pagesën dhe respektimin e kushteve të shfrytëzimit; ai nuk ushtron kompetenca inspektimi ose ndëshkimi përveç kur ato i janë dhënë shprehimisht me ligj.

2.14. **"Ndërmarrja Publike Lokale"** është ndërmarrja publike lokale Përparimi, e caktuar me aktin përkatës për menaxhimin e parkingjeve publike. Emërtimi i plotë dhe statusi juridik i saj shënohen sipas regjistrimit zyrtar.

2.15. **"Parking i rezervuar"** është vendparkimi i caktuar për përdorim nga një kategori ose subjekt i përcaktuar, në pajtim me këtë Rregullore.

2.16. **"Banor rezident"** është personi fizik me vendbanim të regjistruar në zonën përkatëse, i cili dëshmon plotësimin e kushteve të përcaktuara.

2.17. **"Automjet elektrik"** është automjeti që përdor energjinë elektrike për lëvizje, sipas legjislacionit në fuqi.

2.18. **"Park & Ride"** është sistemi ku automjeti parkohet në një hapësirë të përcaktuar dhe udhëtimi vazhdohet me transport publik, biçikletë ose formë tjetër të qëndrueshme të mobilitetit.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I PARKINGJEVE PUBLIKE

Neni 5

Përcaktimi dhe klasifikimi i parkingjeve publike

1. Parkingjet publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë përcaktohen nga Drejtoria për Shërbime Publike, pas vlerësimit të kushteve pronësore, urbanistike, teknike, të trafikut dhe të interesit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Rregullore.

2. Për secilin parking publik, Drejtoria për Shërbime Publike përcakton:

2.1. lokacionin dhe kufijtë e hapësirës së parkingut;

2.2. sipërfaqen dhe numrin e vendparkimeve;

2.3. kategorinë dhe destinimin e parkingut, përfshirë kategoritë e veçanta të parkingjeve dhe hapësirave të dedikuara për kategori të caktuara të përdoruesve;

2.4. zonën tarifore në të cilën përfshihet, sipas kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore;

2.5. orarin dhe kohëzgjatjen e lejuar të shfrytëzimit;

2.6. mënyrën e organizimit dhe administrimit të parkingut.

3. Zonat tarifore dhe lokacionet e parkingjeve që përfshihen në to përcaktohen nga Drejtoria për Shërbime Publike, në përputhje me kriteret e kësaj Rregulloreje. Ndryshimi i lokacioneve ose i klasifikimit të tyre në zona nuk mund të ndikojë në lartësinë e tarifave të miratuara nga Kuvendi i Komunës.

4. Tarifat për shfrytëzimin e parkingjeve publike, përfshirë tarifat sipas zonave, abonimet, parkingjet nëntokësore dhe sistemin Park & Ride, përcaktohen në Shtojcën I – Tabela e Tarifave, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

5. Ndryshimi i lokacionit, kufijve, kapacitetit, kategorisë ose organizimit të parkingut bëhet nga Drejtoria për Shërbime Publike, duke respektuar kompetencat e organeve të tjera komunale dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

6. Drejtoria për Shërbime Publike mban evidencën e parkingjeve publike, të lokacioneve, kapaciteteve dhe zonave tarifore, si dhe siguron publikimin e informatave përkatëse për qytetarët.

Neni 6

Llojet e parkingjeve publike

1. Parkingjet publike mund të jenë:

1.1. parkingje në rrugë;

1.2. parkingje jashtë rrugës;

1.3. parkingje sipërfaqësore, nëntokësore ose shumëkatëshe;

1.4. parkingje të përkohshme;

1.5. parkingje për banorë rezidentë;

1.6. parkingje të rezervuara;

1.7. parkingje për persona me aftësi të kufizuara;

1.8. parkingje ose hapësira karikimi për automjete elektrike;

1.9. parkingje për motoçikleta dhe hapësira për biçikleta;

1.10. parkingje "Park & Ride";

1.11. parkingje dhe hapësira të dedikuara për automjeteve taksi, përfshirë automjetet e operatorëve radio-taksi dhe

1.12. kategori të tjera të lejuara me ligj dhe të përcaktuara nga organi kompetent.

2. Kategoritë e përmendura në paragrafin 1 mund të kombinohen, nëse kjo është në përputhje me destinimin, sigurinë dhe organizimin e hapësirës.

Neni 7
Parkingjet për taksi dhe operatorët radio-taksi

1. Komuna mund të përcaktojë hapësira të veçanta në parkingjet publike për qëndrimin dhe pritjen e automjeteve të taksive, si dhe hapësira të dedikuara për organizimin e shërbimeve të operatorëve radio-taksi.

2. Lokacionet, numri i vendparkimeve, kapaciteti, orari dhe kushtet e shfrytëzimit të këtyre hapësirave përcaktohen nga organi kompetent i Komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Rregullore.

3. Shfrytëzimi i këtyre hapësirave lejohet vetëm për automjetet që plotësojnë kushtet ligjore për ushtrimin e veprimtarisë së transportit me taksi.

4. Operatorët radio-taksi mund t'i shfrytëzojnë hapësirat e dedikuara vetëm në bazë të autorizimit ose marrëveshjes përkatëse me Komunën, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga organi kompetent.

5. Ndalohet rezervimi, bllokimi ose kufizimi i qasjes në hapësirat publike të dedikuara për taksi nga operatorët ose personat e tjerë, pa autorizimin përkatës të organit kompetent të Komunës.

6. Tarifat për shfrytëzimin e këtyre hapësirave përcaktohen sipas tabelës së tarifave që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Zonat tarifore të parkingjeve publike

1. Për menaxhimin e parkingjeve publike, territori mund të ndahet në zona tarifore.

2. Zonat mund të klasifikohen si:

2.1. Zona I, zonë me kërkesë të lartë, që përfshinë unazën e brendshme të qytetit sipas PZHK-së; dhe

2.2. Zona II, zonë me kërkesë mesatare apo të ulët; jashtë unazës së brendshme.

3. Klasifikimi i lokacioneve të parkingjeve publike në zona tarifore bëhet nga Drejtoria për Shërbime Publike, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

4. Gjatë klasifikimit të lokacioneve në zona tarifore merren parasysh, ndër të tjera, kërkesa dhe shkalla e shfrytëzimit të parkingjeve, kapaciteti i vendparkimeve, afërsia me qendrën dhe shërbimet publike, nevojat e banorëve dhe bizneseve, si dhe objektivat e mobilitetit të qëndrueshëm.

5. Harta dhe lista e lokacioneve të parkingjeve sipas zonave tarifore përgatiten dhe përditësohen nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe bëhen publike për qytetarët.

Neni 9

Shënjimi i vendparkimeve

1. Vendparkimet shënohen me sinjalizim horizontal dhe vertikal në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi për sinjalizimin rrugor.

2. Vendparkimet për kategori të veçanta shënohen qartë me sinjalizim përkatës.

3. Ndryshimi i destinimit të një hapësire parkimi bëhet vetëm nga organi kompetent dhe pas vendosjes së sinjalizimit përkatës.

KAPITULLI III – ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

Neni 10

Organet përgjegjëse dhe kompetencat komunale

1. Kuvendi i Komunës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj:

1.1. miraton këtë Rregullore dhe aktet e tjera komunale për parkingjet;

1.2. miraton lartësinë e tarifave për shfrytëzimin e parkingjeve publike dhe abonimet, në përputhje me këtë Rregullore;

1.3. shqyrton planet dhe raportet për menaxhimin e parkingjeve; dhe

1.4. mbikëqyr zbatimin e politikave komunale në këtë fushë.

2. Kryetari i Komunës, në kuadër të kompetencave ligjore:

2.1. siguron zbatimin e akteve komunale;

2.2. koordinon veprimtarinë e drejtorive përgjegjëse;

2.3. i propozon Kuvendit politika dhe plane për përmirësimin e sistemit; dhe

2.4. lidh kontrata dhe ndërmerr veprime administrative brenda kompetencave ligjore.

3. Drejtoritë komunale përgjegjëse:

3.1. koordinojnë dhe monitorojnë sistemin e parkingjeve;

3.2. monitorojnë zbatimin e kontratave, marrëveshjeve dhe cilësinë e shërbimit;

3.3. bashkëpunojnë me ndërmarrjen, operatorët dhe institucionet kompetente; dhe

3.4. hartojnë raporte dhe propozojnë masa për përmirësim.

Neni 11

Menaxhimi i parkingjeve publike

1. Menaxhimi i parkingjeve publike mund të kryhet drejtpërdrejt nga Komuna, përmes ndërmarrjes publike lokale ose përmes operatorit tjetër të përzgjedhur dhe autorizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Të drejtat, detyrimet, standardet e shërbimit, raportimi, mirëmbajtja dhe përgjegjësitë financiare të operatorit përcaktohen në aktin ose kontratën përkatëse.

3. Operatorit nuk mund t'i delegohen kompetenca publike përveç nëse një delegim i tillë lejohet shprehimisht me ligj.

Neni 12

Detyrat e operatorit përgjegjës

1. Operatori, brenda kompetencave të përcaktuara me ligj dhe me aktin e menaxhimit, ka për detyrë:

1.1. të sigurojë funksionimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve;

1.2. të sigurojë funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve të pagesës;

1.3. të evidentojë pagesat dhe abonimet;

1.4. të informojë përdoruesit për tarifat, orarin, mënyrat e pagesës dhe kushtet e shfrytëzimit;

1.5. të mbajë evidencë të saktë dhe të verifikueshme për shfrytëzimin dhe të hyrat;

1.6. të mirëmbajë sinjalizimin, pajisjet dhe infrastrukturën që i janë besuar;

1.7. të pranojë dhe trajtojë kërkesat dhe ankesat për shërbimin brenda kompetencave të veta;

1.8. të ruajë dokumentacionin përkatës;

1.9. të zbatojë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale; dhe

1.10. t'i raportojë Komunës sipas afateve dhe formës së përcaktuar në aktin e menaxhimit.

KAPITULLI IV

PAGESA DHE TARIFAT

Neni 13

Detyrimi për pagesë

1. Shfrytëzimi i parkingut publik që është përcaktuar si parking me pagesë bëhet kundrejt tarifës së miratuar.

2. Pagesa llogaritet sipas zonës, kohëzgjatjes, kategorisë së përdoruesit dhe kushteve të përcaktuara në aktin përkatës.

3. Përjashtimet nga pagesa zbatohen vetëm kur parashihen me ligj ose me nenin vijues të këtij akti të miratuar nga organi kompetent.

Neni 14

Kategoritë e liruara nga obligimi i pagesës për parking

1.Nga obligimi për pagesën e shfrytëzimit të parkingjeve publike të menaxhuara nga Komuna e Vushtrrisë ose nga subjekti i autorizuar për menaxhimin e tyre, lirohen kategoritë në vijim:

1.1. automjetet zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare;

1.2. automjetet diplomatike dhe konsullore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

1.3. automjetet që transportojnë persona me aftësi të kufizuara, kur personi përkatës ndodhet në automjet, përfshirë rastet kur drejtohen nga vetë personi ose nga shoqëruesi i

tij, me kusht që të dëshmohet statusi përkatës dhe të shfrytëzohen vendparkimet e dedikuara, kur ato janë të përcaktuara;

1.4. automjetet zyrtare të shërbimeve emergjente, përfshirë Policinë e Kosovës, shërbimin e zjarrfikësve dhe shërbimet e urgjencës mjekësore, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare;

1.5. automjetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare me karakter emergjent ose të sigurisë publike;

1.6. automjetet e personave me status të invalidit të luftës, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, kur shfrytëzojnë vendparkimet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

2. Për përfitimin e lirimit nga pagesa, kategoritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë në kategorinë e liruar dhe lidhjen e automjetit me atë kategori.

3. Subjekti përgjegjës për menaxhimin e parkingjeve publike administron evidencën e automjeteve të liruara nga pagesa dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga organi kompetent i Komunës.

4. Lirimi nga pagesa vlen vetëm për automjetin dhe kategorinë për të cilën është miratuar, sipas kushteve të këtij neni, dhe nuk krijon të drejtë për rezervimin ose shfrytëzimin ekskluziv të vendparkimit.

5. Lirimi nga pagesa nuk zbatohet për parkingjet private ose për parkingjet që menaxhohen nga operatorë të tjerë, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me ligj ose marrëveshje përkatëse.

Neni 15

Mënyrat e pagesës

1. Pagesa mund të kryhet përmes:

1.1. aparateve automatike;

1.2. aplikacioneve elektronike;

1.3. shërbimit SMS;

1.4. kartelave bankare ose mjeteve të tjera elektronike;

1.5. platformave të autorizuara;

1.6. pagesës me para të gatshme te inkasanti, kur kjo mënyrë ofrohet; dhe

1.7. abonimeve, sipas kushteve të kësaj Rregulloreje.

2. Mënyrat konkrete të pagesës për secilin parking bëhen të ditura për përdoruesit nga operatori.

3. Operatori siguron funksionimin e rregullt të sistemeve të pagesës dhe ofron dëshmi të pagesës sipas mënyrës së përdorur.

Neni 16

Orari i pagesës dhe ditët pa pagesë

1. Pagesa për shfrytëzimin e parkingjeve publike bëhet brenda orarit të përcaktuar për secilën zonë ose kategori të parkingut, në përputhje me orarin e miratuar dhe të publikuar për përdoruesit.

2. Pagesa për shfrytëzimin e parkingjeve publike nuk aplikohet të shtunave të dielave dhe gjatë festave zyrtare në Republikën e Kosovës, përveç rasteve kur për kategori të caktuara të parkingjeve përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore.

3. Orari i pagesës, ditët pa pagesë dhe përjashtimet eventuale bëhen të ditura përmes sinjalizimit dhe njoftimeve të vendosura në parkingjet përkatëse.

Neni 17

Tarifat e parkingjeve publike

1. Për shfrytëzimin e parkingjeve publike me pagesë zbatohen tarifat e përcaktuara në Shtojcën I – Tabela e Tarifave, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

2. Kuvendi i Komunës miraton lartësinë e tarifave për shfrytëzimin e parkingjeve publike, përfshirë tarifat sipas zonave, abonimet, parkingjet nëntokësore dhe sistemin Park & Ride.

3. Tarifat zbatohen sipas kategorisë së parkingut, zonës, njësisë së pagesës dhe periudhës së shfrytëzimit, në përputhje me Shtojcën I.

4. Drejtoria për Shërbime Publike përcakton dhe ndryshon klasifikimin e lokacioneve të parkingjeve në zona tarifore, në përputhje me kriteret e kësaj Rregulloreje, pa ndryshuar lartësinë e tarifave të miratuara nga Kuvendi i Komunës.

5. Ndryshimi i lartësisë së tarifave bëhet vetëm përmes ndryshimit dhe plotësimit të kësaj Rregulloreje, sipas procedurës ligjore për miratimin e akteve komunale.

Neni 18

Informimi për tarifat dhe kushtet e shfrytëzimit

1. Tarifat dhe kushtet e shfrytëzimit publikohen dhe vendosen në vende të dukshme në hyrje ose në afërsi të parkingut.

2. Informacioni përmban së paku tarifën, orarin, periudhën e aplikimit të tarifës, kohëzgjatjen maksimale, mënyrat e pagesës dhe rregullat e shfrytëzimit.

3. Operatori siguron që informacioni të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i përditësuar.

Neni 19

Kohëzgjatja e parkimit

1. Në zonat ku zbatohet kufizim kohor, përcaktohet kohëzgjatja maksimale e parkimit.

2. Kohëzgjatja caktohet sipas zonës dhe qëllimit të parkingut dhe bëhet e ditur me sinjalizim ose njoftim të dukshëm.

3. Operatori nuk mund të ndryshojë në mënyrë të njëanshme kohëzgjatjen ose kushtet e miratuara.

KAPITULLI V

ABONIMET

Neni 20

Llojet e abonimeve

1. Sipas kohëzgjatjes, mund të lëshohen abonime ditore, javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, nëse janë paraparë në tabelën e tarifave.

2. Sipas kategorisë së përdoruesit, mund të përcaktohen abonime për banorë rezidentë, persona fizikë jorezidentë, biznese, persona juridikë, institucione publike, punonjës ose kategori të tjera të miratuara nga organi kompetent.

3. Operatorit nuk i lejohet të krijojë kategori të reja abonimi ose të përcaktojë tarifa të reja pa miratim nga organi kompetent.

Neni 21

Abonimi për banorët rezidentë

1. Banorëve që jetojnë në zonën përkatëse mund t'u lëshohet abonim rezident, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara.

2. Aplikuesi dëshmon vendbanimin dhe lidhjen juridike me automjetin, si dhe paraqet dokumentet e tjera të kërkuara në mënyrë të ligjshme.

3. Abonimi lëshohet për automjetin e identifikuar me targën e regjistrimit dhe vlen vetëm për zonën, kategorinë dhe periudhën për të cilën është lëshuar.

4. Abonimi rezident nuk garanton vendparkim individual, përveç kur vendparkimi është caktuar shprehimisht si i rezervuar me akt të organit kompetent.

5. Një abonim vlen për një automjet në të njëjtën kohë. Ndërrimi i automjetit bëhet pas njoftimit dhe verifikimit nga operatori.

6. Abonimi është i vlefshëm nga data e përcaktuar në dokumentin ose sistemin elektronik deri në përfundimin e periudhës së paguar.

7. Tarifat dhe kushtet e abonimit përcaktohen në Shtojcën II dhe në aktet përkatëse të miratuara ligjërisht.

Neni 22

Abonimi për biznese dhe institucione

1. Bizneset, personat juridikë dhe institucionet mund të aplikojnë për abonim në zonat ku lejohet një gjë e tillë.

2. Lëshimi i abonimeve varet nga kapaciteti i parkingut dhe nga numri i vendparkimeve të përcaktuara për këtë kategori.

3. Kushtet, dokumentacioni, kohëzgjatja dhe tarifat përcaktohen në aktin përkatës dhe në tabelën e tarifave.

KAPITULLI VI

PARKINGJET E REZERVUARA DHE KATEGORITË E VEÇANTA

Neni 23

Parkingjet e rezervuara

1. Vendparkimet mund të rezervohen për qëllime të arsyeshme dhe në pajtim me interesin publik, sigurinë në trafik dhe legjislacionin në fuqi.

2. Rezervimi mund të bëhet për institucionet publike, shërbimet emergjente, ngarkim-shkarkim, shërbime publike ose kategori të tjera të lejuara me ligj.

3. Vendparkimet për persona me aftësi të kufizuara dhe hapësirat e karikimit për automjete elektrike rregullohen edhe sipas dispozitave të veçanta përkatëse.

4. Rezervimi miratohet nga organi kompetent dhe shënohet qartë. Ai nuk mund të pengojë sigurinë në trafik ose qarkullimin e këmbësorëve.

Neni 24

Parkingjet për persona me aftësi të kufizuara

1. Në parkingjet publike sigurohen vendparkime për persona me aftësi të kufizuara në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi.

2. Vendparkimet shënohen qartë me sinjalizim përkatës.

3. Shfrytëzimi lejohet vetëm nga personat ose automjetet që plotësojnë kushtet ligjore për këtë kategori.

Neni 25

Parkingjet për automjete elektrike

1. Komuna mund të përcaktojë vendparkime për automjete elektrike dhe pika për karikim.

2. Kushtet e përdorimit, kohëzgjatja dhe tarifat për karikim, nëse aplikohen, bëhen të ditura në vendin përkatës.

3. Hapësira e caktuar për karikim nuk shfrytëzohet si vendparkim i zakonshëm në kundërshtim me sinjalizimin dhe kushtet e publikuara.

Neni 26

Parkingjet për motoçikleta dhe biçikleta

1. Komuna mund të përcaktojë hapësira të veçanta për motoçikleta dhe biçikleta.

2. Këto hapësira organizohen në mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve, qasjen për persona me aftësi të kufizuara ose qarkullimin e automjeteve.

KAPITULLI VII

PARK & RIDE DHE MOBILITETI I QËNDRUESHËM

Neni 27

Park & Ride

1. Komuna mund të krijojë parkingje "Park & Ride" në hyrje të qytetit ose në lokacione të përshtatshme.

2. Qëllimi i tyre është zvogëlimi i trafikut në zonën qendrore dhe nxitja e përdorimit të transportit publik dhe formave të tjera të qëndrueshme të mobilitetit.

3. Organizimi, orari dhe tarifat përcaktohen nga organi kompetent dhe publikohen për përdoruesit.

Neni 28

Integrimi me politikat e mobilitetit

Menaxhimi i parkingjeve, sa herë që është e zbatueshme, harmonizohet me planin e mobilitetit urban dhe dokumentet e tjera të planifikimit të Komunës.

KAPITULLI VIII

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRDORUESVE

Neni 29

Të drejtat e përdoruesit

1. Përdoruesi i parkingut publik ka të drejtë:

1.1. të informohet për tarifat dhe kushtet e shfrytëzimit;

1.2. ta shfrytëzojë parkingun në përputhje me kushtet e përcaktuara;

1.3. të marrë dëshmi për pagesën;

1.4. të paraqesë kërkesë ose ankesë;

1.5. të kërkojë korrigjimin e gabimeve të evidentuara; dhe

1.6. të trajtohet në mënyrë të barabartë.

Neni 30

Detyrimet e përdoruesit

1. Përdoruesi i parkingut publik është i detyruar:

1.1. të respektojë sinjalizimin dhe udhëzimet e ligjshme;

1.2. të paguajë tarifën e zbatueshme;

1.3. të parkojë vetëm në vendin e përcaktuar;

1.4. të mos pengojë qarkullimin e automjeteve ose këmbësorëve;

1.5. të mos shfrytëzojë pa të drejtë vendparkimet e rezervuara;

1.6. të respektojë kohëzgjatjen e lejuar; dhe

1.7. të mos dëmtojë pajisjet ose infrastrukturën e parkingut.

Neni 31

Ndalesat

1. Në hapësirat e parkingjeve publike ndalohet:

1.1. parkimi jashtë hapësirave të shënuara ose të përcaktuara;

1.2. zënia ose shfrytëzimi pa autorizim i vendparkimeve të rezervuara;

1.3. dëmtimi, shkatërrimi ose keqpërdorimi i pajisjeve dhe infrastrukturës;

1.4. manipulimi ose keqpërdorimi i sistemit të pagesës;

1.5. vendosja pa autorizim e pengesave fizike në vendparkime;

1.6. përdorimi i dokumenteve, lejeve, kartelave ose abonimeve të falsifikuara, të pavlefshme ose të keqpërdorura; dhe

1.7. veprimet e tjera të ndaluara me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IX

KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA

Neni 32

Kontrolli i pagesës

1. Kontrolli i pagesës dhe respektimit të kushteve të shfrytëzimit kryhet nga personat ose organet e autorizuara, brenda kompetencave të përcaktuara me ligj.

2. Kontrolli mund të kryhet përmes verifikimit fizik, pajisjeve elektronike dhe sistemeve të automatizuara të lejuara me ligj.

3. Punonjësit e operatorit mund të kryejnë vetëm detyrat operative që u janë caktuar ligjërisht dhe nuk mund të ushtrojnë kompetenca publike pa bazë të shprehur ligjore.

Neni 33

Evidentimi i shkeljeve

1. Shkeljet evidentohen dhe dokumentohen nga personat ose organet e autorizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Evidenca përmban, së paku, datën dhe kohën, lokacionin, targën e automjetit, përshkrimin e shkeljes dhe identifikimin e personit ose organit që e ka konstatuar.

3. Evidentimi elektronik lejohet kur kryhet për qëllime të ligjshme, me masa të përshtatshme sigurie dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 34

Kompetencat e inspektimit

1. Inspektimi, konstatimi zyrtar i kundërvajtjeve dhe shqiptimi i masave kryhen vetëm nga organet dhe personat që kanë kompetencë të shprehur me ligj.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Rregulloreje nuk mund të interpretohet si bazë për krijimin, zgjerimin ose delegimin e kompetencave përtej asaj që lejon ligji.

KAPITULLI X

AUTOMJETET E PARKUARA NË KUNDËRSHTIM ME RREGULLAT

Neni 35

Masat për shkeljet e rregullave të parkimit

Për automjetet e parkuara në kundërshtim me këtë Rregullore zbatohen vetëm masat e parashikuara me legjislacionin në fuqi, nga organet kompetente dhe sipas procedurës përkatëse.

Neni 36

Bllokimi dhe zhvendosja

1. Bllokimi, zhvendosja dhe largimi i automjeteve kryhen vetëm nga organet ose subjektet e autorizuara ligjërisht dhe sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2. Komuna duhet të organizojë ose sigurojë shërbime të tilla në bashkëpunim me organet kompetente, vetëm brenda kompetencave të saj.

3. Shpenzimet për bllokim, zhvendosje, transport ose ruajtje i bart personi përgjegjës vetëm kur një detyrim i tillë parashihet me legjislacionin në fuqi.

Neni 37

Automjetet e braktisura

1. Automjetet e braktisura në hapësirat publike trajtohen sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Komuna, në bashkëpunim me organet kompetente, mund të evidentojë dhe të njoftojë për automjetet e braktisura dhe të iniciojë procedurat përkatëse.

3. Largimi, zhvendosja dhe ruajtja e tyre kryhen vetëm nga organet ose subjektet e autorizuara.

KAPITULLI XI

ANKESAT

Neni 38

E drejta për ankesë

1. Përdoruesi ka të drejtë të paraqesë ankesë lidhur me pagesën, abonimin, funksionimin e sistemit, cilësinë e shërbimit ose dokumentimin e një shkeljeje.

2. Ankesat për cilësinë e shërbimit paraqiten te operatori ose njësia përgjegjëse sipas procedurës së publikuar. Ankesat kundër vendimeve ose masave administrative paraqiten te organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 39

Shqyrtimi i ankesave

1. Ankesat shqyrtohen nga organi ose subjekti kompetent brenda afateve dhe sipas procedurës së përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

2. Efekti i ankesës ndaj ekzekutimit të një vendimi ose mase përcaktohet nga legjislacioni përkatës.

3. Kur konstatohet gabim teknik ose administrativ, ndërmerren masa për korrigjimin e tij dhe njoftohet ankuesi.

KAPITULLI XII

TË HYRAT DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Neni 40

Të hyrat nga parkingjet

1. Të hyrat nga shfrytëzimi i parkingjeve publike arkëtohen, evidentohen dhe administrohen nga subjekti përgjegjës për menaxhimin e parkingjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktin ose kontratën përkatëse të menaxhimit.

2. Kur menaxhimi i është besuar ndërmarrjes publike, të hyrat dhe shpenzimet nga ky aktivitet regjistrohen në evidencat financiare të ndërmarrjes, sipas legjislacionit dhe rregullave përkatëse të kontabilitetit.

3. Ndërmarrja i raporton Komunës për të hyrat e arkëtuara, shpenzimet, detyrimet ndaj Komunës kur janë përcaktuar dhe treguesit e tjerë financiarë, në intervalet e përcaktuara në aktin e menaxhimit.

4. Transferet ose ndarjet e të hyrave ndërmjet ndërmarrjes dhe Komunës bëhen vetëm në bazë të legjislacionit dhe aktit ose kontratës përkatëse.

KAPITULLI XIII

TEKNOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Neni 41

Sistemet elektronike

1. Komuna ose operatori mund të përdorë sisteme elektronike për pagesa, abonime, kontroll të shfrytëzimit, raportim, informim të përdoruesve dhe analizë të kapaciteteve.

2. Sistemet duhet të sigurojnë saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, sigurinë e informacionit dhe funksionimin e rregullt të shërbimit.

3. Qasja në të dhëna kufizohet sipas detyrave të autorizuara. Të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllime të përcaktuara dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet përkatëse.

2. Të dhënat e mbledhura përmes sistemeve të parkingut nuk përdoren për qëllime të tjera, përveç kur kjo lejohet me ligj.

3. Komuna dhe operatori përcaktojnë përgjegjësitë për qasje, ruajtje, siguri dhe fshirje të të dhënave në pajtim me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI XIV

PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I PARKINGJEVE

Neni 43

Plani dhe evidenca e parkingjeve

1. Njësia organizative përgjegjëse e Komunës administron dhe përditëson planin dhe evidencën e parkingjeve publike, përfshirë hartën e lokacioneve.

2. Evidenca përmban së paku lokacionin, kapacitetin, numrin e vendparkimeve, kategorinë, zonën, tarifën, operatorin dhe gjendjen teknike.

3. Operatori i ofron Komunës të dhënat dhe njoftimet për ndryshimet që ndikojnë në saktësinë e evidencës.

Neni 44

Vlerësimi i nevojave

1. Për planifikimin, zgjerimin ose riorganizimin e parkingjeve, Komuna vlerëson nevojat e popullsisë, zhvillimin urban dhe organizimin e trafikut.

2. Vlerësimi merr parasysh së paku:

2.1. dendësinë e popullsisë;

2.2. aktivitetet ekonomike dhe objektet publike;

2.3. qendrat e shërbimeve;

2.4. gjendjen e trafikut dhe shkallën e shfrytëzimit të parkingjeve;

2.5. nevojat e këmbësorëve dhe personave me aftësi të kufizuara;

2.6. transportin publik;

2.7. zhvillimin urban; dhe

2.8. objektivat e mobilitetit të qëndrueshëm.

Neni 45

Ndryshimi i destinimit

Ndryshimi i destinimit të parkingut publik bëhet nga organi kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e planifikimit.

KAPITULLI XV

Neni 46

Parkingjet publike në zonat e banimit kolektive

1. Ky kapitull përcakton kushtet dhe mënyrën e organizimit, administrimit dhe shfrytëzimit të parkingjeve publike në zonat e banimit kolektiv në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
2. Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen për:

   2.1. hapësirat publike të parkimit që gjenden ndërmjet ndërtesave të banimit kolektiv ose në afërsi të tyre dhe që janë në pronësi ose administrim të ligjshëm të Komunës;

   2.2. hapësirat e parkimit brenda parcelave të ndërtesave të banimit kolektiv, të cilat janë në pronësi private ose në bashkëpronësi të pronarëve të njësive banesore, në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi dhe pa cenuar të drejtat pronësore.

3. Përfshirja e një hapësire në këtë kapitull nuk nënkupton vetvetiu se ajo është parking publik ose se Komuna ka të drejtë ta administrojë atë.

Neni 47

Parkingjet publike në zonat e banimit kolektiv

1. Hapësirat e parkimit në zonat e banimit kolektiv, të cilat janë pronë publike komunale ose për të cilat Komuna ka të drejtë të ligjshme administrimi, mund të përcaktohen si parkingje publike në bazë të vendimit të organit kompetent.
2. Para përcaktimit të tyre si parkingje publike, organi kompetent i Komunës verifikon:

   2.1. statusin pronësor dhe kadastral të parcelës;

   2.2. destinimin urbanistik dhe përputhshmërinë me dokumentet e planifikimit hapësinor;

   2.3. kapacitetin dhe organizimin e vendparkimeve;

   2.4. qasjen për këmbësorë, personat me aftësi të kufizuara dhe automjetet emergjente;

   2.5. ndikimin në qarkullimin dhe sigurinë e trafikut, si dhe në hapësirat e gjelbra dhe këndet e lojërave.

3. Parkingjet publike mund t'i jepen në menaxhim ndërmarrjes publike lokale N.P.L. "Përparimi" Sh. A. ose operatorit tjetër të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimin përkatës të Komunës.
4. Vendimi për organizimin e parkingut përcakton, sipas rastit, numrin e vendparkimeve, orarin e shfrytëzimit, kategoritë e përdoruesve, tarifat, mënyrën e pagesës dhe kushtet e administrimit.
5. Në parkingjet publike në zonat e banimit kolektiv, Komuna mund të përcaktojë kushte të veçanta të shfrytëzimit për banorët rezidentë të ndërtesave përkatëse, përmes lejeve ose abonimeve, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me këtë Rregullore.
6. Pajisja me leje ose abonim për banorët rezidentë u mundëson atyre shfrytëzimin e parkingut sipas kushteve të përcaktuara, por nuk u krijon të drejtë pronësore mbi vendparkimin dhe as të drejtë ekskluzive në një vendparkim të caktuar, përveç rasteve kur kjo e drejtë përcaktohet shprehimisht me një bazë tjetër juridike.

Neni 48

Lejet dhe abonimet për banorët rezidentë

1. Në parkingjet publike të zonave të banimit kolektiv, banorëve rezidentë mund t'u lëshohet leje ose abonim për shfrytëzimin e parkingut, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Komuna.
2. Përfitues të lejes ose abonimit mund të jenë personat që dëshmojnë se kanë vendbanimin në ndërtesën ose zonën përkatëse dhe se automjeti për të cilin kërkohet leja plotëson kushtet e përcaktuara.
3. Procedura e aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e lejes, tarifat, ripërtëritja dhe kushtet e anulimit përcaktohen me aktin përkatës të Komunës ose me procedurat e miratuara në bazë të kësaj Rregulloreje.
4. Dhënia e lejeve ose abonimeve duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe sipas kritereve të njëjta për personat që gjenden në rrethana të krahasueshme.
5. Leja ose abonimi është personal ose i lidhur me automjetin, sipas kushteve të përcaktuara, dhe nuk mund t'i bartet personit tjetër apo të përdoret për automjet tjetër pa autorizimin përkatës nga menaxhuesi i parkingut.
6. Leja e rezidentit nuk garanton vendparkim të lirë në çdo kohë, përveç nëse vendimi përkatës përcakton shprehimisht rezervimin e një vendparkimi të caktuar dhe ekziston bazë juridike për këtë.

Neni 49

Parkingjet brenda parcelave private ose në bashkëpronësi

1. Hapësirat e parkimit brenda parcelave të ndërtesave të banimit kolektiv, të cilat janë në pronësi private ose në bashkëpronësi të pronarëve të njësive banesore, administrohen nga pronarët, bashkëpronarët ose organi i autorizuar për administrimin e ndërtesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Komuna dhe ndërmarrja publike lokale N.P.L. "Përparimi" Sh. A. nuk mund t'i përfshijnë këto hapësira në sistemin e parkingjeve publike, t'i tarifojnë ose t'ia kalojnë menaxhimin një operatori pa bazë të vlefshme juridike dhe pa respektuar të drejtat e pronarëve.
3. Në rastet kur pronarët ose organi i autorizuar për administrimin e ndërtesës kërkojnë që parkingu të menaxhohet nga Komuna, ndërmarrja publike ose operatori tjetër, një menaxhim i tillë mund të realizohet vetëm në bazë të marrëveshjes së vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Marrëveshja nga paragrafi 3 i këtij neni duhet të përcaktojë së paku:

   4.1. palët kontraktuese dhe bazën juridike të përfaqësimit të pronarëve;

   4.2. hapësirën dhe numrin e vendparkimeve që përfshihen në menaxhim;

   4.3. kohëzgjatjen dhe mënyrën e administrimit;

   4.4. tarifat dhe mënyrën e përdorimit të të hyrave;

   4.5. përgjegjësitë për mirëmbajtjen, sigurinë dhe dëmet eventuale;

   4.6. kushtet dhe procedurën e përfundimit të marrëveshjes.

5. Menaxhimi i parkingut sipas këtij neni nuk mund të ndryshojë statusin pronësor të parcelës ose të vendparkimeve dhe as të cenojë të drejtat e pronarëve që nuk kanë dhënë pëlqimin në mënyrën e kërkuar me ligj.
6. Nëse hapësira e parkimit është pronë e përbashkët, vendimet për dhënien e saj në menaxhim, ndryshimin e destinimit ose vendosjen e kushteve të reja të shfrytëzimit merren nga organet kompetente të pronarëve, sipas shumicës dhe procedurave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 50

Mbrojtja e hapësirave të përbashkëta dhe qasjes publike

1. Gjatë organizimit dhe menaxhimit të parkingjeve në zonat e banimit kolektiv duhet të sigurohet mbrojtja e hapësirave të gjelbra, shtigjeve për këmbësorë, këndeve të lojërave, hyrjeve të ndërtesave dhe qasjes për automjetet emergjente.
2. Ndalohet shndërrimi i hapësirave të gjelbra, shtigjeve për këmbësorë ose hapësirave të tjera me destinim të veçantë në vendparkime, pa lejet dhe vendimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Ndalohet vendosja e pengesave, rezervimi i paautorizuar i vendparkimeve ose kufizimi i qasjes në parkingjet publike.
4. Për shkeljet e dispozitave të këtij kapitulli zbatohen masat dhe procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Rregullore, sipas kompetencave të organeve përkatëse.

KAPITULLI XVI

PARKINGJET PRIVATE DHE PUBLIKO-PRIVATE

Neni 51

Parkingjet private

1. Parkingjet private organizohen dhe shfrytëzohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumentet e planifikimit hapësinor, kushtet teknike dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2. Organizimi dhe shfrytëzimi i parkingjeve private si veprimtari afariste bëhet nga personat juridikë të regjistruar për veprimtarinë përkatëse dhe të pajisur me lejen e kërkuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, kur një leje e tillë kërkohet me legjislacionin në fuqi.

3. Regjistrimi i biznesit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) nuk e zëvendëson lejen për ushtrimin e veprimtarisë së parkingut, kur pajisja me leje kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.

4. Pronari ose operatori është përgjegjës për organizimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e parkingut, si dhe për respektimin e kushteve dhe kritereve mbi bazën e të cilave është pajisur me leje.

5. Kur organizimi ose shfrytëzimi i parkingut prek ose ndikon në rrugët publike, trotuaret, qasjen në infrastrukturën publike apo sigurinë e komunikacionit, operatori është i detyruar të sigurojë paraprakisht pëlqimet dhe lejet e nevojshme nga organet kompetente.

Neni 52

Kushtet dhe kriteret për organizimin e parkingjeve private

1. Për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingut privat duhet të plotësohen kushtet si në vijim:

1.1. hapësira të jetë në përputhje me destinimin e përcaktuar në dokumentet e planifikimit hapësinor;

1.2. të dëshmohet pronësia ose e drejta ligjore për shfrytëzimin e hapësirës;

1.3. parkingu të ketë së paku njëzet (20) vendparkime;

1.4. të sigurohet qasje direkte dhe e përshtatshme në rrugë, në përputhje me kushtet teknike dhe pëlqimet e organit kompetent;

1.5. qasja në parking të mos organizohet përmes trotuarit dhe të mos pengojë lëvizjen e lirë të këmbësorëve;

1.6. kyçja në rrugë të jetë në përputhje me kufizimet dhe standardet teknike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

1.7. hapësira të jetë e rregulluar dhe e shtruar me material të përshtatshëm, si asfalt, kubëza betoni, ose zhvor sipas projektit të miratuar;

1.8. vendparkimet dhe rrugët qarkulluese të jenë të shënuara horizontalisht dhe vertikalisht;

1.9. të sigurohet së paku një (1) vendparkim për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve teknike dhe kërkesave ligjore në fuqi;

1.10. të sigurohen kushtet e nevojshme për ndriçim, mirëmbajtje dhe siguri të përdoruesve;

1.11. të sigurohet sistem i kamerave, kur kërkohet sipas kritereve të zbatueshme, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

1.12. të përmbushen kushtet e tjera teknike, urbanistike dhe administrative të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Projekti i parkingut duhet të përgatitet nga profesionistët e licencuar ose të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të përmbajë organizimin e vendparkimeve, hyrjet, daljet, rrugët qarkulluese, shenjëzimin dhe mënyrën e funksionimit të parkingut.

3. Për parkingjet që organizohen në hapësira me destinim tjetër, duhet të sigurohen pëlqimet dhe lejet përkatëse, si dhe të përcaktohen afati dhe kushtet e shfrytëzimit.

Neni 53

Kërkesa për pajisje me leje të operimit

1. Personi juridik që synon të organizojë dhe të shfrytëzojë parking privat duhet të paraqesë kërkesë për pajisje me leje të operimit në organin kompetent të Komunës së Vushtrrisë.

2. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të operatorit, lokacionin e parkingut, të dhënat kadastrale, numrin e vendparkimeve dhe mënyrën e planifikuar të organizimit e të funksionimit të tij.

3. Kërkesës i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:

3.1. certifikata e regjistrimit të biznesit në ARBK për veprimtarinë përkatëse;

3.2. certifikata e pronësisë ose marrëveshja apo kontrata e vlefshme me pronarin e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës, e noterizuar kur kërkohet me ligj;

3.3. projekti për kyçjen dhe funksionimin e hapësirës së parkingut, i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor ose profesionisti i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi;

3.4. dëshmia për numrin e vendparkimeve dhe paraqitja grafike e organizimit të tyre;

3.5. dokumentacioni kadastral dhe incizimi gjeodezik;

3.6. dëshmia për përmbushjen e kushteve të qasjes në rrugë dhe pëlqimi për kyçje nga organi kompetent;

3.7. dëshmia për shenjëzimin horizontal dhe vertikal;

3.8. dëshmia për rregullimin dhe shtrimin e sipërfaqes së parkingut;

3.9. dëshmia për sistemin e kamerave, kur kërkohet sipas kritereve të zbatueshme;

3.10. dokumentet e tjera të kërkuara shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

4. Organi kompetent mund të kërkojë plotësimin e dokumentacionit ose sqarime shtesë kur ato janë të nevojshme për shqyrtimin e kërkesës.

Neni 54

Shqyrtimi i kërkesës dhe leja e operimit

1. Organi kompetent i Komunës shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

2. Kur është e nevojshme, organi kompetent mund të kërkojë mendime ose pëlqime nga drejtoritë komunale dhe institucionet e tjera kompetente, si dhe të kryejë verifikim në terren.

3. Leja e operimit lëshohet pasi të konstatohet se aplikuesi i plotëson kushtet e kërkuara dhe i ka përmbushur detyrimet administrative përkatëse.

4. Leja e operimit përmban, së paku:

4.1. emrin dhe të dhënat identifikuese të operatorit;

4.2. lokacionin dhe të dhënat kadastrale të parkingut;

4.3. numrin e vendparkimeve të miratuara;

4.4. zonën ku klasifikohet parkingu, sipas ndarjes zonale të përcaktuar nga Komuna;

4.5. kushtet kryesore të organizimit dhe shfrytëzimit të parkingut;

4.6. afatin e vlefshmërisë së lejes, kur përcaktohet afat;

4.7. detyrimet kryesore të operatorit.

5. Në rast të refuzimit të kërkesës, organi kompetent nxjerr vendim të arsyetuar, kundër të cilit mund të ushtrohet mjeti juridik sipas legjislacionit në fuqi.

6. Leja e operimit nuk i zëvendëson lejet ndërtimore, pëlqimet për kyçje në rrugë ose lejet e tjera që kërkohen me legjislacionin në fuqi.

Neni 55

Taksa për lejen e operimit

1. Për pajisjen me leje të përgjithshme të operimit të parkingut privat paguhet taksa e përgjithshme në shumën prej (500) eurosh.

2. Pagesa e taksës së përgjithshme bëhet sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga organi kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Taksat nga ky nen janë detyrime për pajisjen me leje dhe ushtrimin e veprimtarisë dhe nuk përbëjnë çmimin që operatori u ngarkon përdoruesve për shfrytëzimin e vendparkimit.

4. Ndryshimi i shumës së përcaktuar në këtë nen bëhet vetëm sipas procedurës dhe autorizimeve të parashikuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 56

Afati i vlefshmërisë së lejes, vazhdimi dhe ndryshimi i kushteve

1. Leja e operimit lëshohet për një periudhë prej katër (4) vjetësh, nga data e nxjerrjes së vendimit përkatës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Operatori mund të kërkojë vazhdimin e lejes pas përfundimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, duke paraqitur kërkesë pranë organit kompetent të Komunës, së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të saj.

3. Vazhdimi i lejes bëhet pas verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore.

4. Operatori është i obliguar ta njoftojë organin kompetent të Komunës për çdo ndryshim që ndikon në kushtet mbi bazën e të cilave është lëshuar leja, përfshirë ndryshimin e pronësisë, të së drejtës së shfrytëzimit, lokacionit ose numrit të vendparkimeve.

5. Ndryshimi i kapacitetit, lokacionit ose mënyrës së organizimit të parkingut që ndikon në kushtet e miratuara mund të bëhet vetëm pas marrjes së miratimeve ose lejeve përkatëse nga organet kompetente, kur ato kërkohen me legjislacionin në fuqi.

Neni 57

Detyrimet e operatorit të parkingut privat

1. Operatori i parkingut privat është i obliguar:

1.1. të dëshmojë përmbushjen e obligimeve për tatimin në pronë ndaj Komunës, sipas legjislacionit në fuqi;

1.2. të operojë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në lejen e operimit dhe në dokumentacionin e miratuar;

1.3. të mirëmbajë hapësirën e parkingut, pajisjet përcjellëse dhe infrastrukturën përkatëse në gjendje të rregullt dhe funksionale;

1.4. të sigurojë që organizimi dhe shfrytëzimi i parkingut të mos pengojë lëvizjen e lirë të qytetarëve, qasjen në hapësirat publike dhe sigurinë në komunikacion;

1.5. të vendosë në hyrje të parkingut lejen e operimit dhe të sigurojë shenjëzim të dukshëm, si dhe informim të qartë të përdoruesve për çmimet, orarin dhe kushtet e shfrytëzimit;

1.6. të përdorë dhe mirëmbajë sistemin e kamerave, kur kërkohet sipas kritereve të zbatueshme, në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

1.7. të mos e përdorë hapësirën e parkingut për veprimtari të tjera që nuk janë të lejuara me lejen e operimit ose që pengojnë funksionimin normal të parkingut;

1.8. t'u mundësojë organeve kompetente të Komunës kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit, duke u ofruar qasje në hapësirat dhe dokumentacionin përkatës, brenda kompetencave të tyre dhe sipas legjislacionit në fuqi.

2. Operatori mban përgjegjësi për dëmet që u shkaktohen përdoruesve ose personave të tretë si pasojë e organizimit, mirëmbajtjes ose funksionimit të parkingut, në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 58

Mbikëqyrja e parkingjeve private

1. Mbikëqyrjen e përmbushjes së kushteve dhe kritereve për organizimin dhe operimin e parkingjeve private e kryejnë organet kompetente të Komunës së Vushtrrisë, brenda fushës së përgjegjësive dhe autorizimeve të tyre ligjore.

2. Gjatë mbikëqyrjes, organet kompetente verifikojnë:

2.1. përputhshmërinë e parkingut me lejen e operimit dhe dokumentacionin teknik të miratuar;

2.2. respektimin e kushteve të pronësisë ose të së drejtës së shfrytëzimit të hapësirës;

2.3. përmbushjen e kushteve teknike dhe të qasjes në parking;

2.4. gjendjen e shenjëzimit, mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e pajisjeve;

2.5. respektimin e detyrimeve të operatorit të përcaktuara me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

3. Kur gjatë mbikëqyrjes konstatohen mangësi ose parregullsi, organi kompetent evidenton gjetjet dhe vepron sipas procedurave dhe autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

4. Pezullimi ose revokimi i lejes së operimit, si dhe shqiptimi i gjobave ose masave të tjera, mund të bëhen vetëm në rastet, nga organet dhe sipas procedurave të përcaktuara shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Neni 59

Parkingjet publike-private

1. Parkingjet publike-private organizohen dhe shfrytëzohen në bazë të kontratës ose marrëveshjes përkatëse ndërmjet Komunës dhe partnerit privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për partneritetin publiko-privat dhe fushat e tjera përkatëse.

2. Përzgjedhja e partnerit privat dhe dhënia në shfrytëzim e pronës publike bëhen sipas procedurave dhe autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Kontrata ose marrëveshja përcakton, së paku, lokacionin dhe kapacitetin e parkingut, kohëzgjatjen e marrëveshjes, detyrimet e palëve, investimet, mirëmbajtjen, tarifat, administrimin e të hyrave, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë për dëmet.

4. Partneri privat është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata dhe legjislacioni në fuqi. Kompetencat publike mbeten te organet publike, përveç rasteve kur delegimi i tyre lejohet shprehimisht me ligj.

5. Mbikëqyrja e zbatimit të kontratës bëhet nga organi ose njësia përgjegjëse e përcaktuar në kontratë, pa cenuar kompetencat e organeve të tjera publike.

KAPITULLI XVII

SIGURIA DHE QASJA

Neni 60

Siguria dhe organizimi i parkingjeve publike

1. Parkingjet publike planifikohen, organizohen dhe mirëmbahen për të siguruar shfrytëzim të sigurt, qasje të përshtatshme dhe qarkullim të papenguar.

2. Për këtë qëllim, parkingjet duhet:

2.1. të mos rrezikojnë sigurinë e trafikut;

2.2. të sigurojnë qasje të sigurt për këmbësorët;

2.3. të kenë sinjalizim të qartë;

2.4. të kenë ndriçim të përshtatshëm, kur kërkohet;

2.5. të sigurojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara sipas kërkesave ligjore; dhe

2.6. të mos pengojnë rrugët dhe qasjet emergjente.

KAPITULLI XVIII

TRANSPARENCA DHE RAPORTIMI

Neni 61

Informimi publik

Komuna siguron publikimin dhe përditësimin e hartës së parkingjeve, zonave, tarifave, orareve, mënyrave të pagesës, procedurave të abonimit dhe mënyrave të paraqitjes së ankesave.

Neni 62

Raportimi

1. Operatori ose njësia përgjegjëse i raporton Komunës së paku një herë në vit, ose më shpesh kur përcaktohet në aktin e menaxhimit, për:

1.1. numrin dhe kapacitetin e vendparkimeve;

1.2. shkallën e shfrytëzimit;

1.3. të hyrat dhe shpenzimet;

1.4. numrin e abonimeve;

1.5. ankesat dhe mënyrën e trajtimit të tyre;

1.6. problemet teknike; dhe

1.7. masat e propozuara për përmirësim.

KAPITULLI XIX

MASAT DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 63

Kundërvajtjet dhe sanksionet

1. Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje përbën kundërvajtje vetëm në rastet kur veprimi ose mosveprimi është përcaktuar shprehimisht si kundërvajtje dhe për të është paraparë sanksioni përkatës.

2. Kundërvajtjet dhe sanksionet përcaktohen në përputhje me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje dhe Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse.

3. Për të njëjtin veprim ose mosveprim nuk mund të shqiptohen dy sanksione kundërvajtëse, nëse kjo bie në kundërshtim me parimin e ndalimit të ndëshkimit të dyfishtë.

4. Tarifat e parkimit, detyrimet për pagesë, kompensimi i dëmit dhe shpenzimet e largimit ose ruajtjes së automjetit nuk konsiderohen gjoba kundërvajtëse, përveç kur legjislacioni në fuqi përcakton ndryshe.

Neni 64

Përgjegjësia për dëmet

1. Personi që me dashje ose nga pakujdesia shkakton dëm në pajisjet, sinjalizimin ose infrastrukturën e parkingut përgjigjet për dëmin e shkaktuar, në pajtim me ligjin.

2. Kërkimi i kompensimit bëhet sipas procedurës ligjore.

KAPITULLI XX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 65

Aktet zbatuese

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje mund të nxirren akte, udhëzime dhe procedura të brendshme vetëm brenda kompetencave ligjore.

2. Për zbatimin teknik mund të përgatiten dhe përditësohen harta e zonave, lista e parkingjeve, formularët e abonimit, procedurat e kontrollit dhe raportimit, si dhe materialet informuese.

3. Tabela e tarifave dhe çdo ndryshim i saj miratohen sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 66

Harmonizimi

Aktet komunale që rregullojnë çështje të parkingjeve harmonizohen me këtë Rregullore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 67

Zbatimi i legjislacionit të përgjithshëm

Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë Rregullore zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 68

Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 01-62/16, e datës 31.03.2016, e cila e ka rregulluar më parë fushën e organizimit, menaxhimit dhe shfrytëzimit të parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushojnë së zbatuari të gjitha dispozitat e akteve të tjera komunale që janë në kundërshtim me të, për aq sa rregullojnë çështje të njëjta.

Neni 69

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, brenda afatit të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

SHTOJCAT:
Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë Shtojca 1 – Tarifat për shfrytëzimin e parkingjeve publike dhe abonimet, si dhe Shtojca 2 – Sinjalizimi dhe shenjëzimi i parkingjeve, me dimensionet dhe specifikimet përkatëse të vendparkimeve."

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

VUSHTRRI, _____ 2026

ARSYETIM PËR PROJEKT-RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, MENAXHIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Hartimi dhe miratimi i Rregullores për organizimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë është i domosdoshëm për krijimin e një sistemi të rregulluar, funksional, transparent dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të parkingjeve publike, në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe zhvillimin urban të Komunës.Rritja e numrit të automjeteve dhe kërkesa gjithnjë e më e madhe për hapësira parkimi kanë shtuar nevojën për organizimin dhe shfrytëzimin më efikas të hapësirave publike.

Mungesa e rregullimit të plotë të kësaj fushe ndikon në qarkullimin e trafikut, sigurinë rrugore, qasjen në hapësirat publike dhe cilësinë e jetës në zonat urbane. Për këtë arsye, është e nevojshme të përcaktohen rregulla të qarta për organizimin, kategorizimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike.

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe mënyra e organizimit dhe menaxhimit të parkingjeve publike, ndarja e tyre në dy zona tarifore, si dhe rregullimi i kategorive të veçanta të parkingjeve, përfshirë parkingjet nëntokësore, parkingjet pranë objekteve kolektive dhe hapësirat e dedikuara për automjetet taksi dhe operatorët radio-taksi. Gjithashtu, përcaktohen kushtet për shfrytëzimin e parkingjeve, mënyrat e pagesës, tarifat, abonimet, të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve, si dhe përgjegjësitë e operatorit dhe organeve kompetente komunale.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve për shfrytëzimin e parkingjeve nga kategori të ndryshme të përdoruesve, përfshirë banorët, bizneset, institucionet, organizatat dhe operatorët e shërbimeve taksi. Përmes rregullimit të abonimeve dhe tarifave synohet të sigurohet trajtim i qartë dhe i barabartë i përdoruesve, transparencë në përcaktimin e detyrimeve financiare dhe shfrytëzim më racional i kapaciteteve ekzistuese të parkingjeve.

Rregullorja përcakton gjithashtu parimet për sinjalizimin dhe shenjëzimin e parkingjeve, përfshirë dimensionet dhe organizimin e vendparkimeve, me qëllim të sigurimit të qasjes, orientimit dhe sigurisë për të gjithë përdoruesit, duke marrë parasysh edhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe kategorive të tjera që kanë nevojë për trajtim të veçantë.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje, menaxhimi i parkingjeve publike i besohet ndërmarrjes publike N.P.L. "Përparimi" Sh. A., në përputhje me përgjegjësitë dhe kushtet e përcaktuara me aktet përkatëse.

Rregullorja përcakton detyrimet e operatorit lidhur me administrimin e parkingjeve, informimin e përdoruesve, mbledhjen e tarifave, mirëmbajtjen e hapësirave, monitorimin e shfrytëzimit dhe raportimin te organet kompetente komunale.

Miratimi i kësaj Rregulloreje synon të krijojë një bazë të qartë juridike dhe organizative për menaxhimin e parkingjeve publike, të përmirësojë disiplinën në parkim, të zvogëlojë parkimin e parregullt, të rrisë sigurinë dhe qasjen në hapësirat publike, si dhe të kontribuojë në përdorimin më të drejtë dhe më efikas të hapësirës publike.

Nëpërmjet zbatimit të saj pritet të përmirësohet menaxhimi i kërkesës për parking, të rritet përgjegjshmëria e operatorit dhe të sigurohen të hyra të administruara në mënyrë transparente, të cilat mund të kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e shërbimeve të parkingjeve publike.

Për këto arsye, miratimi i kësaj Rregulloreje konsiderohet i nevojshëm dhe në interes të përgjithshëm publik, duke krijuar kushte për një sistem më të organizuar, më të sigurt dhe më të qëndrueshëm të parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

SHTOJCA 1

TARIFAT PËR SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE DHE ABONIMET NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Rregullores për organizimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

I. TARIFAT E PARKINGJEVE PUBLIKE SIPAS ZONAVE

Nr.	Zona	Njësia e pagesës	Tarifa (€)
1.	Zona I	1 orë	0.50 €
2.	Zona I	Çdo orë shtesë	0.30 €
3.	Zona I	Ditore	3.00 €
4.	Zona II	1 orë	0.40 €
5.	Zona II	Çdo orë shtesë	0.20 €
6.	Zona II	Ditore	2.00 €

II. TARIFAT E PARKINGJEVE NËNTOKËSORE

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Njësia e pagesës	Tarifa (€)
1.	Parkim i zakonshëm	1 orë	0.50 €
2.	Parkim i zakonshëm	Çdo orë shtesë	0.30 €
4.	Parkim i zakonshëm	Ditore	3.00 €
5.	Parkim gjatë natës	Për natë	2.00 €
6.	Parkim afatgjatë	Javore	10.00 €
7.	Parkim afatgjatë	Mujore	30.00 €
8.	Abonim për shfrytëzim të rregullt	Vjetore	300.00 €

III. TARIFAT E PARKINGJEVE NË ZONAT PRANË OBJEKTEVE KOLEKTIVE

Nr.	Lloji i shfrytëzimit	Njësia e pagesës	Tarifa (€)
1.	Abonim për banorë të objektit kolektiv	Mujore	5.00 €
2.	Abonim për banorë të objektit kolektiv	Vjetore	50.00 €
3.	Abonim për automjetin e dytë të familjes	Mujore	10.00 €
4.	Abonim për automjetin e dytë të familjes	Vjetore	100.00 €

IV. TARIFAT E PARKINGJEVE PËR AUTOMJETET TAKSI DHE OPERATORËT RADIO-TAKSI

Nr.	Kategoria e shfrytëzimit	Njësia e pagesës	Tarifa (€)
1.	Vendparkim i dedikuar për automjet taksi	Mujore	10.00 €
2.	Vendparkim i dedikuar për automjet taksi	Vjetore	80.00 €
3.	Hapësirë e dedikuar për operator radio-taksi	Mujore	10.00 €
4.	Hapësirë e dedikuar për operator radio-taksi	Vjetore	100.00 €

V. TARIFAT E ABONIMEVE PËR PARKINGJE PUBLIKE, KATEGORITË E TJERA TË PËRDORUESVE

Nr.	Kategoria e abonimit	Periudha	Tarifa (€)
1.	Abonim për banorë zona e parë	Mujore	20.00 €
2.	Abonim për banorë zona e parë	Vjetore	100.00
3.	Abonim për banorë zona e dytë	Mujore	15.00 €
4.	Abonim për banorë zona e dytë	Vjetore	80.00 €
5.	Abonim për biznese zona e parë	Mujore	30.00 €
6.	Abonim për biznese zona e parë	Vjetore	200.00 €
7.	Abonim për biznese zona e dytë	Mujore	20.00 €
8.	Abonim për organizata dhe shoqata	Vjetore	150.00 €

VI. TARIFAT PËR VENDPARKINGJE PRANË OBJEKTEVE KOLEKTIVE TË REZERVUARA PËR BIZNESE

Nr.	Kategoria	Njësia e pagesës	Tarifa (€)
1.	Vendparkim i rezervuar për biznese	Mujore	10.00 €
2.	Vendparkim i rezervuar për biznese	Vjetore	100.00 €

VII. DISPOZITAT PLOTËSUESE

1. Tarifat e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen sipas zonës tarifore, kategorisë së parkingut dhe llojit të shfrytëzimit, në përputhje me dispozitat e Rregullores.
2. Tarifat e parkingjeve publike, parkingjeve nëntokësore, parkingjeve pranë objekteve kolektive dhe hapësirave të dedikuara për automjetet taksi dhe operatorët radio-taksi zbatohen sipas kategorive të përcaktuara në këtë shtojcë.
3. Abonimi është i vlefshëm vetëm për kategorinë, zonën ose hapësirën dhe periudhën për të cilën është lëshuar.
4. Abonimi nuk garanton vendparkim të rezervuar, përveç rasteve kur një e drejtë e tillë është miratuar shprehimisht nga organi kompetent.
5. Abonimet për banorët e objekteve kolektive lëshohen në bazë të dëshmisë së vendbanimit dhe dokumentacionit që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit të automjetit.
6. Abonimet për biznese, institucione publike, organizata dhe shoqata lëshohen në bazë të dokumentacionit përkatës dhe kushteve të përcaktuara me Rregullore.
7. Shfrytëzimi i parkingjeve për automjetet taksi dhe operatorët radio-taksi lejohet vetëm në hapësirat e dedikuara dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara me Rregullore dhe aktet përkatëse.
8. Vendparkimet e rezervuara mund të shfrytëzohen vetëm nga subjektet për të cilat është miratuar rezervimi dhe për qëllimin e përcaktuar.
9. Të gjitha tarifat në këtë shtojcë janë të shprehura në euro (€).
10. Ndryshimi i tarifave të përcaktuara në këtë shtojcë bëhet vetëm me vendim të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

SHTOJCA 2

STANDARDI I DIMENSIONEVE, SINJALIZIMIT DHE SHENJËZIMIT TË PARKINGJEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Rregullores për organizimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Parkingjet publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë duhet të organizohen, projektohen, sinjalizohen dhe shenjëzohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregullat e trafikut rrugor, sinjalizimin rrugor dhe standardet teknike përkatëse.
2. Shenjëzimi i parkingjeve bëhet përmes sinjalizimit horizontal dhe vertikal, me qëllim të përcaktimit të qartë të vendparkimeve, drejtimit të qarkullimit, hyrjeve dhe daljeve, si dhe hapësirave të dedikuara për kategori të veçanta të përdoruesve.
3. Dimensionet dhe organizimi i vendparkimeve përcaktohen në bazë të projektit teknik, duke marrë parasysh llojin e automjeteve, mënyrën e parkimit, hapësirën e nevojshme për manovrim dhe sigurinë e përdoruesve.

II. DIMENSIONET E VENDPARKIMEVE

1. Vendparkimet duhet të shenjëzohen me vija të dukshme dhe të dallueshme, në mënyrë që të përcaktohen qartë kufijtë e secilit vendparkim.
2. Për vendparkimet e zakonshme për automjete të kategorisë së udhëtarëve, përdoren këto dimensione projektuese orientuese:

Nr.	Mënyra e parkimit	Gjerësia	Gjatësia
1.	Parkim paralel me rrugën (0°)	2.20–2.50 m	5.50–6.00 m
2.	Parkim i pjerrët (45°)	2.50 m	5.00 m
3.	Parkim i pjerrët (60°)	2.50 m	5.00 m
4.	Parkim pingul (90°)	2.50 m	5.00 m

3. Gjerësia e korridoreve të qarkullimit dhe hapësira për manovrim përcaktohen sipas këndit të parkimit, qarkullimit njëkahësh ose dykahësh dhe projektit teknik të parkingut.
4. Dimensionet e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen si kritere projektuese orientuese dhe nuk mund të përdoren në kundërshtim me kërkesat detyruese të standardeve teknike dhe legjislacionit në fuqi.

III. VENDPARKIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

1. Në parkingjet publike duhet të sigurohen vendparkime të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në lokacione të përshtatshme dhe sa më afër hyrjeve të objekteve ose destinacioneve përkatëse.

2. Këto vendparkime duhet të kenë dimensione të përshtatshme për hyrjen dhe daljen e sigurt nga automjeti, përfshirë hapësirën shtesë anësore për lëvizjen e personit me karrocë invalidore.
3. Vendparkimet duhet të shenjëzohen me:
    - Shenjëzim horizontal me simbolin ndërkombëtar të qasjes për personat me aftësi të kufizuara;
    - Shenjëzim vertikal me shenjën përkatëse të trafikut;
    - Hapësirë të lirë anësore për qasje dhe manovrim, sipas projektit teknik dhe standardeve në fuqi.
4. Dimensionet, numri, pozicionimi dhe mënyra e shenjëzimit të këtyre vendparkimeve duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe teknike në fuqi për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

IV. SHENJËZIMI HORIZONTAL I PARKINGJEVE

1. Shenjëzimi horizontal realizohet me vija të dukshme, të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe ngarkesës së trafikut.
2. Për përcaktimin e vendparkimeve dhe hapësirave të veçanta përdoren shenjat dhe ngjyrat në përputhje me legjislacionin dhe standardet e sinjalizimit rrugor.
3. Shenjëzimi horizontal duhet të përfshijë:
    - Vijat kufizuese të vendparkimeve;
    - Shigjetat e drejtimit të qarkullimit;
    - Simbolet për vendparkimet e dedikuara;
    - Vijat dhe simbolet për ndalimin ose kufizimin e parkimit;
    - Shenjat për vendkalimet e këmbësorëve dhe hapësirat e qasjes.
4. Shenjëzimi duhet të jetë i qartë, i lexueshëm dhe i mirëmbajtur. Kur vijat ose simbolet bëhen të padukshme, operatori përgjegjës duhet të sigurojë ripërtëritjen e tyre.

V. SINJALIZIMI VERTIKAL I PARKINGJEVE

1. Në hyrje të çdo parkingu publik vendoset sinjalizimi përkatës, i cili tregon se hapësira është parking publik dhe informon përdoruesit për kushtet e shfrytëzimit.
2. Në varësi të organizimit të parkingut, sinjalizimi vertikal duhet të përmbajë informata për:
    - Emërtimin ose kategorinë e parkingut;
    - Zonën tarifore përkatëse;
    - Orarin e pagesës;
    - Tarifat dhe mënyrën e pagesës;
    - Kohëzgjatjen e lejuar të parkimit;
    - Vendparkimet e rezervuara dhe kategoritë e autorizuara;
    - Kufizimet dhe ndalesat e parkimit.
3. Shenjat e trafikut vendosen në pozita të dukshme dhe në mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve, automjeteve dhe pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

VI. PARKINGJET NËNTOKËSORE

1. Parkingjet nëntokësore duhet të kenë shenjëzim horizontal dhe vertikal të qartë për çdo vendparkim, si dhe sinjalizim për hyrje, dalje dhe drejtimin e qarkullimit.
2. Në brendësi të parkingut duhet të shënohen:
   - Numrat ose identifikuesit e vendparkimeve;
   - Drejtimet e lëvizjes dhe korridoret e qarkullimit;
   - Daljet emergjente dhe rrugët e evakuimit;
   - Vendparkimet për personat me aftësi të kufizuara;
   - Vendparkimet e rezervuara për kategori të veçanta;
   - Hapësirat teknike dhe zonat ku ndalohet parkimi.
3. Organizimi i parkingjeve nëntokësore duhet të jetë në përputhje edhe me kërkesat për sigurinë nga zjarri, evakuimin, ventilimin dhe mbrojtjen e përdoruesve.

VII. PARKINGJET PRANË OBJEKTEVE KOLEKTIVE

1. Parkingjet pranë objekteve kolektive duhet të shenjëzohen në mënyrë që të dallohen vendparkimet e përgjithshme nga ato të dedikuara për banorët, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të autorizuara.
2. Hyrjet, daljet, korridoret e qarkullimit dhe hapësirat për këmbësorë duhet të jenë të qarta dhe të sigurta.
3. Vendparkimet e rezervuara për banorët ose përdoruesit e autorizuar duhet të identifikohen përmes sinjalizimit përkatës, pa cenuar qasjen publike dhe sigurinë e komunikacionit.

VIII. PARKINGJET PËR AUTOMJETET TAKSI DHE RADIO-TAKSI

1. Vendparkimet e dedikuara për automjetet taksi dhe operatorët radio-taksi duhet të shenjëzohen qartë dhe të dallohen nga vendparkimet e përgjithshme.
2. Në hyrje ose në afërsi të këtyre hapësirave vendosen shenjat përkatëse që tregojnë destinimin e parkingut dhe kategorinë e automjeteve që kanë të drejtë ta shfrytëzojnë atë.
3. Numri dhe pozicionimi i vendparkimeve për taksi dhe radio-taksi përcaktohen me projektin përkatës të organizimit të komunikacionit dhe vendimin e organit kompetent komunal.

IX. MIRËMBAJTJA DHE ZBATIMI

1. Operatori përgjegjës për menaxhimin e parkingjeve publike kujdeset për mirëmbajtjen e shenjëzimit horizontal dhe vertikal, si dhe për zëvendësimin ose ripërtëritjen e shenjave të dëmtuara ose të paqarta.
2. Vendosja, ndryshimi ose largimi i sinjalizimit rrugor bëhet vetëm me pëlqimin ose vendimin e organit kompetent komunal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo ndërhyrje në organizimin e parkingut duhet të mbështetet në dokumentacionin teknik përkatës dhe të mos cenojë sigurinë e komunikacionit, qasjen e këmbësorëve dhe qasjen për personat me aftësi të kufizuara.

Republika e Kosovës **Kuvendi i Komunës Vushtrri**

Propozuesi :Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Bedri Dobra

Lënda: Propozim-Vendim për regjistrimin e pronave rezervë të komasacionit nga Komisioni për Komasacion në pronësi të Komunës

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më _____ 2026, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për regjistrimin e pronave rezervë të komasacionit nga Komisioni për Komasacion në pronësi të Komunës

1. Lejohen të gjitha pronat rezervë të komasacionit ne te gjitha zonat kadastrale te perfshira ne komasacion, të regjistruara në emër të Komisionit për Komasacion të komunës Vushtrri të regjistrohen pronë publike në emër të komunës Vushtrri.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuese e Kuvendit

Melihate Basholli-Latifi

ARSYETIM

Gjat fazave te punve teknike e juridike të zbatimit të Komasacionit i viteve 1983-1987 , jan krijuar disa parcela dhe ato kryesisht nga (zbritja e sipërfaqeve 2.5% e qdo pronari, pastaj nga mezhdat e parcelave, nga mbetjet e sipërfaqeve gjat barazimeve etj .) ku kto parcela në at kohë kan qenun te regjistruara si parcela me Pronar : **Komisioni për Komasacion** ,i Komunës sipas nenit 1 të Aktvendimit të Komunës Vushtrri nr.01-461-3 të datës 15.07.1982 dhe neni 54 i Ligjit mbi komasacionin (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.31/87), ky komision ka menagjuar me kto prona , dhe nga ky fond jan krijuar rrugët , kanalet kulluese ka barazuar parcelat e tjera , dhe qe nga ajo koh aktvendimet kan mbetur me Titullar ,, Komisioni për Komasacion,,dhe nuk jan te futura në system RDPP , ndersa ekzistoin ne pjesën Grafike-Harta Kadastrale. (ky komision ma nuk ekziston)

Pasi ky komision i përkohshëm nuk ekziston dhe puna e ti ka mbaruar, të gjitha parcelat që janë regjistruar në emër të komisionit të lartpërmendur duhet të kalojnë në emër të Komunës se Vushtrrise, pasi qe edhe komisioni i lartecekur ka qene i formuar nga Kuvendi i Komunes.

Nga te cekurat me larte i propozojme Kuvendit te Komunes qe te aprovoj propozim-vendimin per kalimin e pronave te evidentuara ne ëmër te Komisionit te komasacionit ne ëmër te Komunës se Vushtrrise.

Drejtori i Drejtorisë

Bedri Dobra

Bedri Dobra

From: Demir Hyseni
Sent: Thursday, November 5, 2026 2:32 PM
To: Bedri Dobra
Cc: AferditaThaqi; Ferit Idrizi; Bujar Shatrolli; Hajzer Bublaku; Faik Kelmendi; Diellza Bardhecaj
Subject: RE: Opinion Ligjor

Përshëndetje

Pas shqyrtimit te kërkesës nga ZKK e komunës se Vushtrrisë për te dhënë një sqarim lidhur me pronat qe me Aktvendimet e zbatimit te masës se komasacionit janë te evidentuara ne emër te Komisionit për komasacion ,e jap këtë mendim profesional:

Sipas Ligjit për Komasacion i vitit 1987 por me herët edhe me Ligjin për komasacion dhe arondim organ për zbatimin e procesit te komasacionit ka qene Komisionet për Komasacion. Komisioni për komasacion ka qene organ komunal respektivisht i formuar nga komuna .

Gjate punës se komisionit për komasacion ka pasur raste qe disa prona te barten ne emër te komisionit për komasacion. Kjo ka ndodhur ne rastet kur disa pjese te pronave kane qene te pa përshtatshëm për ndarje ose te cilat nuk kane mundur te përfshihen ne ndarjen e këtyre pronave te personat fizik dhe juridik.

Gjithashtu qëllimi i këtyre pronave ka qene qe ne rast te ankesave ose ne raste e vendimeve te shkalles se dyte administrative dhe te Gjykatës Supreme te Kosovës ka mundur qe këto prona te përdoren për kompensim për pjesëmarrësit e komasacionit . Gjithashtu qëllimi i këtyre pronave ka qene edhe kompensimi i dëmeve qe mund te jete shkaktuar pjesëmarrësve ne komasacion. Ndërsa ne fund këto kane mund te jete edhe prona qe kane mbetur te lira pa pasur nevoje te përdoren për qëllimet e shënuara me larte .

Pasi tani një komision i tille nuk ekziston dhe komisioni i mëhershëm ka qene komunale dhe komuna ka qene bartëse e procesit te komasacionit këto prona mund te regjistrohen si prona te komunës. Por ne këto raste duhet te kihet parasysh nëse është duke u zhvilluar ndonjë procedure administrative ose gjyqësore dhe vlerësohet se ndonjë pjesëmarrës i komasacionit është dëmtuar e ne veçanti dëmtimi ka ardhur për shkak te mungesës se sipërfaqes se tokës qe i ka takuar atëherë kompensimi duhet te behet nga këto prona ose pronave qe kane qene bartur me Aktvendime ne emër te Komisionit për Komasacion.

Me respekt !

Demir Hyseni,- Ud. Drejtor i Departamentit për Kadastër
Agjencia Kadastrale e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MOBILE
+383 44 212 875

From: Bedri Dobra <bedri.dobra@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, October 6, 2026 12:05 PM
To: Demir Hyseni <Demir.Hyseni@rks-gov.net>
Cc: AferditaThaqi <aferdita.thaqi@rks-gov.net>; Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>; Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>
Subject: Opinion Ligjor

Te nderuar Zyrtar të AKK – Zyra Ligjore.

Gjat fazave te punve teknike e juridike të zbatimit të Komasacionit I viteve 1983-1987 , jan krijuar disa parcela dhe ato kryesisht nga (zbritja e siperfaqeve 2.5% e qdo pronari, pastaj nga mezhdat e parcelave etj .) ku kto parcela në at koh kan qenun te regjistruara si parcela me Pronar : **Komisioni për Komasacion ,,** ,I komunes , ku ky komision ka menagjuar me kto prona , dhe nga ky fond jan krijuar rrugët , kanalet kulluese ka barazuar parcelat tjera , dhe qe nga ajo koh aktvendimet kan mbetur me Titullar ,, Komisioni për Komasacion,,dhe nuk jan te futura në system RDPP , ndersa ekzistoin ne pjesën Grafike. (ky komision ma nuk ekziston)

Kto parcela besoi se me automatizem duhet te mbarten ne ëmer te Komunes gjegjesisht te nderrohet titullari nga : **Komisioni për Komasacion në ,, Kuvendi Komunal,,** dhe ky vendim të kaloi për mes asambles Komunale.

Kerkoi opinion Ligjor edhe nga AKK

Ne attach gjeni ni vëndim të till si mostër .

Me Respekt,

B.Dobra.

KUVENDI KOMUNAL VUSHTRRI
KOMISIONI PËR K0MASACION
018K/309
30/08/2010
Vushtrri

Komisioni për komasacion i KK Vushtrri ne baze te nenit 1 te Aktvendimit te KK-se Vushtrri, nr.01-461-3 te dates 15.07.1982 me te cilin është paraparë zbatimi i komasacionit në tokat bujqesore te komunes së Vushtrris si dhe nenit 54 të Ligjit mbi komasacionin (" Gazeta Zyrtare e KSAK" , nr.31/87) , gjatë shiqimit publik 2009/2010 mori këtë :

A K T V E N D I M
Mbi ndarjen e tokës nga masa e komasacionit

Pjesëmarrësi i komasacionit **Komisioni per Komasacion** nga Vushtrrija. Për token e përfshirë në masën e komasacionit e cila gjendet në **Gojbulë** , sipas gjendjes së tokës Nr. 309

Nr. i parcelës	Kultura	Klasa Vlerësuese	Sipërfaqja Ha a m²	Vlera e tokës e përfshirë në masën e komasacionit	Zbritja për nevojat e përgjithëshme	Vlera e tërsishme për ndarja nga masa e komasacionit
GJITHËSEJT:						

1.Caktohet toka në masën e komasacionit në Z.Kadastrale **Gojbulë** , siq vijon:

Tabela Nr..	Nr. parcelës	Kultura	Klasa vlerësuese	Sipërfaqja			Vlera sipas klasës vlerësuese	Vlera e tërsishme Për ndarje nga masa e komasac.
				Ha	a	m²		
175	28	Bujqsore	4	0	36	76	2757.00	
175	28	Bujqsore	5	0	19	99	1199.40	
GJITHËSEJT :				0	56	75	3956.40	

Komisioni për komasacion me aktvendim të posaqëm do të bëjë përcaktimin e kompenzimit për ndryshim të vlerës së tokës së përfshirë me komasacion nëse pjesëmarrësit i ka ndryshuar vlera e tërsishme e tokës, sipas dispozitave për eksproprijim e pasi që aktvendimi për ndarjen nga masa e komasacionit merr formën e prerë.

II. Pranim – dorëzimi i tokës, ndërtesave dhe objekteve të tjera është kryer në bazë të procesverbalit për pranim – dorëzimin e përkohshëm me nr.01 nr. 018K-309 dt.30.08.2010 gjat shqimit publik Ndërsa pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, konsiderohet pranim – dorëzim i përhershëm.

A R S Y E T I M

Gjatë procedures së zbatimit të komasacionit u kryen punët pregatitore konform nenit 23, 26,56,57 të Ligjit për komasacion, siq janë konstatimi i gjendjes faktike të pasurive të paluajtëshme, caktimi i vlerës së tokës (bonitetit), vlersimi i kulturave dhe objekteve të përhershme, formimi i planit pasqyror të gjendjes faktike, formimi i librit fondit të masës, projektimi i rrugëve, ndarja e tokës pjesëmarrësve të komasacionit ku është kryer edhe shiqimi publik për rastet e parapara me Ligj konform neneve 35,36,37,38 e 47 në muajin shtator- tetor/84 për çka pjesëmarrësve të komasacionit u janë dhënë sqarime të hollësishme për mundësinë e grupizimit dhe caktimit të tokës në masën e komasacionit si dhe kriteriumet e caktuara me nenin 41,43 ku Komisioni ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Meqenëse është kryer pranim-dorëzimi i përkohshëm i pronës në bazë të nenit 51, 58 është vendosur që i njejti pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi të mbetet definitiv.

Ky aktvendim u bazua në Elaboratin e komisionit per komasacion Vushtrri.

III. Kundër këtij aktvendimi mbi caktimin e tokës në masën e komasacionit, pjesëmarrësi i komasacionit mund të ushtroj ankesë Zyres Ligjore te MBPZHR, Brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të këtij aktvendimi, permes Komisionit për Komasacion të Kuvendit të Komunës së Vushtrris

Vushtrri,
30.08 .2010

KOMISIONI PËR KOMASACION
Kryetari

Emrullah Muli, jur. i dipl.

Dorëzohet :
- Pjesëmarrësit të komasacionit,
- Arkivit,
- Drejtorisë Komunale të Gjeodezisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

PËR: Kuvendin e Komunës

PROPOZUES: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës _____

HARTUES: Bedri Dobra, Drejtor i DGJKP-së _____

TEMA: Propozim-Vendim

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 paragrafi 4 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 paragrafët 4, 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më _____2026, merr këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR. 01.Nr.50/17, DATË 23.02.2017

Neni 1

1. Shfuqizohet pjesërisht Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej pesëmbëdhjetë (15) viteve me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës, në pjesën që lidhet me ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, me sipërfaqe prej 11.97.88 ha, përkatësisht 119,788 m², e cila i është dhënë në shfrytëzim "Bleak Rose" SH.P.K.
2. Shfuqizimi i pjesshëm i Vendimit bëhet për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësi, përkatësisht mosshfrytëzimit të pronës sipas qëllimit dhe kushteve të përcaktuara me kontratë, si dhe mospërmbushjes së detyrimeve për pagesën e qirasë.

Neni 2

1. Shfuqizimi i përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi nuk prek pjesët e tjera të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, të cilat mbeten në fuqi.

2. Në veçanti, mbetet në fuqi pjesa e Vendimit që lidhet me pronën tjetër të përfshirë në të, me sipërfaqe prej 23.45.12 ha, si dhe me përfituesin tjetër të përcaktuar me Vendimin nr. 01.Nr.50/17.

Neni 3

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës, në pajtim me nenin 27 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, merr vendim për shkëputjen e Kontratës nr. 05/2017, datë 01.08.2017, të protokolluar me nr. 39180/17, të lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe "Bleak Rose" SH.P.K.
2. Vendimi për shkëputjen e kontratës nga paragrafi 1 i këtij neni kufizohet në pjesën që lidhet me ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, dhe me përfituesin "Bleak Rose" SH.P.K., dhe nxirret në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e kontratës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, me Vendimin nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, ka dhënë në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim pronë të paluajtshme të Komunës, ndër të tjera edhe ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, me sipërfaqe prej 11.97.88 ha, përkatësisht 119,788 m², për përfituesin "Bleak Rose" SH.P.K. Në bazë të këtij Vendimi është lidhur Kontrata nr. 05/2017, datë 01.08.2017, e protokolluar me nr. 39180/17, ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe "Bleak Rose" SH.P.K., me afat kontraktual prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh. Gjatë mbikëqyrjes së realizimit të kontratës janë konstatuar rrethana që dëshmojnë mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e qiramarrësit, përkatësisht mosshfrytëzimin e pronës sipas qëllimit dhe kushteve të përcaktuara me kontratë, si dhe mos përmbushjen e detyrimeve për pagesën e qirasë, e cila nuk është paguar që nga viti 2019.

Në pajtim me nenin 27 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, drejtoria përkatëse ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e kontratës dhe, në rast të moszbatimit të saj, të rekomandojë marrjen e masave përkatëse nga Kryetari i Komunës për shfuqizimin e pjesshëm të Vendimit nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, vetëm në pjesën që lidhet me ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, dhe përfituesin "Bleak Rose" SH.P.K. Shfuqizimi propozohet vetëm në mënyrë të pjesshme, pasi Vendimi i Kuvendit nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, përfshin edhe pronë tjetër komunale dhe përfitues tjetër. Për këtë arsye, shfuqizimi i tërësishëm i Vendimit do të përfshinte edhe pjesë të tij që nuk janë objekt i procedurës së tanishme. Me shfuqizimin e pjesshëm të Vendimit, krijohet baza procedurale për veprimin e mëtejmë të përcaktuar shprehimisht në nenin 27 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, sipas të cilit, pas shfuqizimit të vendimit për dhënien në shfrytëzim nga Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës. Rrjedhimisht, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës do të nxjerrë vendim për shkëputjen e Kontratës nr. 05/2017, datë 01.08.2017, të protokolluar me nr. 39180/17, në pjesën që lidhet me ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, dhe me përfituesin "Bleak Rose" SH.P.K., në pajtim me nenin 27 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 dhe kushtet e kontratës. Lidhur me faktet e përmendura më lartë, duke pasur parasysh mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësi, mos paraqitjen dhe mos interesimi i palës për përmbushjen e kësaj kontrate, andaj propozohet që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë të miratojë këtë Propozim-Vendim për shfuqizimin e pjesshëm të Vendimit nr. 01.Nr.50/17, datë 23.02.2017, vetëm në pjesën që lidhet me ngastrën kadastrale nr. 492, Zona Kadastrale Balincë, dhe "Bleak Rose" SH.P.K.

Drejtori i Drejtorisë

Bedri Dobra

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 50/17
Nr. i fq. / Br. st -2-
Datë / Datum 23.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 7 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neneve 30 dhe 31 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26, nenit 2 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, nenit 4, 5 të Rregullores QRK NR.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **23 shkurt 2017,** mori këtë:

VENDIM PARAPRAK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR ME KOMPENSIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në ngastrën kadastrale me nr.P-70202022-00209-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë) me sipërfaqe prej 23.45.12 ha, Zona Kadastrale Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe ngastra kadastrale me nr.P-70202022-00492-0, me kulturë arë e klasës së 4 (katërt) me sipërfaqe prej 11.97.88 ha, Zona Kadastrale Balincë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër me veprimtari bujqësore, çmimi fillestar do të jetë 50 € (pesëdhjetë euro) për 1 ha në vit, në afat prej 15 viteve.

3. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

4.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të bëjë regjistrimin e drejtës së shfrytëzimit në regjistrat e pronës së paluajtshme komunale, pas nënshkrimit të kontratës mes dhënësit të pronës në shfrytëzim dhe përfituesit të drejtës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet paragrafi 1.4 dhe paragrafi 1.8 i pikës 1 të Vendimit 01Nr.245/15 të dt.30.11.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës –tokës bujqësore dhe kullosa.

7.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

Datë: **13.11.2026**

Për: KPF, Kuvendin Komunal

Propozues: **Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi**

Hartues: **Drejtoria për Shërbime Publike, Benjamin Shala**

Për shqyrtim: Propozim –Vendim për caktim të lokacionit për mbeturinat inerte në territorin e Komunës së Vushtrrisë

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, nenit 17, pika f), dhe nenit 35, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 13, nënparagrafi 1.6, dhe nenit 18, nënparagrafi 1.1, të Statutit Nr. 209/22 të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2026, miraton këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIM TË LOKACIONIT PËR MBETURINAT INERTE

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për grumbullim të mbeturinave inerte në fshatin Begaj, pjesa nga parcela kadastrale P-70202045-00009-0 zona kadastrale Begaj, e cila evidentohet si pronë shoqërore e Komunës së Vushtrrisë me numër të parcelës 9-0.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

_____

Melihate Basholli - Latifi

ARSYETIM

Për Vendimin për Caktimin e Lokacionit për Ndërtimin dhe Funksionalizimin e Deponisë së Mbeturinave Inerte në Territorin e Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë, në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të saj ligjore për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike, si dhe për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, ka identifikuar nevojën për caktimin e një lokacioni të dedikuar për deponimin e mbeturinave inerte që krijohen nga aktivitetet e ndërtimit, demolimit dhe punimeve të tjera infrastrukturore në territorin e komunës.

Mungesa e një lokacioni të përcaktuar dhe të organizuar për këtë kategori të mbeturinave në zonë lindore të Komunës së Vushtrrisë, paraqet sfidë në menaxhimin e tyre, duke rritur rrezikun e hedhjes dhe deponimit të paautorizuar në hapësira publike, përgjatë rrugëve, në brigjet e lumenjve, në zona të gjelbra dhe në lokacione të tjera të papërshtatshme. Këto praktika ndikojnë negativisht në cilësinë e mjedisit, në peizazhin urban dhe rural, si dhe në shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Për këtë arsye, caktimi i një lokacioni në këtë zonë me destinim afatgjatë për deponimin e mbeturinave inerte konsiderohet i nevojshëm për krijimin e një sistemi të organizuar, të kontrolluar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të kësaj kategorie të mbeturinave. Ky lokacion do të mundësojë orientimin e mbeturinave inerte drejt një hapësire të përcaktuar, duke parandaluar deponimin e tyre në vende të papërshtatshme dhe duke lehtësuar kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të deponimit.

Përmes këtij vendimi synohet që Komuna e Vushtrrisë të krijojë bazën institucionale dhe hapësinore për zhvillimin e një deponie të dedikuar për mbeturina inerte, e cila do të funksionojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kriteret për përzgjedhjen e lokacionit, kushtet teknike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Funksionalizimi i deponisë do të bëhet pas përmbushjes së procedurave përkatëse ligjore dhe administrative, përfshirë dokumentacionin teknik, si dhe përcaktimin e mënyrës së administrimit, operimit, kontrollit dhe monitorimit të saj.

Caktimi i këtij lokacioni me destinim afatgjatë paraqet një masë me interes publik, e cila synon përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave inerte, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e hapësirave publike dhe parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave.

Prandaj propozojmë që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë të miratojë këtë vendim për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Drejtori i Drejtorisë

_____

Benjamin Shala

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

1813675

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202045-00009-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**18-3674-26**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	12.11.2026 - 14:18
Komuna / Opština / Municipality:	VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Begaj / Begaj / Begaj
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202045-00009-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	498255			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GUXHELICA	0			

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pašnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture	498255

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	**Komuna e Vushtrrisë**	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Begaj

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70202045-00009-0	Parcelë / Parcela / Parcel	498255



Shkalla/Razmera/Scale: 1:14909

Punoi/Obradio/Created: Fadil Selimi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 12.11.2026

Koha/ Vreme/ Time: 02:22:30

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

DATË:	
PËR:	**KPF dhe Kuvendin e Komunës**
PROPOZUES:	**Ferit Idrizi** **Kryetar i Komunës së Vushtrrisë**
HARTUES:	**Kimete Mehana Kryesuese e Komisionit Komunal për riintegrimin e personave të Riatdhesuar** **Kryesues i Komisionit për hartimin e Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vushtrrisë 2026 - 2028**
TEMA:	**Akt – përcjellës**

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Planin komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vushtrrisë 2026 – 2028.

Ky dokument i është nështruar konsultimit publik. Gjatë kohës sa ka qenë në konsultim publik nuk kemi pranuar ndonjë koment, propozim apo vërejtje.

I propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë dokument dhe të njëjtin ta procedojë për aprovim në Kuvend.

Me respekt!

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Komuna e Vushtrrisë

PLANI KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË
2026 - 2028

Duke u bazuar në nenin ..... të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale,
në harmoni Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019) nenin ..... të statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e Mbajtur më _____ 2026, aprovoi:

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Komuna e Vushtrrisë

Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve në Komunën Vushtrrisë 2026 - 2028

Shkurtesat:

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FVN	Formulari për Vlerësimin e Nevojave
VN	Vlerësimi i nevojave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Riintegrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
PR	Person i Riatdhesuar
PIR	Plani Individual i Riintegrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Punë Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit

ZGJC Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Migrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 të Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ripranimi dhe Riintegrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Riintegrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Riintegrimit ka për qëllim riintegrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të riintegrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë, është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Riintegrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për riintegrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Vushtrrisë.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave. Përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave, aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 të Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për iintegrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, në këtë Plan, është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e riintegrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vushtrrisë.

.

Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2026-2028

Objektivi 1:	*Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit*	*Baza*	*Caku 2026*	*2028*
Avancimi i sistemit të riintegrimit për personat e riatdhesuar dhe te huajve, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe riintegrimin e të huajve.	• *Janë identifikuar nevojat e grupeve të cenueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimit dhe të integrimit;*	*40%*	*70%*	*90%*
	• *Shërbimet e riintegrimit dhe integrimit monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese;*	*30%*	*60%*	*80%*
	• *Është arritur riintegrimi dhe integrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i grupeve të cenueshme;*	*50%*	*60%*	*80%*

#	Masa	*Veprimet*	*Indikatorët*	*Institucioni përgjegjës*	*Institucioni /partneri përkrahës*	*Kosto financiare*	*Afati kohor*	*Mjetet e verifikimit*
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të cenueshme;	1. Realizimi i vizitave në familjen e kthyer, apo të posaardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS; 2. Intervistimi i familjes dhe plotësimi i formularit dhe Vlerësimit të	Numri i familjeve të cenueshme të kthyera, dhe të huaja në komunë Numri i vizitave të realizuara nga ekipi për VN Numri i FVN të plotësuar Numri i formularëve të vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB/QPS	QPS DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia ne komunitetet (siapas nevojes) DSHMS Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	300 euro	Në vazhdimësi	Raportet nga tereni FVN i Plotësuar dhe nënshkruar nga palët SMR

		Nevojave; 3. Vendoset ne FVN të skanuar në SMR						
1.2	Hartimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuara në FVN;	Hartimi i Planit Individual të ri integrimit dhe integrimit për secilin person dhe familje të cenueshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale; Vendosja PIR/PII të skanuar në SMR;	Numri i Planeve Individuale të riintegrimit dhe integrimit, të hartuara;	ZKKK/ QPS DRPRIH/MPB	ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Planet Individuale të riintegrimit dhe integrimit në SMR
1.3	Zbatimi sistematik i planit individual të riintegrimit dhe integrimit përmes ofrimit të shërbimeve të riintegrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Këshillimi i personit te riatdhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informimi për afatet ligjore të parashtrimit të kërkesave; Ndihma per PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse komunale për	Numri i kërkesave te parashtruara, bazuar në PIR; Numri dhe llojet e skemave të mbështetjes; Numri i kërkesave dhe përfitimeve të regjistruara ne SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse DRPRIH/MPB ZP/QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i riintegrimit dhe integrimit	Në vazhdimësi	Raportet e rregullta Kërkesat e parashtruara SMR

		sigurimin e shërbimeve të nevojshme; Regjistrimi i kërkesave dhe përfitimet në SMR;						
1.4	Monitorimi dhe vlerësimi periodik i riintegrimit dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Monitorimi në baza mujore zbatimin e PIR; Vlerësimi në baza tremujore skemat e ofruara, ndikimin e tyre dhe nevojat për plotësime apo ndryshime të skemave për arritjen e riintegrimit të qëndrueshëm dhe integrimit;	Numri i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve; Raporti tremujor i vlerësimit të ndikimit të skemave të riintegrimit dhe integrimit, me rekomandimet konkrete për masa shtesë, në rast nevoje;	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) Anëtarët e komisionit	Drejtoritë komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	450 Euro	Në vazhdimësi	Raportet e tremujore të monitorimit dhe vlerësimit
1.5	Vlerësimi përfundimtar i riintegrimit dhe integrimit dhe mbyllja e rastit;	Vlerësimi i gjendjes përfundimtare dhe nivelin e riintegrimit dhe integrimit te PR sipas PIR; Mbyllja e rastit në dokumentacion fizik; Mbyllja rastin në SMR- konstato - riintegrim / integrim i qëndrueshëm;	Numri i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike SMR	ZKKK/ QPS (Koordinatori Rajonal)	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e mbylljes së rasteve pas 18 muajve; Dosjet fizike të PR, të mbyllura SMR

Objektivi specifik: 2			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të riintegrimit dhe integrimit			• *Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional;* • *Numri i rasteve të referuara te autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur;* • *Rritet numri i drejtorive komunale të ndërlidhura me SMR*			*40 %* *30 %* *40 %*	*70%* *75%* *60 %*	*90%* *90%* *85 %*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
2.1	Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal;	Koordinimi i ndihmës dhe mbështetjes me drejtoritë relevante komunale, ne baza ditore, për secilin rast; Realizimi i takimeve të rregullta dhe takime ad-hoc, diskutimi rasteve që kërkojnë zgjidhje;	Numri i rasteve të referuara në drejtoritë përkatëse komunale; Numri i takimeve te rregullta dhe numri i rasteve të diskutuara; Numri i takimeve ad –hoc dhe numri i rasteve të diskutuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB MAPL MPFVLQ MFPT MSH MBPZHR QPS ZP Drejtoritë komunale përkatëse. Qendra e Shëndetit mendor. Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë. Shtëpia në komunitet. Bizneset.	/	Në vazhdimësi	SMR Raportet e rregullta nga tereni Raportet e rregullta nga DRPRIH/MPB ZKKK

2.2	Profilizimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna;	Pranimi në zyrë i personave të riatdhesuar apo të huaj; Intervistimi i të riatdhesuarve (të huajin), parashtrimi i pyetjeve rreth nevojave dhe mundësive të tij/saj; Krijimi i profilit të secilit person të kthyer apo të huaj; Vlerësimi dhe evidentimi i nevojave të tij/saj; Vendosja e profilit dhe nevojat në SMR;	Numri i personave të lajmëruar në ZKKK; Numri i personave të intervistuar; Numri i dosjeve me profilin, personave të riatdhesuar dhe të huaj; Numri i personave me nevojat e vlerësuara; Numri i personave me profilin e vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë përkatëse komunale	/	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR
2.3	Referimi i personave të riatdhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre;	Referohen personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve . Referimi i personave të kthyer, apo të huaj në ZP që të regjistrohen si punëkërkues; Referohen personat e kthyer apo të huaj	Numri i personave të referuar në drejtoritë përkatëse; Numri i personave të referuar në ZGJC; Numri i personave të referuar në ZP; Numri i personave të referuar në QPS;	ZKKK	DRPRIH ZP QPS QAP Drejtoritë komunale përkatëse. Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të	/	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

		të cenueshëm në QPS; Referohen në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmijë për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkolla;	Numri i personave te referuar në DKA;		huajve në Kosovë. Zyra për barazi gjinore.			
2.4	Përmirësimi i sistemit të këshillimit të personave të riatdhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë;	Bazuar në profilin dhe nevojat, këshillohen ata për mundësitë e përfitimit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integrimit dhe të integrimit; Këshillohen dhe orientohen ata se cilat dokumente ju nevojiten për çfarë shërbimi; Ndihmohen ne përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave; Këshillohen për respektimin e afateve dhe detyrimet ligjore;	Numri i personave të këshilluar nga ZKKK Numri i personave qe janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP QAP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	1100 Euro	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

		Njoftohen ata për pasojat ligjore të ri emigrimit;						
2.5	Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe këshillim të personave të riatdhesuar dhe të huaj;	Vendosja ne sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat; Kërkesa per të u informuar nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marre statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrim, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj; Kontaktohet personi i kthyer, apo të huajin informo për mundësitë e mbështetjes, refero në institucionet përkatëse;	Takimet e rregullta me akterët relevant Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që identifikohen si rezultat i këtij bashkëpunimi	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS QAP Shkollat ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	900 Euro	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK Numri i të riatdhesuarve dhe të huajve të identifikuar
2.6	Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit;	Realizimi i takimeve te rregullta me ZKKK; Diskutimi për referimin dhe	Numri i takimeve të rregullta	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP QPS Drejtoritë komunale përkatëse	400 Euro	Në vazhdimësi	Raportet monitoruese

		koordinimin e rasteve; Analizohet sistemi i referimit dhe koordinimit; Vlerësohet gjendja aktuale dhe Rekomandohet masa përmirësuese, në rast nevoje;			Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
2.7	Referimi i rasteve pas periudhes dymbdhjete mujore konform legjislacionit ne fuqi	Identifikohen personat, familjet qe kane nevojë për mbështetje pas dymbëdhjetë muajve Ndërmerren veprimet për planifikimin buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojeshme pas dymbdhjete muajve	Vizita e personave/ familjeve ne skemen e akomodimit me nevoja soecifike pas periudhes dymbdhjete mujore Takimet dhe informim per rastet me derjtorite pergjegjese ne menyre qe te behet planifikimi buxhetor	ZKK QPS Dretoria per buxhet dhe financa	DRPRIH ZP	3600 Euro	Ne vazhdimësi	Raporte te rregullta
Objektivi specifik 3			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i masave të riintegrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik			• *Numri i punëkërkuesve të riatdhesuar apo te huaj të profilizuar dhe të këshilluar për zhvillimin në karrierë;* • *Numri i të riatdhesuarve/huajve të punësuar;* • *Numri i përfitueseve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës;*					

			• *Numri i përfituesve nga skemat e aftësimit profesional;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve përfitues të grandeve bujqësore dhe këshillimeve në fushën e bujqësisë;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore;* • *Zgjerimi i fushave të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut*			*45 %*	*50%*	*80%*
%	***Masat***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
3.1	Regjistrimi i të riatdhesuarve/të huajve si punëkërkues në Zyrat e Punësimit;	Pranon në zyrë personin e riatdhesuar/të huaj; Regjistro personat e riatdhesuar/te huaj si punëkërkues; Informohen për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP; Informohen për mundësitë e tyre në baze të legjislacionit në fuqi;	Nr. i personave të riatdhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkues;	ZP APRK	DRPRIH/MPB ZKKK QAP organizatat vendore dhe nderkombetare	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Raportet e ZKK
3.2	Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkueseve të riatdhesuarve apo te të huajve;	Intervistohen , rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj; Vlerësohen dhe evidentohen nevojat e tij/saj Krijohet profili i	Numri i personave të riatdhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj; Numri i dosjeve fizike të personave të riatdhesuar apo të huaj që janë	ZP	ZKKK QAP	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Numri i dosjeve Shënimët dhe raportet nga SMR

		secilit person të kthyer apo të huaj Këshillohen për orientimin ne karriera, bazuar në aftësitë dhe mundësit e tyre Zgjerimi i kritereve në programin e super punes Krijohet një dosje për secilin person te riatdhesuar apo te huaj Vendosja e shënimeve në SMR	këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre jane evidentuar; Numri i të riatdhesuarve apo të huajve punëkërkues ku janë vendosur shënimët për profilizim dhë këshillim në SMR					
3.3	Punësimi i të riatdhesuarve apo te huajve përmes ndërmjetësimit në punësim;	Ndërmjetësimi në punësim për personat e riatdhesuar apo ata te huaj të përgatitur për tregun e punës; Evidentimi i të dhënat relevante në SMR;	Numri i rasteve të ndërmjetësuara Numri i rasteve të punësimit të riatdhesuarve apo te te huajve me ndërmjetësim Të dhënat për ndërmjetësim dhe punësim në SMR	ZP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë (donatoret) Institucionet publike	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP me të dhënat mbi numrin e rasteve të ndërmjetësimit dhe punësimit të personave të riatdhesuar apo atyre te huaj
3.4	Trajnimi në punë dhe punësimi i të riatdhesuarve apo te te huajve përmes	Ndërmjetësimi për trajnim përmes punës personat ne nevojë për përgatitjen për	Numri i rasteve të ndërmjetësuara për trajnim dhe përgaditje për tregun e punës;	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatat	750	Në vazhdimësi	Raportet e ZP dhe QAP

	subvencionimit të pagës;	tregun e punës; Monitorohet mbarëvajtja e trajnimit dhe punësimit;	Numri i rasteve të monitoruara		vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Institucionet publike			
3.5	Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo te të huajve përmes financimit të planeve të biznesit;	Informohen personat për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë; Informohen personat kur thirrja të jetë e hapur për aplikim; Ndihmohen personat në kompletimin e dosjes për aplikim;	Numri i të riatdhesuarve apo te te huajve që informohen për mundësitë dhe kushte e përfitimit përmes planeve të biznesit	ZP	DRPRIH ZKKK QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Operatoret e licensuar	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
3.6	Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe te te huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës;	Identifikohen personat e riatdhesuar dhe të huaj që kanë nevojë për aftësim profesional; Identifikohen profilet e tyre dhe orientohen ne profesionet adekuate me prirjet dhe dëshirat e tyre; Referohen në QAP	Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që vijojnë aftësimin profesional Numri i të riatdhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar dhe te referuar për QAP	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Bizneset	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP me të dhënat e të riatdhesuarve dhe të huajve që vijojnë aftësimin profesional

		përkatëse;						
3.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);	Monitorimi në baza të rregullta mbarëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); Vlerësohet ndikimi i tyre ne përgatitjen dhe riintegrimin e PR;	Numri i të riatdhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ; Të dhëna për ndikimin e MATP në riintegrimin dhe integrimin e tyre	ZP DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	ZKKK APRK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet periodike te monitorimit dhe vlerësimit të përgatitura nga DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)
3.8	Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe këshillimi i të riatdhesuarve dhe te huajve në zonat rurale;	Informimi i personave për mundësitë e përfitimit të granteve bujqësore; Përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve si përfitues i granteve bujqësore;	Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituar grante bujqësore	Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit rural/ Komuna	ZKKK AZHBR/MBZHR Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK me të dhënat për rastet kur përfitues të granteve janë personat e riatdhesuar
Objektivi specifik 4			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit për riintegrim dhe integrim të qëndrueshëm social të personave të riatdhesuar dhe të huajve			*Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;* *Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfitues të asistencës sociale;* *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevoje që kanë pranuar trajtim psiko-social;* *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në*		*40 %* *70%* *15%*	*35%* *60%* *30%*	*90%* *90%* *50%*

			aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ; *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komunat (pas periudhës 12 mujore);* *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfituar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;*			*10 %* *10%* *30%*	*30%* *30%* *50%*	*60%* *40%* *60%*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
4.1	Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për mundësitë e përfshirjes ne skema sociale;	Pranohen në zyre personat e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK; Informimi për shërbimet dhe skemat sociale; Këshillohen për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale; Menaxhohen rastet deri ne vendosjen ne sistemin social; Regjistrimi ne bazën e te dhenave (SNS) rastin/skemën e përfitimi;	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale; Numri i rasteve që monitorohen derisa vendosen në sistemin social Vendosja e të dhënave për të riatdhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP E-Kosova Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK
4.2	Asistimi i personave të riatdhesuar dhe te huaj në sigurimin e	Asistimi i personave te riatdhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e	Numri i personave të riatdhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK

	dokumentacionit të nevojshëm për përfitim nga skemat sociale;	dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale; Menaxhohen dhe monitorohen rastet në shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar; Regjistrohen ne SMR rastin/skemën e përfitimit;	aplikim në skemat sociale Numri i rasteve të monitoruara deri në shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar Vendosja e të dhënave për numrin e të riatdhesuarve dhe te huajve që përfitojnë nga skemat sociale në SMR		E-Kosova Drejtoritë përkatëse komunale Agjensioni për ndihmë juridike falas			
4.3	Sigurimi i banimit të qëndrueshëm	Monitorohen rastet që janë të akomoduar me qera nga programi i ri integrimit dhe i integrimit Këshillohen dhe ndihmohen rastet në nevojë për aplikim për banim social Sigurohet banimi i qëndrueshëm pas skadimit te qirasë Regjistrimi në SMR rastet e përfitimit	Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve të asistuara për aplikim për banim social Numri i rasteve që u sigurohet banim i qëndrueshëm Të dhënat në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) Zyrtare per banim social	QPS Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e të riatdhesuarve që kanë përfituar banim të qëndrueshëm

4.4	Trajtimi psikologjik dhe asistenca psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te huaj në nevojë;	Identifikimi i rasteve dhe vlerësimi i nevojave për trajtim psiko-social Ofrimi i ndimës psiko-sociale për personat e identifikuar Monitorimi i rasteve që u ofrohet ndihmë psiko sociale Regjistrimi i të dhënave për rastet dhe formën e ndihmës psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te te huajve, sigurimi i transportit gjate periudhes se trajtimit	Numri i rasteve të identifikuara në nevojë për ndihmë psiko-sociale Numri i rasteve që marrin ndihmë psiko sociale Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve dhe të dhënave të regjisturuara në SMR	ZKKK QPS	QKMF Qendra e shëndetit mendor Spitali Rajonal Shkollat Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e te riatdhesuarve që janë mbështetur dhe formën e ndihmës psiko sociale Raportet e OSHC-ve
4.5	Sigurimi i kushteve të banimit përmes renovimit, rindërtimit dhe mobilimit te shtëpive të personave të riatdhesuar dhe te huaj;	Këshillimi i personave te riatdhesuar dhe te huajt për mundësit e përfitimit nga skema e renovimit, rindërtimit dhe mobilimit të shtëpive Ndihmohen në kompletimin e dosjeve për aplikim	Numri i personave të riatdhesuar dhe te huaj që janë informuar dhe asistuar për mundësitë e përfitimit nga skema e renovimit, ndërtimit dhe mobilimit të shtëpive; Numri i rasteve/dosjeve të proceduara për shqyrtim në KKR;	KKR Zyrtari per banim social	ZKKK DRPRIH/MPB MMPHI Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raportet e DRPRIH Të dhënat nga SMR

		ne këto skema Procedohen dosjet për shqyrtim nga KKR Përcjell landët për ekzekutim ne DRPRIH përmes koordinatorit rajonal Regjistrohet rasti dhe vendoset dosja ne SMR	Numri i vendimeve të KKR për këtë skemë; Numri irasteve të përcjella në DRPRIH për ekzekutim; Vendosja e të dhënave në SMR për numrin e rasteve të aplikimit dhe vendimeve përfundimtare të përfitimit nga kjo skemë.		huajve në Kosovë			
4.6	Përfshirja e të kthyerve dhe te huajve në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative;	Informohen dhe përfshihen personat e riatdhesuar dhe te huaj në aktivitete kulturore, sociale, rekreative dhe inovative, te organizuara ne komunën tuaj Bashkëpunimi me organizatat për realizim te aktiviteteve te tilla ne komunën tuaj	Të dhënat mbi informimin e të riatdhesuarve dhe te huajve për përfshirje në aktivitete sociale dhe kulturore në nivel komunal Të dhënat mbi bashkëpunimin me organizata dhe projekte me qëllim përfshirjen e të riatdhesuarvedhe te huajve në aktivitete të ndryshme	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat Klubet sportive	1200	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
Objektivi specifik 5			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe të të huajve, në sistemin edukativo arsimor			*Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj të përfshirë në nivelin përkatëse të shkollimit;* *Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues;*			*90%* *50%*	*100%* *60%*	*100%* *85%*

			Numri i rasteve të reagimeve të ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes;			*50%*	*75%*	*80%*
			Numri i programeve mësimore të rishikuara të shpërndara në shkolla;			*10%*	*50%*	*80%*
			Numrin i të rriturve të riatdhesuar dhe te huaj, që kanë mësuar shkrim- lexim;			*50%*	*60%*	*70%*
			Numri i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes në mësim;			*80%*	*85%*	*97%*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
5.1	Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në nivelin përkatës të shkollimit;	Merrja e informatave nga ZKKK për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj që duhet të përfshihen në sistemin arsimor Vlerësohet niveli i njohurive te nxënësit te riatdhesuar dhe atyre te huaj Përcaktohet niveli përkatës i shkollimit Akomodohen nxënësit në klasat përkatëse	Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe atyre te huaj që janë përfshirë në sistemin arsimor Raportet e vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Raportet e regjistrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj	DKA Shkollat	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Shkollat Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet nga DKA Raportet nga ZKKK
5.2	Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimit plotësues për fëmijët e	Identifikohen nxënësit që kanë vështirësi në përdorimin e gjuhëve zyrtare	Numri i nxënësve te kthyer ne komune; Numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi	DKA Shkolla përkatëse	DRPRIH/MPB ZKKK Shkollat Qendrat	500	Në vazhdimësi	Testet vlerësuese dhe raportet përkatëse

	riatdhesuar dhe te huaj;	Organizohen kurse të gjuhës në shkollën ne të cilën nxënësit vijojnë mësimin; Organizohet mësimi plotësues bazuar në nevojat e nxënësit	ne përdorimin e gjuhëve zyrtare Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset dhe mësimin plotësues		Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
5.3	Nostrifikimi i dokumenteve te nxënësve te riatdhesuar dhe te huaj;	Nostrifikohen dokumentet shkollore të nxënësve të kthyer dhe te huaj Ofrohet ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumentacionit të nevojshëm për nostrifikim	Numri i nxënësve që kanë nostrifikuar dokumente Numri i rasteve që u është ofruar ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumenteve	DKA MASHTI	DRPRIH/MPB Shkolla përkatëse Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	300	Në vazhdimësi	Raportete e DKA për rastet e nostrifikimit të dokumenteve
5.4	Funksionalizimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj;	Organizohen takime të rregullta me ekipet për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave Diskutohet për gjendjen e fëmijëve te riatdhesuar dhe te huaj, identifikohen fëmijët ne rrezik për braktisje te shkollës Ndërmerren masat	Numri i takimeve të rregullta të ekipit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj Të dhënat për aktivitetet dhe bashkëpunimin me prindër dhe akterët tjerë	Shkollat DKA	KKR ZKKK Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raprotet nga Shkolalt dhe DKA

		konkrete ne bashkëpunim me prindërit dhe shkollën për parandalim te kësaj dukurie Përgatiten raporte të rregullta dhe ndaj ato me MASHTI dhe DRPRIH						
5.6	Hartimi dhe zbatimi i planeve të riintegrimit dhe te integrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj në arsim, bazuar në nevojat e tyre;	Vlerësohen njohuritë arsimore të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj Identifikohen nevojat për mësim plotësues për nxënësit e riatdhesuar dhe të huaj Hartohen planet individuale për integrim në arsim të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj	Numri i rasteve të vlerësimit të njohurive arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Të dhënat për mësim plotësues për nxënësit e riatdheasuar dhe te huaj Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj për të cilët janë hartuar planet individuale për integrim në sistemin arsimor	Shkolla DKA	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet nga shkollat
5.7	Zhdukja e analfabetizmit të personave të riatdhesuar dhe te huaj;	Identifikohen personat e riatdhesuar dhe te huaj që nuk dijnë shkrim – lexim Dërgohen listat ne DRPRIH përmes	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve analfabetë; Masat e ndërmarra për zhdukje të analfabetizmit tek të riatdhesuarit dhe te huajt;	ZKKK DRPRIH/MPB	DKA QPS MASHTI Shkollat Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raprotete e DRPRIH

		koordinatoreve rajonal			ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
5.8	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikave të përfshirjes në shkollim për të riatdhesuarit dhe te huajt;	Monitorohet rregullisht përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe të huaj në shkollim Vlerësime: zbatimin e politikave të përfshirjes së fëmijëve të shkollim Përgatiten raportet te monitorimit dhe përcjellën nga një kopje ne MASHT dhe DRPRIH	Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në sistemin arsimor të Kosovës	DKA	MASHTI DRPRIH/MPB ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e DKA Raportet e ZKKK

Objektivi specifik 6	***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***	***Baza***	***Caku 2063***	***2028***
Integrimi social dhe informimi i të riatdhesuarve dhe të huajve si dhe komuniteti pritës	• *Numri i forumeve të organizuara me të kthyerit në komuna për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në komunitet;* • *Numri i aktiviteteve për promovimin e procesit të riintegrimit;*	*5%* *10 %*	*30%* *40%*	*60%* *70%*

Nr.	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
6.1	Organizimi i forumeve me të kthyerit dhe te	Organizohen takime informative me te kthyerit dhe te	Numri i takimeve të organizuara me të kthyerit dhe te huajt dhe	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK ve për takimet e

	huajt për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në komunitet;	huajt; Diskutohet ne këto takime me te riatdhesuarit që kanë histori për te ndare me te tjerët, për ndarjen e përvojave me te riatdhesuar tjerë	komunitetin në nivel komunal		DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Zyra për informim			organizuara dhe numri i pjesëmarrësve
6.2	Ndarja e përvojave e personave të riatdhesuar dhe te huaj gjatë procesit te integrimit përmes realizimit te aktiviteteve të ndryshme;	Organizohen takime/ debate dhe përfshij të riatdhesuarit dhe te huajt të ndajnë historitë e tyre të migracionit me persona tjerë nga komuniteti , si mase e parandalimit të migrimit ilegal	Numri i takimeve të organizuara dhe përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve me qëllim të ndarjes së përvojës dhe parandalim të migrimit ilegal	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK nga takimet/debatet e organizuara
6.3	Promovimi i procesit të ri integrimit dhe integrimit përmes informimit publik;	Promovohet procesi i riintegrimit dhe integrimit ne komunën tuaj, përmes diskutimeve publike në radiot dhe televizionet lokale	Numri i artikujve dhe storjeve në mjetet e komunikimit masiv lokale dhe qendrore (Radio, TV, Internet dhe media sociale)	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat	/	Në vazhdimësi	Raportet dhe referencat nga komunikmi masiv
Objektivi specifik 7			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***

Koordinimi ndërmjet akterëve lokal të përfshirë në procesin e riintegrimit e të riatdhesuarve dhe integrimit të të huajve			• *Është vendosur praktika e bashkëveprimit horizontal në nivel lokal dhe ajo është efektive;* • *Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet ZKKK dhe QPS;* • *Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet akterëve në nivel qendror dhe atyre lokal të kyçur në riintegrim dhe integrim;* • *Është avancuar bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile, projektet dhe organizatat ndërkombëtare;*			*10%* *30%* *50%* *40%*	*35%* *50%* *70%* *60%*	*60%* *80%* *80%* *70%*
Nr.	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
7.1	Vendosja e kontakteve me të gjitha institucionet relevante dhe organizatat;	Krijohet një bazë e te dhënave (listë) me kontakte të institucioneve dhe organizatave në fushën e riintegrimit dhe integrimit të personave të riatdhesuar dhe te te huajve Vendosen kontakte te komunikimit dhe bashkëpunimit	Janë identifikuar organizatat dhe akterët që punojnë në fushën e riintegrimit dhe integrimit te personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj në komunë/rajon Kontaktet me akterë dhe organizata janë vendosur	ZKKK	QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e punë dhe bashkëpunimit me partnerë
7.2	Organizimi i takimeve tërregullta ndërmjet drejtorive komunale dhe gjithë akterëve të përfshire në nivel lokal;	Organizohen takime te rregullta mujore me drejtoritë relevante , diskuto për nevojat dhe mbarëvajtjen e procesit te ri integrimit dhe integrimit	Numri i takimeve dhe Raportet nga takimet me drejtoritë relevante për riintegrim dhe integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj	KKR ZKKK	ZP QPS QAP Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Policia në komunitet Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e	/	Në vazhdimësi	Raportet e KKR ZKKK

		Se paku një herë në tre muaj organizohen takime me te gjithë akterët e ri integrimit dhe integrimit ne nivelin lokal	Raportet nga takimet me akterët tjerë relevant		të huajve në Kosovë QKMF			
7.3	Ndarja e raporteve analitike dhe informatave relevante me të gjithë akterët e përfshirë në procese; Takime te ndersjella per koordinimrreth ofrimitte sherbimeve multidiciplinare	Ndarja e raporteve te rregullta me te gjitha drejtorit komunale, relevante ne ri integrim dhe integrim. Kërkohen dhe dërgohen informata kthyese, për rastet e referuara ne drejtorit përkatëse Identifikimi i personave ne nevoj per ofrimin e sherbimeve ne shendetin mendor	Shpërndarja e raporteve me drejtoritë relevante dhe partnerët tjerë Të dhënat dhe raportet e pranuara nga drejtroritë përkatëse Raportet mjekesore/diagnoza	ZKKK	ZKKK QPS Koordinatori -MPB DSHMS/QKMF QKUK DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
Objektivi specifik: 8			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike në nivel të komunës për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve			• *Rritja e nivelit të përfitimit nga donatorët që mbështesin riintegrimin në nivel qendror dhe lokal;* • *Numri i projekt-propozimeve të zhvilluara dhe të financuara nga donatorët e huaj;* • *Rritet numri i projekteve të realizuara;* • *Vendosja e mekanizmit adekuat për koordinim të asistencës teknike dhe donacioneve bazuar në prioritetet e strategjisë;* • *Projektet dhe iniciativat që mbështesin fushën e riintegrimit monitorohen vazhdimisht;*			*40%* *%* *%* *30%* *%*	*60%* *30%* *30%* *50%* *30%*	*80%* *50%* *50%* *70%* *40%*

#	*Aktiviteti*	*Veprimet*	*Indikatorët*	*Institucioni përgjegjës*	*Institucioni /partneri përkrahës*	*Kosto financiare*	*Afati kohor*	*Mjetet e verifikimit*
8.1	Identifikimi dhe sigurimi i kontakteve me të gjitha projektet e ri integrimit dhe integrimit;	Identifikimi projektve te ri integrimit dhe integrimit ne komunën tuaj Sigurimi kontaktetve te organizatave që zbatojnë projekte të ri integrimit dhe integrimit në komunë	Të dhënat për projektet që realizohen në komunën/rajon	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.2	Vendosja e sistemit per bashkepunimin dhe koordinimin e projekteve te ri integrimit dhe integrimit me perfaqesuesit e organizatave donatore dhe ofruesit e sherbimeve	Krijimi i nje databaze me te gjitha projektet e ri integrimit dhe integrimit nga komuna dhe organizata te cilat bejn implementimin e e tyre Organizimi i takimeve te regullta se paku Cdo tre muaj me organizata qe zbatojne projekte te ri integrimit dhe integrimit. Koordinimi i aktiviteteve ne mes te organizatave me qellim te shmangjes se dyfishimit te sherbimeve te njejta .	Raportim mbi projekte qe zbatohen ne fushen e ri integrimit dhe integrimit ne komune dhe rajon . Numri i takimev ekoordinuese lidhur me projektet	ZKKK	DRPRIH/MPB ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		Referimi i rasteve ne nevoje tek organizatat sipas profilit dhe sherbimeve qe ofrojn						
8.3	Identifikimi i nevojave të nivelit lokal për projekte në fushën e ri integrimit dhe integrimit;	Identifikimi nevojave për projekte në fushën e riintegrimit dhe integrimit Informimi i organizatave dhe donatoret	Nevojat për riintegrim dhe integrimit janë identifikuar dhe oprganizatat janë infromuar dhe ftuar për bashkëpunim	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.4	Fuqizimi i sistemit të shkëmbimit të informatave me donatorët në nivelin lokal;	Organizimi i takimeve me donatoret, së paku një here në vit Prezantimi i nevojave për donacione në fushën e ri integrimit dhe integrimit Ndarja e informatave relevante me donatoret .	Raporti nga takimet me donatorë; Ndarja e infromatave relevante për rintegrim dhe integrimit me donatorë dhe partnerë në komunë/rajon	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.5	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës	Organizimi i takimeve për diskutim të mbarëvajtjes se projekteve	Numri i takimeve me organizata, projekte dhe donatorë;	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

	teknike;				riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
Objektivi specifik: 9			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në procesin e riintegrimit dhe integrimit			• *Janë fuqizuar kapacitetet e stafit të angazhuar për zbatimin e qasjes së bazuar në nevoja dhe trajtimin e grupeve të cenueshme* • *Numri i stafit të riintegrimit dhe integrimit të trajnuar për identifikimin, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve;* • *Numri i aktiviteteve të realizuara në nivelin lokal për shpërndarjen e praktikave të mira komunale*			*20%* *20%* *20%* *20%*	*50%* *50%* *30%* *40 %*	*70%* *80%* *60%* *70 %*
#	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
9.1	Pjesëmarrja aktive ne trajnimet e organizuara për ri integrim dhe integrim;	Pjesmarja aktive në trajnimet e organizuara nga DRPRIH, Organizatat ndërkombëtare apo Organizatat vendore	Numri dhe tema e trajnimeve të ndjekura	ZKKK	DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet
9.2	Shkëmbimi i përvojave ndërmjet akterëve lokal përmes punës së përbashkët në teren;	shkëmbimi i përvojave dhe praktikave te mira me homologet nga komunat tjera.	Numri i takimeve me homologët	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga takimet

					dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
9.3	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet komunave për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira;	Organizimimi takimeve te përbashkëta me komunat e regjionit edhe me komuna tjera Diskutimi për temat me interes në fushën e riintegrimit dhe integrimit	Numri i takimeve të përbashkëta dhe temat e diskutuara	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP QPS Qendrat e shëndetit mendor Qendrat mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet
9.4	Regrutimi i stafit adekuat ose blerja e sherbimeve nese eshte e nevojshme	Ofrimi i sherbimeve psiko-sociale	Sipas nevojes	Prokurimi	ZKKK QPS DSHMS	/	Ne vazhdimesi	Raporet e ZKKK
Objektivi specifik: 10			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Monitorimi sistematik i qasjes së orientuar në nevoja për secilen kategori të personave të riatdhesuar dhe të huaj, bazuar në planin individual të riintegrimit dhe integrimit			• *Numri i stafit të trajnuar në fushën e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të pakove standarde të riintegrimit dhe integrimit;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut;*			*%*	*30%*	*60%*
#	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
10.1	Rritja e kualitetit të shënimeve në Sistemin elektronik të Menaxhimit të	Regjistrimi i të gjitha rasteve në SMR; Skanimi i gjithë	Nr i rasteve të regjistruara në SMR Nr dhe lloji i	ZKKK	DRPRIH/MPB	/	Në vazhdimësi	SMR

	Rasteve (SMR);	dokumentacionit për secilin rast individual dhe vendosja në SMR	dokumenteve të vendosura në SMR Nr i përmirësimeve dhe plotësimeve në SMR					
10.2	Monitorimi sistematik i shfrytëzimit dhe ndikimit të shërbimeve në ri integrim dhe integrim të qëndrueshëm;	Monitorimi i rasteve te regjistruara në SMR, nëse kanë marr shërbime e nevojshme dhe kanë parashtruar kërkesat, bazuar në nevojat e identifikuara në FVN Bashkepunimi me DKA nëse fëmijët e kthyer janë duke vijuar mësimit Bashkepunimi me ZP nëse te kthyerit janë regjistruar ne ZP si punëkërkues dhe a janë qasur në skemat adekuate	Të dhënat për rastet e monitoruara	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	SMR Raportet nga tereni Raportet e ZKKK
10.3	Vendosja e një mekanizmi për monitorimin dhe raportim të komunave për zbatimin e	Raportimi te DRPRIH/MPB për zbatim të planit	Mekanizmi për monitorim dhe raportim të zbatimit të planit komunal për riintegrimdhe integrim të	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatat	/	Në vazhdimësi	Raporti i zbatimit të planit komunal

	Planeve Komunale të Ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm.		qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe te huaj		vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			

REPUBLIKA E KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 5127/126
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum: 10.11.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

Procesverbali nga konsultimi publik me qytetarë për Draft-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë, 2026-2028

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik me qytetarë për Draft-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë, 2026-2028.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Ora: 11:00

Data: 04.11.2026

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin anëtarët e komisionit Kimete Mehana, kryesuese e komisionit, Ekrem Merovci, anëtar i komisionit, Xhavit Mehmeti, anëtar i komisionit, si dhe Selim Abazi, anëtar i komisionit.

Kimete Mehana, kryesuese e komisionit, hapi konsultimin publik me qytetarët dhe para tyre prezantoi Draft-Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë, 2026-2028.

Qytetarëve të pranishëm në këtë konsultim publik i është ofruar edhe material shpjegues lidhur me Draft-Planin.

Nga qytetarët e pranishëm në këtë konsultim publik, nuk ka pasur ndonjë koment apo sugjerim lidhur me Draft-Planin.

Takimi përfundoi në ora 11:45.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVA

Ekrem Merovci – Procesmbajtës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Vushtrri / Vucitrn Municipality

Zyra Komunale për Komunitete dhe kthim

Takim për konsultim publik lidhur me Draft-Planin e veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë, 2026-2028
Mbajtur më **Date :04.11.2026**

	Emri Name Ime	Organizata Organization Organizata	Telefoni Telephone Telefon	e-mail e-mail e-mail	Nenshkrimi Signature Potpis
1	Kinde Kelmendi	QPS			
2	Elorem Merovci	ZKKK			
3	Adnir Feka	Vushtrri			
4	Xhavit Mehmeti	ZHE			
5	Yetim Abazi	DKA			
6	Shemif Feka	Qytetar			
7	Avni Mehmeti	Qytetar			
8	Ajete Bunjaku	Qytetare			
9	Fjolla Ademi	-11-			
10	Safet Jamuli				
11	Linolito-Durodola				
12	AJETE HARADINAJ				
13					
14					
15					
16					

17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E VUSHTRRISË

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A:	05.11.2026
NR. I PROTOKOLIT	865 / 26
PËRMES:	Kryetarin e Komunës z. Ferit Idrizi
NGA/:	Drejtore e DKA-së, Naile Bekteshi
TEMA:	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.209/2022, Drejtoria Komunale e Arsimit paraqet këtë informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027.

Drejtoria Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASh-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PUNËS SË DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, në kuadër të përgjegjësive të saj ligjore dhe institucionale, ka koordinuar dhe përcjellë mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2025/2026, duke u bazuar në kalendarin zyrtar të vitit shkollor dhe në dispozitat përkatëse ligjore.

Viti shkollor 2025/2026 ka filluar më 1 shtator 2025. Gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 24 dhjetor 2025, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2025, ndërsa gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 12 janar 2026 dhe ka përfunduar më 23 qershor 2026.

Gjatë kësaj periudhe, puna e Drejtorisë Komunale të Arsimit është zhvilluar në koordinim me institucionet edukativo-arsimore, me synim sigurimin e zhvillimit të rregullt të procesit mësimor, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit.

Fushat kryesore të angazhimit të DKA-së kanë qenë:

- Përmirësimi i cilësisë në arsim
- Fuqizimi i menaxhimit të institucioneve arsimore
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe stafit arsimor
- Mbështetja e fëmijëve dhe nxënësve
- Avancimi i arsimit profesional dhe mësimit dual
- Zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët institucional dhe ndërkombëtarë
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve shkollore
- Krijimi i kushteve më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

1.1. Të dhënat e përgjithshme për vitin shkollor 2025/2026

Në Komunën e Vushtrrisë funksionojnë gjithsej 38 institucione publike arsimore, të organizuara si në vijim:

Lloji i institucionit	Numri
Institucione parashkollore publike	3
Shkolla fillore (klasat I–V)	3
Shkolla të mesme të ulëta (klasat VI–IX)	2
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (klasat I–IX)	27
Shkolla të mesme të larta	3
Gjithsej	**38**

Numri i nxënësve

Niveli i arsimit	Numri i nxënësve
Arsimi parashkollor	425
Arsimi parafillor	657
Arsimi fillor (klasat I–V)	4570
Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI–IX)	3820
Arsimi i mesëm i lartë (klasat X–XII)	2174
Gjithsej	**11.646**

Numri i paraleleve

Niveli	Numri i paraleleve
Parafillor	40
Fillor (I–V)	266
I mesëm i ulët	206
I mesëm i lartë	105
Gjithsej	**617**

Personeli arsimor dhe administrativ

Kategoria	Numri
Zyrtarë të DKA-së	11
Drejtorë	34
U.D. drejtorë	4
Zëvendësdrejtorë	8
Pedagogë	10
Psikologë	10
Asistentë	12
Bibliotekistë	9
Këshilltarë të karrierës	2
Sekretarë	11
Punëtorë teknikë	140
Edukatore	86
Mësimdhënës klasorë	266
Mësimdhënës lëndorë (VI–IX)	372
Mësimdhënës lëndorë (X–XII)	174
Gjithsej personel	**1,149**

Përveç institucioneve publike, në Komunën e Vushtrrisë funksionojnë edhe institucione në sektorin publiko-privat dhe privat:

- Në sektorin publiko-privat funksionojnë 2 çerdhe me bazë në komunitet, IP "Margherita Kids", në bashkëpunim me OJQ-në CIPOF, në Stanoc të Epërm dhe Shtitaricë.
- Në sektorin privat funksionojnë 6 institucione parashkollore private dhe 1 shkollë e mesme e lartë private e mjekësisë "Vicianamed".
- Gjithashtu, funksionon paralelja e ndarë e Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko".

1.2. Vlerësim i përgjithshëm i punës

Gjatë vitit shkollor 2025/2026, janë realizuar aktivitete të shumta në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim. Përmes koordinimit ndërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit, institucioneve edukativo-arsimore, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe partnerëve zhvillimorë, janë realizuar projekte, investime, trajnime, gara, aktivitete kulturore, sportive dhe profesionale, të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të arsimit në Komunën e Vushtrrisë.

DKA mbetet e përkushtuar në harmonizimin e kontratave të punës për punëtorët e arsimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e Auditorit. Megjithatë, procesi i harmonizimit të kontratave në shkollat përkatëse ende nuk është përmbyllur. Si arsye për mosrealizimin e këtij procesi është paraqitur kundërshtimi i SBASHK-ut ndaj kontratave të propozuara.

Përkundër rezultateve të arritura, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar edhe sfida që lidhen me infrastrukturën shkollore, nevojën për pajisje shtesë didaktike, zgjerimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe rritjen e mundësive për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

ZHVILLIMET, AKTIVITETET DHE TË ARRITURAT

2.1. Menaxhimi dhe monitorimi i institucioneve arsimore

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete:

- Monitorimi i institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë, me fokus në menaxhimin dhe qeverisjen e shkollave, sigurimin e cilësisë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e kontratave për furnizim me material mirëmbajtës, inventar shkollor, material administrativ, lëndë djegëse, transport të nxënësve, internet dhe furnizime të tjera për institucionet arsimore.
- Organizimi i transportit të nxënësve në 36 linja transporti, duke siguruar vijueshmëri të rregullt në procesin mësimor.
- Vlerësimi i tre (3) nxënësve dhe rivlerësimi i nëntë (9) nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, nga Ekipi Komunal për Vlerësim.
- Subvencionimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Realizimi i vlerësimit të brendshëm të performancës në institucionet parashkollore "Foleja", "Foleja 2" dhe "Foleja 3".

2.2. Aktivitetet edukative dhe institucionale

Në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet përkatëse janë organizuar dhe mbështetur aktivitete të ndryshme edukative dhe ndërgjegjësuese, ndër të cilat:

- Aktivitet me fëmijët parashkollorë, me rastin e 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në bashkëpunim me DKRS-në.
- Program festiv me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, gjatë të cilit janë ndarë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar, si dhe janë realizuar vizita te veteranët e arsimit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës.
- Aktivitete për fëmijët me Sindromën Down, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës.
- Aktivitete me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin.

2.3. Bashkëpunimi institucional

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar bashkëpunimin me institucione publike, organizata dhe partnerë të ndryshëm, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të arsimit dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Bashkëpunimi është zhvilluar me:

- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoratin Rajonal të Arsimit dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës – Kolegjiumin për Arsim.
- KFOR-in Slloven (CIMIC), në realizimin e aktiviteteve edukative dhe trajnimeve për mësimdhënës.
- Policinë e Kosovës, për siguri në shkolla dhe organizimin e ligjëratave vetëdijesuese për sigurinë në komunikacion, përdorimin e sigurt të internetit dhe parandalimin e rreziqeve nga mjetet piroteknike.
- Kryqin e Kuq të Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe institucionet relevante, për organizimin e ushtrimeve praktike në situata emergjente.
- Future Minds Academy, Kosovo Education Center, Innovation Academy dhe partnerë të tjerë, në realizimin e aktiviteteve edukative dhe zhvillimore.

Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët janë nënshkruar edhe marrëveshje dhe memorandume të ndryshme:

Memorandumi i Bashkëpunimit me UCTECHNOLOGY SH.P.K.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me kompaninë UCTECHNOLOGY SH.P.K., me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të arsimit përmes pilotimit të Sistemit Digjital "URA" në shkollat e përzgjedhura të Komunës së Vushtrrisë.

Sistemi synon të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet shkollës, prindërve dhe nxënësve, si dhe të mundësojë evidentimin dhe përcjelljen e hershme të nevojave për mbështetje të nxënësve.

Marrëveshja e Bashkëpunimit me Dukagjini Academy

Drejtoria Komunale e Arsimit ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Dukagjini Academy, me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit parauniversitar në Komunën e Vushtrrisë. Marrëveshja parasheh zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave përmes trajnimeve dhe punëtorive.

Memorandumi i Mirëkuptimit me Teach For Kosova

Drejtoria Komunale e Arsimit ka lidhur Memorandum Mirëkuptimi me organizatën Teach For Kosova për zbatimin e projektit "Promovimi i të menduarit kritik dhe qytetarisë aktive te të rinjtë", i mbështetur financiarisht nga National Endowment for Democracy (NED).

Projekti do të realizohet në periudhën shtator 2026 – shkurt 2028, në dy shkolla të mesme të Komunës së Vushtrrisë: Gjimnazin "Eqrem Çabej" dhe Shkollën e Mesme Profesionale "Bahri Haxha", përmes themelimit të Klubeve të Aktivizmit të Nxënësve.

Qëllimi i projektit është fuqizimi i nxënësve përmes zhvillimit të mendimit kritik, lidershipit dhe qytetarisë aktive, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore dhe institucionale.

Marrëveshja e Bashkëpunimit me Terre des hommes Kosova

Drejtoria Komunale e Arsimit ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me organizatën Terre des hommes Kosova (TdHK), me qëllim të zhvillimit dhe funksionalizimit të një platforme digjitale për raportimin e rasteve të abuzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.

Bashkëpunimi parasheh pilotimin e platformës në shkolla, koordinimin e aktiviteteve vetëdijesuese dhe parandaluese, si dhe fuqizimin e mekanizmave për raportim të sigurt dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Memorandumi i Mirëkuptimit me Volontari nel Mondo RTM

Drejtoria Komunale e Arsimit ka lidhur Memorandum Mirëkuptimi me organizatën Volontari nel Mondo RTM, në kuadër të projektit PEDAKOS II – Aleanca për Zhvillimin e Arsimit Parashkollor në Kosovë, të financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS).

Bashkëpunimi synon fuqizimin e kapaciteteve të stafit të arsimit parashkollor përmes trajnimeve, inovacionit pedagogjik dhe promovimit të praktikave gjithëpërfshirëse dhe edukimit me në qendër fëmijën, përfshirë qasjen Reggio Emilia.

Memorandumi i Mirëkuptimit me KEC – Qendra për Arsim e Kosovës

Drejtoria Komunale e Arsimit ka lidhur Memorandum Mirëkuptimi me KEC – Qendra për Arsim e Kosovës. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, më 26 dhe 27 shtator 2026 janë organizuar trajnime dyditore me temën "Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme", në të cilat kanë marrë pjesë 26 mësimdhënës të klasave I–V.

Ky aktivitet synon avancimin e kompetencave profesionale të mësimdhënësve dhe përmirësimin e praktikave mësimore, me fokus në zhvillimin e shkathtësive të leximit te nxënësit në klasat e hershme.

2.4. Takimet, punëtoritë dhe zhvillimi profesional

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar takime, punëtori dhe aktivitete profesionale, ndër të cilat:

- Takime të rregullta me Inspektoratin Rajonal të Arsimit
- Punëtori me MASH për Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2035+
- Punëtori e përbashkët në mes të MASH dhe Drejtorëve Komunalë të Kosovës
- Punëtori- Prezentimi i Instrumentit për Vlerësimin e Brendshëm të Institucionit të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme
- Takime të rregullta me përfaqësues të KFOR-it Slloven
- Pjesëmarrje në takimet e Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës
- Pjesëmarrje e përfaqësuesve të DKA-së, në trajnime profesionale për menaxhimin e projekteve dhe qasjen në fondet e Bashkimit Evropian.
- Punëtori për parandalimin, referimin dhe raportimin e dhunës në shkolla. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, në bashkëpunim me ACCESS-in dhe Agjencinë për Barazi Gjinore, ka realizuar një punëtori me drejtorë, mësimdhënës dhe bashkëpuntorë profesional, me fokus në parandalimin e dhunës, identifikimin dhe raportimin e rasteve në institucionet arsimore. Përmes këtyre aktiviteteve synohet forcimi i mekanizmave të mbrojtjes, reagimi në kohë reale dhe me përgjegjësi institucionale dhe krijimi i një mjedisi shkollor të sigurt për të gjithë nxënësit. Nga kjo puntori është hartuar draft plani/protokolli për menaxhimin, referimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në mjediset shkollore dhe dokumentet përcjellëse, këto janë dokumente shumë të rëndësishme me bazë në Rregulloren QKR- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar.

Hartimi i Draft-Rregullores për Arsimin Parauniversitar

Duke marrë parasysh se Rregullorja aktuale për Arsimin Parauniversitar në Komunën e Vushtrrisë, e miratuar në vitin 2014, nuk reflekton plotësisht realitetin aktual, zhvillimet në sektorin e arsimit dhe ndryshimet në kuadrin ligjor në fuqi, Drejtoria Komunale e Arsimit ka iniciuar procesin e hartimit të një rregulloreje të re.

Qëllimi i kësaj iniciative është përditësimi dhe harmonizimi i bazës normative që rregullon funksionimin e arsimit parauniversitar në Komunën e Vushtrrisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat aktuale të institucioneve arsimore.

Për këtë qëllim është angazhuar grupi punues dhe janë organizuar punëtori për hartimin e dokumentit. Drafti i rregullores është në fazën përfundimtare të përgatitjes, pas së cilës do të procedohet për konsultim dhe dëgjim publik, e më pas për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

Përmes kësaj iniciative synohet krijimi i një kornize të përditësuar rregullative, e cila do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit, qartësimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar në komunë.

Punëtoria "Të drejtat tona" – Promovimi i të drejtave të fëmijëve

Në bashkëpunim me KFOR-in Slloven është organizuar punëtoria me temën "Të drejtat tona", e cila ka pasur në fokus njohjen, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në institucionet arsimore.

Në kuadër të këtij aktiviteti janë certifikuar gjithsej 50 mësimdhënëse, të cilat janë pajisur edhe me materiale përkatëse dhe udhëzime praktike për zbatimin e njohurive të fituara në punën e përditshme me nxënësit.

Aktiviteti synon të fuqizojë rolin e mësimdhënësve në vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe në krijimin e një mjedisi shkollor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe mbështetës.

2.5. Vizitat studimore dhe shkëmbimi i përvojave

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e arsimit, janë realizuar vizita studimore dhe zyrtare, ndër të cilat:

- Vizita studimore e përfaqësuesve të SHMT "Lutfi Musiqi" në Holandë dhe Finlandë, në kuadër të projektit CG-International.
- Vizita në Denizli të Turqisë, nga data 23 deri më 27 shkurt, ku një grup prej pesë nxënësish dhe dy mësimdhënësish të SHMT "Lutfi Musiqi", me mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit dhe Kryetarit të Komunës, vizituan shkollën partnere dhe zhvilluan aktivitete të ndryshme.
- Vizita dhe turneu muzikor në Itali nga nxënësit e Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko", gjatë të cilit janë mbajtur katër koncerte artistike në Termoli, Montecilfone dhe Chieuti. Në kuadër të vizitës janë vendosur edhe bazat për bashkëpunim ndërmjet shkollave. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës, Drejtoresha e Arsimit, zyrtarja e DKA-së dhe drejtori i shkollës.
- Vizita zyrtare në Växjö të Suedisë, gjatë së cilës janë zhvilluar aktivitete dhe takime për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në fushën e arsimit, me theks të veçantë në organizimin dhe menaxhimin e shkollave, arsimin profesional dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore.
- Vizita studimore në Shqipëri, me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.
- Vizita studimore e përfaqësuesve të SHMP "Bahri Haxha" në Athinë, në kuadër të projektit CG-International.
- Vizita e ekspertëve zviceranë të arsimit parashkollor në institucionet arsimore të Komunës së Vushtrrisë.
- Vizita në Qendrën Arsimore të Komunitetit VORAE në Prelluzhë.

Vizita zyrtare në Gemlik dhe Serdivan të Turqisë

Në shtator 2026, delegacioni i Komunës së Vushtrrisë ka realizuar vizitë zyrtare në komunat Gemlik dhe Serdivan të Republikës së Turqisë. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë përfaqësues të disa drejtorive komunale, përfshirë Drejtorinë Komunale të Arsimit, Drejtorinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë e Diaspores dhe përfaqësues nga Komuna e Vushtrrisë.

Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira, si dhe shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim në fusha me interes të përbashkët, me theks të veçantë në fushën e arsimit.

Pas kësaj vizite është konkretizuar procesi i binjakëzimit ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Serdivanit, në kuadër të Sakaryas, duke hapur mundësi të reja për bashkëpunim të mëtejmë, shkëmbim përvojash dhe realizimin e projekteve të përbashkëta në të ardhmen.

Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale në Dresden të Gjermanisë

Më 29 dhe 30 shtator 2026, Drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Vushtrri ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale me temën: "Arsimi dhe Edukimi i të Rriturve si Përgjegjësi e Autoriteteve Lokale", e cila është mbajtur në Dresden të Gjermanisë.

Konferenca ka trajtuar rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale në zhvillimin e arsimit dhe edukimit të të rriturve, duke ofruar mundësi për shkëmbimin e përvojave, praktikave të mira dhe diskutimin e qasjeve për avancimin e këtij sektori.

Pjesëmarrja në këtë konferencë ka kontribuar në zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe njohjen me praktika të ndryshme evropiane, të cilat mund të shërbejnë si referencë për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit në Komunën e Vushtrrisë.

2.6. Projektet dhe iniciativat zhvillimore

Gjatë periudhës raportuese janë mbështetur dhe realizuar projekte të ndryshme në fushën e arsimit:

- Vazhdimi i renovimit të SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë, në bashkëpunim me Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara dhe MASHTI-n.
- Përzgjedhja e Gjimnazit "Eqrem Çabej" ndër tetë projektet fituese të programit BELI.
- Dhurimi i projektit "Panorama" për Gjimnazin "Eqrem Çabej", i cili mundëson prezantimin virtual 360° të objektit shkollor.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me 18 biznese lokale për realizimin e mësimit dual për 30 nxënës të SHMT "Lutfi Musiqi".

Erasmus+ – CultiVeting

SHMLP "Bahri Haxha" ka qenë pjesë e programit Erasmus+, përmes projektit CultiVeting, duke u renditur ndër shkollat e para publike të përfshira në këtë program.

Në kuadër të projektit janë realizuar trajnime për mësimdhënësit dhe aktivitete me karakter edukativ e profesional. Gjithashtu, nxënësit e shkollës kanë realizuar një vizitë studimore në Athinë, duke përfituar përvoja të reja dhe mundësi të shkëmbimit ndërkulturor.

Projekti "Superschools"Shkolla është pjesë e projektit "Superschools", i cili mbështetet nga Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Përmes këtij projekti synohet fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave, shkëmbimi i përvojave, zhvillimi i dialogut dhe krijimi i mundësive të reja për nxënësit.

- Pjesëmarrja e nxënësve në projektin "Drejt Malit", të mbështetur nga MASHTI.

GARAT E DITURISË DHE AKTIVITETET SPORTIVE

Gjatë vitit shkollor 2025/2026, nxënësit e institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë kanë marrë pjesë në gara të ndryshme të diturisë dhe aktivitete sportive, duke arritur rezultate të rëndësishme në nivel komunal, rajonal, republikan dhe ndërkombëtar.

Këto rezultate dëshmojnë angazhimin e nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe përkushtimin e institucioneve arsimore në zhvillimin e potencialit akademik dhe sportiv të nxënësve.

3.1. Garat e diturisë

- Nxënësja Mirjeta Hasani nga SHFMU "Andon Zako Çajupi", fitoi vendin e parë në garën e shkrimit në gjuhën gjermane "Schreibwettbewerb im Rahmen der Tage der Deutschen Sprache 2026", në kategorinë e shkollave publike për klasat VI–IX.
- Nxënësit e SHFMU "Emin Duraku" në Novolan, arritën rezultate të shkëlqyera në Olimpiadën e Fizikës, duke fituar vendin e parë për klasat VII dhe VIII, ndërsa vendin e tretë për klasën IX.
- Në garën komunale të eseve në lëndën e Gjuhës Shqipe, nxënësja e SHFMU "Emin Duraku", fitoi vendin e parë në kategorinë e klasave të teta.
- SHFMU "Liria" në Stroc u dallua në garat e Gjuhës Shqipe. Nxënësja Sumea Aliu u shpall "Eseistja më e mirë" në nivel komunal, ndërsa nxënësit Rrezart Aliu dhe Adnit Saraçi u kualifikuan në finalen e Olimpiadës së Gjuhës Shqipe, të organizuar nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë. Nxënësja Rrezarta Aliu fitoi vendin e tretë.
- SHFMU "Migjeni" në Stanoc të Epërm u rendit në katërshen finale të Olimpiadës Shtetërore të Gjuhës Shqipe.
- SHMU-2 në Vushtrri, fitoi vendin e parë në Garat Komunale të Diturisë. Vendin e dytë e fitoi SHFMU "28 Nëntori" në Vërnicë, ndërsa vendin e tretë SHFMU "Latif Berisha" në Dobërllukë.

- U organizua Olimpiada Komunale e Gjuhës Shqipe për nxënësit e klasave të nënta. Vendin e parë e fitoi SHFMU "Liria" në Stroc, vendin e dytë SHFMU "Andon Zako Çajupi", ndërsa vendin e tretë SHMU-2.
- Nxënësja Jara Meniqi u rendit në vendin e katërt në Olimpiadën Republikane të Fizikës.
- Nxënësi Laurent Maxhuni, fitoi vendin e parë në Olimpiadën Republikane të Fizikës, ndërsa nxënësi Redon Hajrizi u rendit në vendin e dytë. Të dy nxënësit u kualifikuan për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare.

3.2. Garat sportive

- Ekipi i futsallit për djem (klasat VI–VII) i SHFMU "Andon Zako Çajupi" u shpall kampion në nivel komunal.
- Ekipi i futsallit për vajza i së njëjtës shkollë fitoi vendin e parë në nivel komunal dhe siguroi pjesëmarrjen në kampin sportiv-rekreativ dimëror në Brezovicë, të organizuar në kuadër të aktiviteteve të MASHTI-t.
- Ekipi i volejbollit për djem i SHFMU "Andon Zako Çajupi" u shpall kampion në nivel komunal.
- SHFMU "Emin Duraku" në Novolan fitoi vendin e parë në garat komunale dhe vendin e dytë në nivel rajonal në disiplinën e volejbollit për vajza.
- Ekipi i basketbollit për vajza i SHMU-2 u shpall kampion në nivel republikan.
- Nxënësit e Gjimnazit "Eqrem Çabej" morën pjesë në garat sportive ndërkombëtare në Ohër, ku ekipi i futsallit për vajza shënoi fitore ndaj përfaqësueses së Gjeorgjisë.
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" arriti rezultate të shkëlqyera në garat sportive republikane, duke fituar vendin e parë në hendboll (vajza), futsall (vajza), volejboll (djem) dhe pingpong.
- Në bashkëpunim me Innovation Academy, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi garën komunale në shah për nxënësit e klasave të pesta. Vendin e parë e fitoi SHFMU "Mustafë Venhari" në Vushtrri.

Rezultatet e arritura në garat e diturisë dhe aktivitetet sportive dëshmojnë angazhimin e nxënësve, mësimdhënësve dhe institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë. Këto suksese kanë kontribuar në promovimin e vlerave arsimore dhe sportive dhe në përfaqësimin e komunës në nivele të ndryshme.

INVESTIMET E REALIZUARA NGA KOMUNA

Në kuadër të investimeve dhe mbështetjes së ofruar nga Komuna për institucionet arsimore, gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete:

- SHFMU "Dëshmorët" – Zhilivodë është pajisur nga Drejtoria Komunale e Arsimit me një televizor 65 inç dhe një laptop ASUS Vivobook, me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin e procesit mësimor dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.
- SHFMU "12 Qershori" – Mihaliq është pajisur me pajisje për klimatizim, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të përshtatshme për nxënësit dhe stafin shkollor.
- Në SHMU-1 Vushtrri është realizuar rregullimi i trotuarit përreth objektit shkollor, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe qasjes së nxënësve dhe personelit në hapësirat shkollore.
- SHFMU "Latif Berisha" – Dobërllukë është pajisur me dy laptopë, një kompjuter dhe dy televizorë LED, të cilët do të shfrytëzohen për avancimin e procesit edukativo-arsimor dhe digjitalizimin e mësimdhënies.

- SHFMU "Migjeni" – Stanoc i Epërm ka përfituar mbështetje nga Komuna përmes sigurimit të 250 luleve sezonale dhe disa titujve të lektyrave për bibliotekën e shkollës, duke kontribuar në përmirësimin e ambientit shkollor dhe pasurimin e fondit të leximit.

Përmes këtyre investimeve është vazhduar mbështetja institucionale për përmirësimin gradual të infrastrukturës, pajisjeve dhe kushteve të përgjithshme në institucionet arsimore të komunës.

DONACIONET DHE MBËSHTETJA NGA PARTNERËT

Gjatë periudhës raportuese, institucionet arsimore të Komunës së Vushtrrisë kanë përfituar donacione të ndryshme nga organizata, biznese, shtëpi botuese, individë dhe partnerë të tjerë mbështetës.

Këto donacione kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës, pasurimin e bibliotekave shkollore, pajisjen me mjete teknologjike dhe krijimin e ambienteve më të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

5.1. Donacione në pajisje dhe inventar shkollor

- SHFMU "Nedakoc" ka përfituar donacion prej gjashtë (6) klimave nga kompania Gorenje, duke përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe punës në ambientet shkollore.
- SHMP "Bahri Haxha" ka bashkëpunuar me SH.P.K. "Rikont". Në firmën ushtrimore të drejtimit të Ekonomisë është instaluar softueri i kontabilitetit, si donacion nga kjo kompani. Softueri u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi praktike në përdorimin e programeve profesionale të kontabilitetit, duke e afruar procesin mësimor me kërkesat reale të bizneseve.
- SHFMU "Adem Voca" – Pasomë ka përfituar donacion prej pesë (5) klimave (kondicionerëve) nga kompania GNTC Group, me seli në Prishtinë.
- SHMU-1 Vushtrri ka pranuar donacion prej pesë (5) klimave nga kompania Gorenje.
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtrri ka përfituar një tabelë pingpongu nga Ordinanca Bava Dent, duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative të nxënësve.
- Gjimnazi "Eqrem Çabej" ka pranuar një tabelë interaktive (smart tabelë) nga kompania SH.P.K. Butrinti, e cila do të shfrytëzohet për avancimin e mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.
- Humanisti dhe biznesmeni nga diaspora, Shahin Dervishaj, i ka dhuruar Gjimnazit "Eqrem Çabej" pajisje me vlerë prej 1,500 euro, në mbështetje të përmirësimit të kushteve shkollore.

5.2. Donacione në libra dhe materiale edukative

- SHFMU "Andon Zako Çajupi" – Vushtrri ka përfituar rreth 200 tituj librash dhe lektyrash shkollore për nxënësit e klasave I–V nga shtëpia botuese "Dukagjini", duke kontribuar në pasurimin e bibliotekës shkollore.
- SHFMU "Lumadh" ka përfituar lektyra shkollore për ciklin I–V nga shtëpia botuese "Dukagjini", duke pasuruar fondin e bibliotekës dhe duke nxitur kulturën e leximit te nxënësit.

5.3. Donacione për përmirësimin e ambienteve shkollore

- Me iniciativën dhe angazhimin vullnetar të prindërve të klasave IV/1 dhe IX/1 të SHFMU "Andon Zako Çajupi", është realizuar rregullimi i plotë i klasave, përfshirë ngjyrosjen, pastrimin dhe sistemimin e ambienteve mësimore.
- SHFMU "Liria" – Stroc ka pranuar donacion nga z. Kushtrim Klinaku, i cili ka dhuruar një makinë fotokopjuese HP Laser MFP 135a, si dhe nga donatori Fidan Zeqiri, i cili ka mbështetur shkollën me 400 euro materiale për realizimin e muralit me motivin "Mbretëresha Teutë".
- SHFMU "Lummadh" ka përfituar materiale për lyerjen e objektit shkollor dhe aneksit të ndarë nga fabrika gjermane e ngjyrave Bitter Deutsche Farben, duke përmirësuar dukshëm pamjen dhe ambientin e shkollës.

Donacionet e pranuara dëshmojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, komunitetit, bizneseve dhe partnerëve mbështetës. Këto iniciativa kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e një mjedisi më funksional e stimulues për procesin edukativo-arsimor.

SUKSESI I NXËNËSVE NË PËRFUNDIM TË VITIT SHKOLLOR 2025/2026

Në përfundim të vitit shkollor 2025/2026, institucionet arsimore të Komunës së Vushtrrisë kanë realizuar vlerësimin e arritjeve të nxënësve në përputhje me kurrikulën, udhëzimet administrative dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e nxënësve.

Procesi i vlerësimit është zhvilluar me qëllim të evidentimit të nivelit të arritjeve të nxënësve, identifikimit të fushave ku nevojitet mbështetje shtesë dhe planifikimit të masave për përmirësimin e rezultateve mësimore.

Në kuadër të analizës së suksesit janë marrë parasysh suksesi i përgjithshëm i nxënësve, përqindja e kalueshmërisë, rezultatet sipas niveleve arsimore, nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm dhe nxënësit që kanë nevojë për përkrahje shtesë.

6.1. Suksesi i nxënësve të klasave I–V

Suksesi në fund të vitit shkollor 2025/2026, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Periudha	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2026	69.17%	18.25%	9.27%	3.16%	0.04%	0.07%
2025	67.22%	19.12%	10.57%	2.98%	0.07%	0%
Krahasueshmëria	1.95%	-0.87%	-1.30%	0.18%	-0.03%	0.07%

6.2. Suksesi i nxënësve të klasave VI–IX

Suksesi në fund të vitit shkollor 2025/2026, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Periudha	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Kanë përsëritur klasën	Të panotuar
2026	29.08%	21.16%	27.71%	20.79%	1.23%	0.03%
2025	28.85%	21.39%	26.51%	22.74%	0.38%	0.13%
Krahasueshmëria	0.23%	-0.23%	1.20%	-1.95%	0.85%	-0.10%

6.3. Suksesi i nxënësve të klasave X–XII

Suksesi në fund të vitit shkollor 2025/2026, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Periudha	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Kanë përsëritur klasën	Të panotuar
2026	13.91%	22.16%	32.97%	30.78%	0.00%	0.18%
2025	13.85%	20.24%	32.93%	30.92%	0.89%	1.16%
Krahasueshmëria	0.06%	1.92%	0.04%	-0.14%	-0.89%	-0.98%

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë nevojën për vazhdimin e angazhimit në ngritjen e suksesit të nxënësve dhe në mbështetjen e kategorive që kanë nevojë për përmirësim.

6.4. Evidenca e mungesave të nxënësve

Periudha gjatë vitit shkollor 2025/2026	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Nr. i nxënësve	Në raport për nxënës – mungesa të arsyeshme	Në raport për nxënës – mungesa të paarsyeshme
Gjysmëvjetori i parë	123214	40050	10569	0.09	3.79
Gjysmëvjetori i dytë	204330	79063	10569	0.05	7.48

REZULTATET E VLERËSIMEVE TË JASHTME

7.1. Testi i Arritshmërisë 2025/2026

Në vijim paraqiten rezultatet e Testit të Arritshmërisë sipas institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë.

Nr.	Shkolla	Nr. i nxënësve	Kalueshmëria %	Meshkuj %	Femra %
1	SHFMU "Dëshmorët"	1	68.00	68.00	0.00
2	SHFMU 2	235	56.55	55.58	57.44
3	SHFMU "Azem Bejta"	6	56.23	55.50	59.50
4	SHFMU "Emin Duraku"	11	55.00	53.33	55.63
5	SHMU-1	156	54.18	54.90	55.62
6	SHFMU "Mustafë Shyti"	5	53.60	46.00	84.00
7	SHFMU "A.Z. Çajupi"	82	50.09	46.57	52.98
8	SHFMU "Adem Voca"	5	49.00	41.70	60.00
9	SHFMU "Enver Hadri"	35	47.08	48.31	46.28
10	SHFMU Nedakoc	11	46.91	20.18	26.73
11	SHFMU "7 Marsi"	26	46.53	42.64	51.08
12	SHFMU "Nazmi Zhegrova"	19	46.05	44.50	46.90
13	SHFMU "Liria"	20	46.05	41.60	50.50
14	SHFMU "Martirët"	14	45.79	51.40	42.67
15	SHFMU Lummadh	12	45.75	42.80	47.86
16	SHFMU "Bahri Kuqi"	24	45.21	43.07	49.28
17	SHFMU "Lumni Surdulli"	12	45.08	39.86	52.20
18	SHFMU "Gj.K. Skënderbeu"	13	44.44	45.92	43.16
19	SHFMU "28 Nëntori"	14	44.05	43.85	44.33
20	SHFMU "Pestovë"	16	43.81	38.38	49.25
21	SHFMU "Abdyl Frashëri"	16	42.06	38.08	54.00
22	SHFMU "Migjeni"	35	42.06	38.08	54.00
23	SHFMU "12 Qershori"	14	41.71	38.14	45.29
24	SHFMU "Hajrullah Shala"	20	41.15	23.42	61.04
25	SHFMU "Latif Berisha"	17	41.12	31.81	55.58
26	SHFMU "Jusuf Gërvalla"	12	40.83	36.75	42.87
27	SHFMU "Rilindja"	43	39.74	36.61	44.52
28	SHFMU "Bajram Curri"	14	39.42	39.83	39.12
29	SHFMU "Rexhep Musa"	3	39.00	41.50	34.00
Gjithsej		**891**	**46.86**	**42.82**	**48.71**

Sipas rezultateve të Testit të Arritshmërisë për vitin shkollor 2025/2026, mesatarja e përgjithshme e kalueshmërisë në nivel komunal është 46.86%.

Nga analiza, sipas gjinisë, rezulton se nxënëset femra kanë arritur përqindje më të lartë të kalueshmërisë (48.71%), krahasuar me nxënësit meshkuj (42.82%).

Rezultatet tregojnë dallime ndërmjet institucioneve arsimore dhe evidentojnë nevojën për analiza të vazhdueshme dhe masa mbështetëse, veçanërisht në shkollat me rezultate më të ulëta, me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve.

7.2. Testi i Maturës 2026

Testi i Maturës Shtetërore për vitin 2026 është mbajtur më 20 qershor 2026, në 5 qendra testimi. Në këtë proces kanë marrë pjesë nxënësit e tri institucioneve të arsimit të mesëm të lartë të Komunës së Vushtrrisë:

- Gjimnazi "Eqrem Çabej";
- SH.M.T. "Lutfi Musiqi";
- SH.M.P. "Bahri Haxha".

Në tabelën në vijim paraqiten rezultatet e kalueshmërisë dhe krahasimi me vitin paraprak.

Nr.	Institucioni	Kalueshmëria 2025	Kalueshmëria 2026	Ndryshimi (%)
1	Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	90.00%	93.73%	+3.73%
2	SH.M.P. "Bahri Haxha" Vushtrri	42.00%	44.26%	+2.26%
3	SH.M.T. "Lutfi Musiqi" Vushtrri	41.84%	50.00%	+8.16%

Rezultatet e Testit të Maturës 2026, tregojnë përmirësim të kalueshmërisë në të tri institucionet e arsimit të mesëm të lartë të Komunës së Vushtrrisë, krahasuar me vitin paraprak.

Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri, ka ruajtur nivelin më të lartë të suksesit, me 93.73% kalueshmëri. SH.M.P. "Bahri Haxha" Vushtrri, ka shënuar rritje të kalueshmërisë nga 42.00% në 44.26%, ndërsa SH.M.T. "Lutfi Musiqi" Vushtrri, ka shënuar përmirësimin më të madh, duke u rritur nga 41.84% në 50.00%.

Në përgjithësi, tri institucionet kanë treguar progres në rezultatet e Testit të Maturës 2026. Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin e institucioneve shkollore, mësimdhënësve dhe nxënësve në përgatitjen për Testin e Maturës dhe në ngritjen e cilësisë së arsimit të mesëm të lartë.

SFIDAT DHE ÇËSHTJET QË KËRKOJNË TRAJTIM

Përkundër aktiviteteve dhe rezultateve të arritura gjatë vitit shkollor 2025/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit ka evidentuar disa sfida dhe çështje që kërkojnë trajtim, planifikim dhe mbështetje të mëtejshme institucionale.

Ndër sfidat kryesore janë:

1. **Kufizimet buxhetore dhe nevoja për sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare**, të cilat kanë ndikuar në mundësinë e realizimit të plotë të disa prioriteteve dhe aktiviteteve në fushën e arsimit.
2. **Pamundësia për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë gjatë vitit 2026**, si pasojë e kufizimeve buxhetore, duke pamundësuar realizimin e kësaj forme të mbështetjes nga Komuna e Vushtrrisë.
3. **Çështja e mësimdhënësve të papërfshirë në listën e pagave**, e cila kërkon trajtim dhe zgjidhje institucionale për rregullimin e statusit të tyre dhe sigurimin e vazhdimësisë së procesit edukativo-arsimor, në përputhje me procedurat dhe legjislacionin në fuqi.
4. **Nevoja për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në vlerësimet e jashtme**, veçanërisht në institucionet arsimore me rezultate më të ulëta, përmes analizave të thelluara dhe masave konkrete për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies.
5. **Nevoja për forcimin e mbështetjes për fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore**, përfshirë sigurimin e mekanizmave të nevojshëm për vlerësim, mbështetje profesionale, përfshirje dhe subvencionim.
6. **Nevoja për investime të mëtejshme në infrastrukturën shkollore**, përfshirë renovimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e objekteve shkollore që kërkojnë ndërhyrje.
7. **Nevoja për furnizim të vazhdueshëm me pajisje teknologjike, mjete didaktike dhe inventar shkollor**, me qëllim të krijimit të kushteve më të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
8. **Nevoja për rritjen e mundësive për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe stafit arsimor**, në funksion të ngritjes së kompetencave profesionale dhe përmirësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor.
9. **Nevoja për sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme financiare për aktivitetet që lidhen me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore**, përfshirë mbështetjen për shërbimet dhe programet përkatëse.
10. **Nevoja për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe partneritetit** me institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe partnerët zhvillimorë, me qëllim të sigurimit të burimeve dhe mundësive shtesë për zhvillimin e arsimit.
11. **Nevoja për forcimin e bashkëpunimit me prindërit, komunitetin dhe bizneset lokale**, në funksion të mbështetjes së institucioneve arsimore dhe krijimit të një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e nxënësve.
12. **Nevoja për forcimin e arsimit profesional dhe zgjerimin e bashkëpunimit me bizneset**, me qëllim të krijimit të më shumë mundësive për zhvillimin e mësimit dual dhe lidhjen e arsimit me tregun e punës.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjatë vitit shkollor 2025/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh dhe ka ndërmarrë masa të ndryshme në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të arsimit në komunë.

Përmes bashkëpunimit me institucionet arsimore, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoratin Rajonal të Arsimit dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë, janë realizuar aktivitete në fushën e menaxhimit dhe monitorimit, zhvillimit profesional, arsimit profesional, mësimit dual, projekteve, investimeve, donacioneve, aktiviteteve sportive dhe garave të diturisë.

Rezultatet e nxënësve në garat e diturisë dhe aktivitetet sportive, si dhe përmirësimi i rezultateve në Testin e Maturës në të tri institucionet e arsimit të mesëm të lartë, paraqesin tregues pozitivë të angazhimit të institucioneve arsimore.

Në të njëjtën kohë, rezultatet e Testit të Arritshmërisë dhe disa tregues të suksesit të nxënësve, veçanërisht në arsimin e mesëm të ulët, kërkojnë analiza të mëtejshme dhe ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e rezultateve dhe ngritjen e cilësisë së arsimit.

Në bazë të aktiviteteve të realizuara, rezultateve të arritura dhe sfidave të evidentuara, rekomandohet:

1. Të sigurohen mjete të mjaftueshme buxhetore për sektorin e arsimit, me prioritet për aktivitetet dhe nevojat që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit dhe mirëqenien e nxënësve.
2. Të planifikohet dhe të mundësohet rikthimi i skemës së bursave për studentë, në përputhje me mundësitë buxhetore të Komunës së Vushtrrisë, si formë e rëndësishme e mbështetjes së studentëve.
3. Të ndërmerren veprimet e nevojshme institucionale për zgjidhjen e çështjes së mësimdhënësve që nuk janë të përfshirë në listën e pagave, me qëllim të rregullimit të statusit të tyre dhe sigurimit të vazhdimësisë së procesit edukativo-arsimor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat përkatëse.
4. Të hartohen dhe zbatohen masa konkrete për përmirësimin e rezultateve në vlerësimet e jashtme, veçanërisht në institucionet arsimore me rezultate më të ulëta, duke u bazuar në analiza të detajuara të rezultateve.
5. Të fuqizohet mbështetja për fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përmes vlerësimit të rregullt, mbështetjes profesionale, sigurimit të asistentëve dhe mekanizmave të tjerë mbështetës, si dhe përmes skemave të subvencionimit kur është e nevojshme.
6. Të vazhdohet me investimet në infrastrukturën shkollore, duke u dhënë përparësi objekteve që kanë nevojë më të madhe për renovim, mirëmbajtje dhe përmirësim të kushteve të sigurisë dhe mësimnxënies.
7. Të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm me pajisje teknologjike, mjete didaktike dhe inventar shkollor, me qëllim të modernizimit dhe përmirësimit të procesit edukativo-arsimor.
8. Të rriten mundësitë për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe stafit arsimor, përmes trajnimeve, programeve profesionale dhe formave të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm.
9. Të sigurohet mbështetje e qëndrueshme financiare për programet dhe aktivitetet që synojnë përfshirjen e fëmijëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, duke përfshirë edhe mekanizmat e subvencionimit.

10. Të zgjerohet bashkëpunimi me institucionet qendrore, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, sektorin privat dhe partnerët zhvillimorë, me qëllim të sigurimit të projekteve, donacioneve dhe mbështetjes shtesë për sektorin e arsimit.
11. Të forcohet bashkëpunimi me prindërit, komunitetin dhe bizneset lokale, në funksion të përmirësimit të mbështetjes për institucionet arsimore dhe nxënësit.
12. Të vazhdohet dhe zgjerohet bashkëpunimi me bizneset në fushën e arsimit profesional dhe mësimit dual, duke krijuar më shumë mundësi për aftësimin praktik dhe përgatitjen e nxënësve për tregun e punës.

PËRGATITJET DHE FILLIMI I VITIT TË RI SHKOLLOR 2026/2027

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për përgatitjen dhe organizimin e fillimit të vitit të ri shkollor 2026/2027, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e rregullt të procesit edukativo-arsimor.

Viti i ri shkollor 2026/2027 ka filluar më 1 shtator 2026, në përputhje me kalendarin shkollor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Gjatë muajit gusht, institucionet edukativo-arsimore kanë realizuar përgatitjet teknike dhe organizative për fillimin e vitit të ri shkollor. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përgatitjes së objekteve shkollore, klasave, hapësirave të përbashkëta dhe pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka qenë në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtuesit e shkollave për përcjelljen e gjendjes në institucione dhe identifikimin e nevojave, me qëllim që procesi mësimor të fillojë dhe të zhvillohet në kushte sa më të përshtatshme.

Në kuadër të përgatitjeve është përcjellë edhe organizimi i personelit dhe i procesit mësimor, si dhe funksionimi i institucioneve shkollore në përputhje me nevojat e tyre.

Investimet në infrastrukturën shkollore dhe përmirësimi i kushteve për zhvillimin e procesit mësimor

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027, janë realizuar investime të rëndësishme në infrastrukturën shkollore dhe në përmirësimin e kushteve për nxënësit dhe personelin arsimor.

Gjatë këtij viti shkollor, SHF "Mutafë Venhari" ka filluar zhvillimin e procesit mësimor në objektin e ri shkollor, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-arsimore.

Po ashtu, në SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë ka përfunduar renovimi i objektit shkollor, i cili është pajisur në tërësi me inventar të ri, duke mundësuar krijimin e një ambienti më funksional dhe më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Edhe për vitin shkollor 2026/2027, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka mundësuar aplikimin e prindërve për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore përmes platformës E-Kosova. Aplikimi për subvencionim ka qenë i hapur deri në fillim të muajit shtator. Ky proces ka pasur

për qëllim mbështetjen e familjeve dhe lehtësimin e përgatitjeve të nxënësve për fillimin e vitit të ri shkollor.

10.1. Institucionet arsimore

Në Komunën e Vushtrrisë funksionojnë gjithsej 38 institucione publike arsimore, të organizuara si në vijim:

Lloji i institucionit	**Numri**
Institucione parashkollore publike	3
Shkolla fillore (klasat I–V)	3
Shkolla të mesme të ulëta (klasat VI–IX)	2
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (klasat I–IX)	27
Shkolla të mesme të larta	3
Gjithsej	**38**

Përveç institucioneve publike, në komunë funksionojnë edhe institucione në sektorin publiko-privat dhe privat:

- **Sektori publiko-privat:** 2 çerdhe me bazë në komunitet, IP "Margherita Kids", në bashkëpunim me OJQ-në CIPOF, në fshatrat Stanoc i Epërm dhe Shtitaricë.
- **Sektori privat:** 6 institucione parashkollore private dhe 1 shkollë e mesme e lartë private e mjekësisë, "Vicianamed".

Gjithashtu, funksionon edhe paralelja e ndarë e Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko".

10.2. Numri i nxënësve

Sipas të dhënave për fillimin e vitit shkollor 2026/2027, në institucionet edukativo-arsimore janë të përfshirë gjithsej 11,409 nxënës, të shpërndarë sipas niveleve si në vijim:

Niveli i arsimit	**Numri i nxënësve**
Niveli 0 Arsimi Parashkollor	430
Arsimi Parafillor	635
Niveli 1 (klasat I–V)	4,478
Niveli 2 (klasat VI–IX)	3,765
Niveli 3 (klasat X–XII)	2,101
Gjithsej	**11,409**

10.3. Numri i paraleleve

Niveli	Numri i paraleleve
Parashkollor	15
Parafillor	43
Fillor (I–V)	269
I mesëm i ulët (VI–IX)	205
I mesëm i lartë (X–XII)	106
Gjithsej	**638**

10.4. Personeli arsimor dhe administrativ

Për realizimin e procesit edukativo-arsimor dhe funksionimin e institucioneve arsimore, sipas të dhënave të siguruara, janë të angazhuar gjithsej 1,163 punonjës, sipas kategorive në vijim:

Kategoria	Numri
Zyrtarë të DKA-së	11
Drejtorë	34
U.D. drejtorë	4
Zëvendësdrejtorë	8
Pedagogë	12
Psikologë	10
Asistentë	26
Bibliotekistë	9
Këshilltarë të karrierës	2
Sekretarë	11
Punëtorë teknikë	140
Edukatore	84
Mësimdhënës klasorë	266
Mësimdhënës lëndorë (VI–IX)	372
Mësimdhënës lëndorë (X–XII)	174
Gjithsej	**1,163**

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri mbetet e përkushtuar në vazhdimin e punës së koordinuar me të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe akterët relevantë, me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim, përmirësimit të kushteve të punës dhe mësimnxënies, rritjes së përfshirjes dhe barazisë në arsim, si dhe krijimit të mundësive më të mira për të gjithë fëmijët dhe nxënësit e Komunës së Vushtrrisë.

Përmes bashkëpunimit institucional, planifikimit të përgjegjshëm dhe trajtimit të sfidave të evidentuara, DKA do të vazhdojë angazhimin për një sistem arsimor më cilësor, gjithëpërfshirës dhe në funksion të zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve të Komunës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova ▪ Republic of Kosova

Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	04.11.2026
REFERENC-Ë:	08Nr.487
PËR/ZA/TO:	Kryesuesën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë Znj. Melihate Basholli-Latifi, Anëtaret e Komitetit për Politik dhe Financa, Anëtaret e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtori i drejtorisë Drilon Jusufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal e cila përfshinë periudhën nga Janari i këtij viti, DUMM ju informon se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Gjatë periudhës Janar – Nëntor 2026, lidhur me zbatimin e objektivave te parashikuara në planin e lartcekur kryesisht janë mbajte takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullim, takimet e rregullta me nivelin qendror si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë tjera për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta si dhe tashme jemi ne fazen e hartimit te Palnit Zhvillimor Komunal të ri ku bartës i procesit është Komuna e Vushtrrisë, përmes Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe ekipes komunale te caktuar me vendimin nga Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi si dhe mbështetja profesionale për hartimin e dokumentit ofrohet nga Instituti për Shkencë dhe Teknologji – INSI Sh.P.K., ndërsa menaxhimi i kontratës realizohet nga Qemajl Hasani. Procesi përfshin bashkëpunimin e grupit punues, drejtorive komunale, institucioneve sektoriale, ndërmarrjeve publike dhe palëve të interesuara.

Gjatë procesit janë trajtuar profili i komunës, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, nevojat zhvillimore, vizioni dhe skenarët e zhvillimit, korniza hapësinore, infrastruktura, mbrojtja e mjedisit dhe programi i veprimit. Përmbajtja është zhvilluar përmes prezantimeve, konsultimeve dhe koordinimit me sektorët përkatës.

Me datën : 09.10.2026 – është mbajtur Punëtoria e radhës e cila ka pas për bazë vizionimin strategjik dhe shqyrtimin e koncepteve të zhvillimit, është zhvilluar punëtoria me përfaqësues të Komunës, DUMM-së, institucioneve, ndërmarrjeve, operatorëve dhe shoqërisë civile, si dhe ekipin profesional të INSI-së. Janë prezantuar vizioni, skenarët dhe konceptet tematike, si dhe janë evidentuar kërkesa për plotësimin e draftit.

Ndërsa sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024 DUMM në çdo kërkesë të pranuar nga zyrtaret përgjegjës gjatë shqyrtimit të tyre që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale, janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2024.

Me respekt!

Republika e Kosovës

Republika Kosova ▪ Republic of Kosova

Komuna Vushtrri

Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Shërbime Publike

DATË/A	10.11.2026
PËR/ZA/TO:	KPF, Kuvendin Komunal
PËRMES:	z,Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtor i drejtorisë z,Benjamin Shala
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë

Të nderuar anëtar të komitetit për politikë dhe financa, anëtar të kuvendit,

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale. Pra ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, pat hartuar dhe miratuar në kuvend, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026 brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, përveç krijimit të mekanizmit institucional (emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve dhe zyrës për inkasim) dhe mekanizmit financiar (planifikimin e taksës për mbeturina si e hyrë komunale), ka arritur që të bëjë:

- zbatimin e Planit operativ që ka rezultuar me; vazhdimin e kontraktimit të shërbimit me Ndërmarrja Publike Lokale „Përparimi'' për tërë territorin e komunës, vazhdimin e mbledhjes së taksës për mbeturina si e hyrë komunale për vitin 2026, menaxhimi i softwerit pra sistemit të menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit,
- zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe

praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, për zonën e përzgjedhur në qytet me 1500 ekonomi familjare, e cila sasi është duke u paketuar në Qendrën për paketim në Bukosh.
- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë. Gjithashtu është hartuar Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2025 përmes platformës elektronike të instaluar nga AMM (Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit) dhe GIZ.

Tërë këto aktivitete kanë qenë të mbështetura nga konsulenca e vazhdueshme e GIZ-së përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me ç'rast përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të angazhuar, është bërë hartimi i nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të tri komunave të regjionit duke përfshirë Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, me çrast është hartuar Draft Plani Ndër komunal dhe Draft - Marrëveshja për bashkëpunim ndërkomunal.

Ndërsa sa i përket deponive ilegale, komuna së bashku me Ndërmarrja Publike Lokale,,Përparimi''në në kuadër të aktivitetit për eliminimin e deponive ilegale, ka bërë eliminimin e disa deponive ilegale, me çrast aktualisht kemi vetëm 4 deponi ilegale të mëdha dhe disa deponi të vogla të cilat eliminohen në baza ditore nga NPL"Përparimi", sepse pas shtrirjes së shërbimit në tërë territorin e komunës është bërë eliminim i qëndrueshëm i tyre.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë pasur mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e deponive ilegale, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim dhe procesit të kompostimit.

Bazuar në të cekurat më lartë Komuna e Vushtrrisë ka kontribuar vazhdimisht në përmirësimin dhe ruajtjen e Mbrojtjes së Mjedist në tërë territorin e Komunës si dhe veprime të tillë do të ndërmerren edhe në vazhdimësi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova ▪ Republic of Kosova

Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATË/A	05.11.2026
REFERENC-Ë:	22/2026
PËR/ZA/TO:	KPF-ca dhe Kuvendin e Komunës Znj. Melihate Basholli-Latifi, kryesuese
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë z. Bedri Dobra, drejtor z. Azem Bejta Udhëheqës i Sektorit të Pronës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale

Të nderuar,

Bazuar në Planin e Punës së Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë dhe të Kuvendit Komunal, paraqesim Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për periudhën janar-tetor 2026.

Për momentin në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të komunës dhe 16 Kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronave në pronësi të komunës nga të cilat 6 kontrata të përfunduara më 30.10.2026.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të Komunës, ka përpiluar dhe publikuar në Ueb-faqen e Komunës Listën e përgjithshme të pronave komunale.

Gjithashtu, kemi hartuar Listën e veçantë të pronave të komunës të cilat kanë qenë të planifikuara të jepen në shfrytëzim në vitin 2026, e cila listë nuk është miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Gjatë periudhës janar-tetor 2026 nuk janë lidhur kontrata të reja për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Gjatë kësaj periudhe janë dërguar 13 njoftime pronarëve të cilët kanë obligime të pa shlyera të qeras.

Deri më tani vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën 01.01.2026 deri më 01.11.2026 arrin shumën prej 37617€.

Me respekt!

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB ///26 ///11/2026

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **26 nëntor 2026,** merr këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

1. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.

2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 24 qershor 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

3. Me këtë Deklaratë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.

4. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, strukturat përkatëse komunale përfshirë Kryesuesen e Kuvendit të Komunës, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.

5. Kjo Deklaratë hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Melihate Basholli-Latifi

_____

Kryesuese e Kuvendit